

# KAPITULLI I

## HYRJE

### 1.1 Përkufizime

Për të kuptuar më mirë të gjithë përmbajtjen e kësaj teme dhe çështjet e trajtuara në të është e nevojshme të shpjegohen disa nga përkufizimet bazë ku mbështetet ky punim. Në këtë kapitull të shkurtër hidhet dritë mbi adoleshencën, specifikisht për një nga fenomenet më shqetësuese që mund të shoqërojnë individin adoleshent, si, agresiviteti dhe sjelljet antisociale. Për këtë, në këtë hyrje, do të ndalemi fillimisht në përkufizimet përkatëse.

Përkufizimet e adoleshencës janë dhënë në mënyra të ndryshme nga autorë të veçantë.

E njëjta periudhë moshore që sot përkufizohet me termin adoleshencë, në antikitet si, Sokrati dhe Aristoteli e përshkruajnë atë si rini. Ata u kujdesën të përshkruajnë me detaje dëshirat dhe emocionet e kësaj moshe. Të rinjtë ishin skallavë të dëshirave të tyre e të aftë për ti përthyer këto dëshira në veprime, ndonëse shpesh ndodheshin përballë rregullave dhe normave që ju vendoste shoqëria .

Si periudhën më të rëndësishme studimore që lidhet me adoleshencën mund të theksojmë atë të shek. XX, ku mori edhe hov studimi i këtij stadi mjaft specifik të jetës. Kjo dhe për shkak të evoluimit njerëzor në shkencë, teknologji, si dhe atij mjedisor, gjeografik e natyrisht i të gjitha fushave të zhvillimit. Adolehenca në vetvete është një fazë normale e zhvillimit jetësor, si fëmijëria, mosha e mesme dhe plakja (Wohlman, 1998).

Që të mund të përkufizohet kjo moshë nevojitet të bazohesh mbi disa kritere që në vetvete janë relevante, duke u fokusuar si tek karakteristikat primare dhe ato sekondare dhe jo thjesht elementi moshë (Aarø, 2006).

Është e arsyeshme që fillimisht të dallojmë ndryshimin midis termave, *Adoleshencë*, *Rini* dhe *Pubertet*. Në varësi të fushës së studimit, në litereturë ofrohen tre emërtime, që në vetvete merren me studimin dhe vlerësojnë këtë moshë të zhvillimit njerëzor, që përfshin përkatësisht periudhën e adoleshencës, por duke e trajtuar atë gjithnjë në këndvështrime të ndryshme.

- Për **biologët** dhe **mjekët**, në qendër të studimeve të të cilëve qëndrojnë ndryshimet fiziologjike dhe organike, në këtë fazë jetësore flitet për emërtimin, *Pubertet*. Mutz & Scheer, (1997)
- Për **sociologët**, kjo fazë zhvillimi njihet me termin, *Rini*. Ata gjatë studimit të tyre vënë në dukje se individi përjeton tre stadi të zhvillimit jetësor, përkatësisht atë të fëmijërisë, të rinisë dhe të qenit adult. (King, 2002)
- Për **studuesit e edukimit**, adoleshenca pranohet si një periudhë stresi dhe konfuzioni, në çdo aspekt të jetës. Kjo periudhë shoqërohet me ndryshime të fuqishme psiko-fiziologjike. Adoleshenti nuk është as i rritur dhe as fëmijë, ai përpiqet të kuptojë më shumë rreth shoqërisë, marrëdhënieve sociale dhe mbi identitetin e vet social. Studuesit e edukimit gjithnjë e më shumë e studiojnë adoleshentin në termin CHULT( Child+Adult), Babu, & Islamia (2007).

- Për **psikologët**, kjo fazë njihet me emrin “Adoleshencë”. Psikologët në fokus të studimit të tyre përqëndrohen në analizën dhe zhvillimin e përjetimeve emocionale dhe psikike, të cilat shfaqen gjatë kësaj faze të rëndësishme të jetës.

Termi “adolescence” në literaturën amerikane trajtohet dhe identifikohet që me fillimin e pubertetit nga mosha 13deri në moshën 24 vjeç. Në Argjentinë, përkufizimi i adoleshencës, varion 12-13 vjeç tek femrat, 13-14 vjeç tek djemtë deri në moshën 16,18/21. Kjo identifikohet përkatësisht me 16 vjeç për femrat dhe 18 vjeç djemtë, mund të martohen dhe në moshën 21 vjeç prindërit nuk kanë më përgjegjësi për fëmijët. Në Australi kjo moshë varion nga 12-20 vjeç. Ndërsa në Gjermani, adoleshenca njihet si një stad zhvillimi që shtrihet nga 15 - 24 vjeç, në Austri kjo varion nga 14-19 vjeç (Arnett, 2007).

Kjo periudhë moshore varion nga njëri shtet në tjetrin nga një kontinent në tjetrin, nga një kulturë në tjetrën, por gjithsesi ngelet përgjithësisht në të njëjat vite jetësore, me ndryshime afërsisht nga 2 deri në 3 vjet.

Sipas Frank, (1993), debati qendron kur fillon dhe kur përfundon adoleshenca. Individit adoleshent rritet në një kontekst social ekonomik dhe politik të caktuar dhe që në vetvete është në ndryshim.

**Adoleshenca** (lat. adolescere = rritje, fuqizim) mund të përkufizohet si mosha e rinisë, koha e hyrjes në fazën e pjekurisë gjinore dhe të qënies rritur e cila varion nga 14-25 vjeç, tek vajzat 12-21 vjeç dhe tek djemtë 14- 25vjeç, (vgl. Bibliog. Inst. 1971, S. 292).

- a. Termi adoleshencë njihet si periudha pas pubertetit, kur fillon dhe përgjegjësia personale, ku tiparet e pjekurisë fiziologjike kanë nisur dhe përfundojnë formimin e plotë të tyre. Është periudha e ndryshimeve përmes të cilave individit lëviz nga një siguri relative e fëmijërisë tek privilegji dhe përgjegjësia e adultit (Collins, 1997).

Nga pikëpamja psikologjike duke filluar që në periudhën e pubertetit dalëngadalë individi formon personalitetin e tij. Si simptoma të kësaj faze kemi zhvillimin e të qenit “i lirë”, lidhur kjo dhe me të qenit “vetëbesues” dhe i ndërgjegjshëm (Kaza, 2006).

- b.** Adoleshenca vjen nga lat. “*adolescere*” që do të thotë të rritesh, ajo njihet si periudha e pjekurisë, e cila fillon me pubertetin dhe vazhdon deri në moshë të rritur. Kjo ka nuancat e veta në varësi të kulturës dhe mund të identifikohet si një fazë i të qenit i pavarur (Bertelsmann, 1995).
- c.** Adoleshenca fillon në moshën 10/11 vjeç - 14 vjeç dhe 14 – 16,17 vjeç dhe vazhdon deri në 16/17 - 21 vjeç. Adoleshenca është pika kulminante që përcakton ndryshimet hormonale të cilat ndikohen nga faktorë gjentik, gjeografik dhe nga mënyra e të ushqyerit (Mutz & Scheer, 1998).
- d.** Sipas Adams, 1994 adoleshenca përfshin një grup moshe nga 11-20 vjeç, duke e ndarë në adoleshencën e hershme 11-14 vjeç, adoleshenca e mesme 15-17 vjeç dhe ajo e vonë 18-20 vjeç.

Është e vështirë të gjesh një marrëveshje përsa i përket përkufizimit të termit adoleshencë. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetit, adoleshenca përkufizohet si periudha moshore që varion nga 11/ 12 – 19/21 vjeç (Ayers, 2007).

Shumë adoleshentë gjatë kësaj periudhe jetësore eksperimentojnë me elementë jolegalë, sjellje josociale, sjellje agresive, të cilat përfshijnë destruktivitet, mosmarrëveshje dhe zgjidhje konfliktesh me aksion trupor, pabindje, largime nga shtëpia. Kjo kohë përkon dhe me fillimin apo kryerjen e marrëdhënieve të hershme seksuale, sjellje shqetësuese dhe

nxitëse për të tjerët, si dhe vetvrasje. Një nga problemet shqetësuese të adoleshencës është “Agresiviteti”, i cili është dhe fokus i studimit tonë.

### ***Përkufizimi i Agresivitetit***

Në thelb të studimit tonë është pikërisht trajtimi i formave të agresivitetit dhe lidhja që ai krijon me nxitësit e tij si dhe dallimet gjinore në lidhje me format e shfaqjes së agresivitetit tek adoleshentët e grupmoshës 15-19 vjeç.

“Agresivitet”, fjala vjen nga lat. *aggredi* → sulm, me të cilin nënkuptohet një organizëm që është në gjendje të gatshme për të kryer një sjellje agresive kundrejt personave të tjerë.

“Agresiviteti” sipas një përkufizi tjetër, përshkruhet si një gjendje emocionale, e cila shoqërohet me një dëshirë për të sulmuar persona të tjerë. Kjo dukuri mund të shkaktohet si pasojë e ndryshimeve hormonale apo anomalive gjenetike (Webster ninth new Collegiate Dictionary).

Agresiviteti mund të shfaqet në momente të caktuara të situatave tona jetësore, organizmi e shfaq atë si mënyrë mbrojtjeje dhe e vlerësuar nga kjo pikëpamje një gjendje e tillë do të ishte pozitive. Por kur ky agresivitet shfaqet me sjellje agresive, ose duke përdorur çdo lloj mjete për të shkatërruar të tjerët apo veten, në këto raste kemi të bëjmë me shprehjen e pjesës negative (Larson, 2008). Grada e agresivitetit luhetet nga faktorë të brendshëm, ku duhen nënvizuar sidomos ata hormonal, por dhe nga eksperiencat jetësore.

Personat me agresivitet të lartë reagojnë lehtëazi dhe nga një provokim shumë i vogël. Është tepër e rëndësishme që fjalët agresivitet dhe agresion të mos përdoren si sinonime të njëra tjetrës (Berkowitz, 1993).

Agresioni nënkupton kryerjen e një sjellje agresive në mënyrë të ndërgjegjshme me qëllimin për t'i shkaktuar vuajtje një personi apo për të dhunuar kafshë (Berg & Meers, 1997), por agresiviteti mund të lindë dhe nga një sinjal biologjik, ku qenia fizike juaj kërcënohet (Bernhard, 2012).

Agresiviteti, sidomos ai fizik është normë në fëmijërinë e hershme, por konsiderohet atipike kur vazhdon në fëmijërinë e vonë dhe në adoleshencë (Delfos, 2004).

Agresiviteti i lindur i cili është tipik që në lindje, tek individë vazhdon deri në moshën 2-3 vjeçare, n.q.s. fëmija nuk edukohet dhe nuk gjen mbështetje nga rrethi familjar apo edukativ, gjendja agravon dhe mund të shoqërohet me akte të dhunshme në adoleshencë dhe më pas në moshë adulte (Delfos, 2004).

Sipas Essau dhe Conradt, 2004 dallohen disa tipe agresiviteti “**i hapur**”, që shfaqet dukshëm me dëmtime trupore apo përdorim armësh, “**i fshehur**” sjelljet që shoqërojnë këtë tip agresiviteti janë braktisja e shkollës, vjedhjet, ikjet nga shtëpia etj.

Një nga format e shfaqjes së agresivitetit të fshehur, përkatësisht midis nxënësve apo grupi nxënësish në shkollë, ose brenda në klasë mund të shprehet verbalisht ose fizikisht, por duke u fshehur më së miri (Kampwerth, 2009, S. 7).

### ***Përkufizimi i sjelljes antisociale***

Disa nga përkufizimet mbi sjelljet antisociale analizohen dhe studiohen nga këndvështrime apo perspektiva të ndryshme, por thelbi i tyre ngelet pothuaj i njëjtë. Përsa i takon terminologjisë së agresivitetit në shkencë të ndryshme përkufizohet ose nënkupton sjellje të

ndryshme, por duhet të përpiqemi të dallojmë agresivitetin nga dhuna apo sjellja antisociale, pasi secila ka specifikën e saj (Connor, 2004).

Sjellja antisociale është aftësia për të shkaktuar dëme apo shqetësime kundrejt një personi tjetër, që shfaqet tek individit me fillimin e moshës së fëmijërisë së hershme (Fifth Report of Session, 2004-2005). Për shumë studiues sjelljet antisociale përfshijnë të gjitha aktet vandaliste, përdorimi i drogës apo substancave të tjera si: dehe, sjellje keqtrajtuese në mjedise publike, kërcënime, ngacmime racore apo gjinore. Sjellja antisociale është një mënyrë sjelljeje që shkon kundër normave të një shoqërie. Parke dhe Slaby, (1983).

Agresivitetin e përkufizojnë si një mënyrë apo formë reagimi brenda sjelljes antisociale që drejtohet kundrejt një personi të përcaktuar me qëllim për ta dëmtuar atë.

Ky përkufizim është i njëjtë me atë që jep dhe Loeber (specialist i sjelljeve kriminale, 1985) për sjelljet antisociale, sipas të cilit ky sulm fizik ose mendor ka qëllim t'i shkaktoj dëm një personi tjetër duke thyer ose jo ligjin mbi kriminalitetin.

Sjelljet antisociale janë studiuar më shumë se sjelljet agresive, sepse sjellja agresive është parë në kontekst të sjelljes antisociale, duke përfshirë këtu mashtrimet, apo sjellje tipike antisociale si: përdorim i substancave apo delikuenca që zakonisht shoqërohet me ndëshkim, sepse në vetvete konsiston në shkelje të ligjit dhe në aspektin ligjor çdo veprë e kryer në dëm apo në kundërshtim me ligjin përkufizohet si veprë kriminale (Lösel & Bllesener, 2003, Baier & Pfeiffer, 2011)

Është tepër e rëndësishme të mos ngatërrohen ajo çfarë është deviante dhe që ka të bëjë me personalitetin antisocial që duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në DSM –V.

## **Nxitësit**

Nxitësit mund të jenë të shumëllojshëm dhe me ndikim në jetën e një individi. Ky term e ka prejardhjen nga shkencat mjeksore dhe u zhvillua më tej nga studiues të ndryshëm, duke u përshtatur me fushat e tyre të studimit. Pavlov me eksperimentin që kreu me qentë, doli në përfundimin se ekzistojnë nxitësi: i kushtëzuar dhe i pakushtëzuar, të cilët jo detyrimisht mund të marrin përgjigje (Burns, & Dobson, 1984). Sipas Polich & Begleiter, 1999 matjet e tyre eletromanjetike treguan se nxitësit e ndryshëm ngacmonin një shumësi neuronesh që pasonin me një reagim të pashmangshëm.

Nxitësit që lidhen me agresivitetin mund të jenë të ndryshëm. Kjo lidhur me individin adoleshent, familjen, shoqërinë, apo kulturës pjesë e të cilës ai i është.



## KAPITULLI II

### PERSPEKTIVA TEORIKE MBI ADOLESHENCËN

#### 2.1. Adoleshenca

Në këtë kapitull do të trajtohen disa elementë specifik të adoleshencës si dhe fazat e zhvillimit të individit në këtë periudhë moshore.

Kur flitet për zhvillim e individit, secila shkencë përpiqet të gjej zgjidhje për probleme që kanë të bëjnë me një individ të rritur. Për të analizuar shumë fenomene të adultit, kryesisht sëmundje të ndryshme që shfaqen në moshë adulte, secilës shkencë i duhet t'i kthehet individit fëmijë dhe adoleshent, duke analizuar mënyrën e rritjes, prejardhjen gjenetike apo kulturën nga vjen një individ. Pyetja që mund të shtrohet është : Përse adoleshenca ? Adoleshenca, kjo fazë shumë e rëndësishme zhvillimi jetësor ka filluar të studiohet gjerësisht vetëm në shek.XX.

Adoleshenca është momenti kur individit emërtohet si një qenie *Bio- Psiko-Sociale*, prandaj për ta trajtuar individin në këtë etapë është e rëndësishme ta analizojmë atë dhe funksionin e tij familjar e shoqëror në tre dimensione (Ausubel, 2002)

- a. Biologjik (ndryshimet biologjike që shoqërojnë individin në këtë periudhë moshore).
- b. Social (mjedisi ku ai rritet dhe kultura si roli i tyre në funksionin social të individit adoleshent).

c. Psikologjik (analizë e një sërë faktorësh që ndikojnë në shprehjen e emocioneve dhe sjelljeve që shoqërojnë individin adoleshent).

Ky studim mbi këto ndryshime të dukshme dhe të rëndësishme në këtë stad zhvillimi, nuk do të kishte kuptim, nëse nuk do të merrnim në analizë faktorët apo kushtet kryesore që ndikojnë dhe përcaktojnë këtë periudhë moshore. Gjithnjë kjo analizë realizohet në përputhje me gjininë dhe kulturën pjesë e së cilës është ky individ.

Gjendja tranzitore nga fëmijë në të rritur tek adoleshenti shoqërohet jo vetëm me procesin e maturimit biologjik, por kjo rritje kompletohet nga faktorë ndikimi social- kulturor, gjenetik, familjarë etj. (Stangl,1997, Wohlman, 1998).

Debati qëndron nëse adoleshenca është thjesht një fenomen biologjik apo një konstrukt social. Qasja e të dyjave, inkorporimi tek njëra tjetra, është një dukuri. Për një periudhë të gjatë është supozuar se adoleshenti rritet në botën e krijuar nga të rriturit, por gjithashtu pranohet se shumë prej tyre konstruojnë adoleshencën e tyre. Natyrisht që të rriturit krijojnë kushtet, por janë adoleshentët ata që luajnë pjesën më të madhe, duke qenë faktorë determinues në zhvillimin e tyre (Coleman,1999).

Sipas Larson dhe Willson, 2004 tranzicioni social- kulturor i një vendi, tranzicioni ekonomik, urbanizimi, teknologjia, kushtet atmosferike si tërmetet e fuqishme si psh. ai në Haiti, 2010, apo ndryshimet teknologjike BBC, cilësohen si faktorë të rëndësishëm zhvillimi.

Ndër faktorët determinues që përcaktojnë zhvillimin e adoleshencës, pothuajse në të gjitha vendet, pavarësisht kulturave të tyre, mund të përmendim faktorët si: a. social-kulturor b. Gjenetik c. Mjedisin d.Mënyrën e të ushqyerit e. Klima f. Sëmundjet fizike dhe mendore g. Stresi dhe faktorët social h. Etnia (Berk, 2011).

Shek. XX solli për herë të parë në fokus të mjekëve dhe psikologëve studimin e kësaj periudhe zhvillimi në veçanti.

Në shekullin e XXI në një pjesë të konsiderueshme të literaturës “Adoleshenca” përkufizohet si një stad kalimi dhe zhvillimi i individit nga fëmijë në të rritur, ku një person sheh biologjikisht tek një adoleshent një të rritur, por ende jo me një pjekuri dhe qendrueshmëri emocionale dhe sociale.

Adoleshenca përshkruhet si një periudhë jetësore e fëmijërisë së vonë dhe e të qenit i rritur. Kushtet specifike të zhvillimit të adoleshentit varen nga faktorë të ndryshëm gjinorë, kulturorë dhe social. Kjo periudhë jetësore karakterizohet nga një pjekuri fizike e një të rrituri, sikundër dallohet nga një zhvillim i vrullshëm emocional e psikologjik, njëkohësisht shfaqen elementë të pavarësisë dhe përgjegjshmërisë, të ngjashëm këto me atë të një të rrituri. Adoleshenca është një stad i jetës, ajo shihet si një puzzle, nis si e largët dhe e paqartë e tillë pothuaj se ngelet dhe kur mbaron.

Adoleshenca është një sfidë dhe kënaqësi. Në plan të parë qendron pyetja tek identiteti dhe e ardhmja. Adoleshenca është sfidë, pasi është momenti ku zhvillohen aftësitë, ku jeta sociale bëhet e mundur, kur transformohen marrëdhëniet familjare dhe shumë prej tyre ndahen nga prindërit. Është sfidë sepse dalin në pah shumë vështirësi dhe pengesa nëse adulti dhe adoleshenti ende në formim nuk merren vesh me njëri tjetrin (Coleman, 2011). Adoleshenca është kënaqësi e fitimit të statusit të adultit në idealizimin dhe entuziazmin e jetës që njih ky zhvillim.

## **2.2 Fazat e zhvillimit në adoleshencë dhe faktorët që ndikojnë në zhvillim**

Fjala “ Pubertet” ( lat. *pubertas*, pjekuria gjinore) studiohet si e tillë nga biologë dhe mjekë si fazë e rëndësishme e pjekurisë fizike (Rocheblave-Spenle, 1972).

Vajzat dhe djemtë hyjnë në këtë fazë pak a shumë në të njëjtën kohë, por kriteret e fillimit të adoleshencës janë më të vështira për t’u identifikuar tek meshkujt se tek femrat.

Adoleshenca për femrat identifikohet më herët, ndërsa tek meshkujt pak më vonë.

Në këtë periudhë jetësore, që fillon nga 10/12 vjeç -20/21 vjeç, ashtu si e përmendëm dhe më lart, nuk bëhet fjalë vetëm për pjekuri fizike dhe seksuale, por ky stad jetësor karakterizohet dhe shoqërohet edhe nga një zhvillim i fuqishëm i personalitetit.

Nga studimet theksohet se tre janë fazat kryesore të adoleshencës, (theksojmë se terminologjia është e ndryshme në literatura të ndryshme). Nuk ka një ndarje apo kufi fiks midis adoleshencës dhe paraadoleshencës. Shenja që adoleshenca fillon, është si në planin fizik ashtu edhe atë social dhe përfundon si fazë jetësore kur individi arrin një lloj stabiliteti (Flexner, 2004).

Tri fazat e ndarjes së adoleshencës karakterizohen nga zhvillimi fizik, cognitiv dhe social-emocional. Sipas Akademisë Amerikane të Fëmijëve dhe Fakteve mbi Adoloshentët për Familjet, 2008 janë:

- a. Parapubertet (paraadoleshenca), përfshin moshën nga 11-13 vjeç, kjo karakterizohet nga ndryshime fizike, si rritje të flokëve, trupit, fillimin e menstruacioneve tek vajzat, rritja e testikujve dhe penisit tek djemtë, si dhe shfaqin interes të madh mbi seksualitetin, dallohet rritje për mendimit abstrakt si dhe zhvillohen interesat intelektuale. Në këtë periudhë lind lufta me ndjenjën e identitetit, prandaj shqetësohen për të qenë normal. Kuptohet se prindërit nuk

janë të përsosur duke e rritur edhe konfliktin me ta. Kërkojnë të ndikojnë mbi grupin e bashkëmoshatarëve, shfaqet dëshira për pavarësi si dhe një interes më të madh në jetën private.

- b.** Puberteti (adoleshenca e hershme), përfshin moshën 14-18 vjeç. Rritja fizike ngadalësohet për vajzat por vazhdon ende për djemtë. Dallohet kjo fazë për rritjen e vazhdueshme të kapaciteteve për mendimit abstrakt, vendosjen e qëllimeve si dhe shfaqin interes në arsyetimin moral, duke menduar për kuptimin e jetës. Adoleshentët në këtë periudhë karakterizohen nga shqetësimet në lidhje me të qenit normal. Vazhdojnë të kenë tendencën për të distancuar veten nga prindërit, duan të bëjnë miq dhe kanë besim më të madh tek ata. Popullariteti mund të jetë një çështje e rëndësishme si dhe shfaqen ndjenja e dashurisë dhe pasionit.
- c.** Paspubertet (adoleshenca e vonë), përfshin të rinjtë nga mosha 19-21 vjeç. Tashmë ata janë zhvilluar normalisht dhe kanë marrë pamjen e plotë të gruas apo burrit, si në gjatësi dhe peshë. Ata janë të aftë për të menduar dhe për të dhënë ide. Dallohet rritja e shqetësimit dhe interesit për të ardhmen. Ata shfaqin ndjenjë të fortë të identitetit, rritjen e stabilitetit emocional, rritjen e shqetësim për të tjerët, rritjen e pavarësisë dhe vetë-mbështetjen. Mbeten të rëndësishme marrëdhëniet me shokët (Stangl, 1997).

### **2.2.1 Zhvillimi fizik dhe pjekuria seksuale**

Pas fëmijërisë, vihet re një rritje e dukshme tek individit 11-13 vjeçar, që natyrisht është e veçantë në individ të ndryshëm qofshin këta djem apo vajza.

Tek vajzat kjo fillon që në moshën 7.5 vjeç dhe varion deri në 12 vjeç, ndërsa tek djemtë nga 10 dhe varion deri në 13.5 vjeç.

Për djemtë, periudha e pjekurisë zgjat më tepër se tek vajzat. Për vajzat, kjo pjekuri zgjat deri në të 18-tat, ndërsa për djemtë mund të shkojë deri në vitet e para të dhjetëvjeçarit të tretë të jetës së tyre (Schenk – Danzinger, 1988).

Rritja që të rinjtë pësojnë është jo shumë harmonike, kjo fillon me rritjen e përmasës të kokës, në moshën 15-16 vjeç koka pëson rritjen e plotë si në të qenit adult, pastaj kjo rritje vazhdon me duart dhe këmbët. Paralelisht me këto zhvillohet apo arrihet dhe pjekuria seksuale. Natyrisht që ky zhvillim bëhet me ritme të ndryshme si për vajzat dhe për djemtë. (Stoff, 1996).

Një ndikim të madh mbi zhvillimin e adoleshentëve luan faktori gjenetik. Studimet gjithnjë e më tepër tregojnë se gjenët luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimet fiziologjike që ndodhin në adoleshencë. Këtu bëhet fjalë për gjene të pubertetit KiSS1 dhe KiSS1R (GPR 54) Berk, 2011.

Faktorë tjetër ndikues gjatë zhvillimit në adoleshencë janë sëmundjet fizike dhe mendore, të cilat mund të sjellin vonesë të pubertetit për të dyja gjinitë, si, tek djemtë ashtu dhe tek vajzat. Në botën perëndimore në shekullin e kaluar njihen sëmundje ngjitëse, të zorrëve dhe tuberkulozit, ndërsa në zonat e pazhvilluara sëmundjet më të përhapura janë infeksionet kronike, parazitët etj. Sëmundjet mendore ndodhin në pubertet.

Truri i nënshtrohet zhvillimeve të rëndësishme nga hormonet të cilat mund të kontribuojnë në çrregullime të humorit si dhe çrregullime depressive të mëdha, çrregullim bipolar, skizofreni etj.

Përgjithësisht vajzat e moshës midis 15 dhe 19 vjeç aktualisht në botë përbëjnë 40% të rasteve që vuajnë nga anoreksia nervore (Mutz & Scheer, 1998).

Në periudhën e adoleshencës tek vajzat vërehet formësimi dhe zhvillimi i plotë i legenit, i mitrës dhe i vezoreve, që janë bazë në jetën e tyre të mëvonëshme prodhuese, tek ato konstatohet dhe krijimi i depozitave të yndyrës që do të shërbejnë për ushqimin e fëmijës, si në fetus dhe në gji. Tek djemtë kemi një rritje e zgjerim të shpatullave dhe zhvillim të muskujve që zgjat për disa vite. Tipike për fazën e pubertetit është rritja e shpejtë e peshës trupore, e cila në pubertet zhvillohet dhe fillon të bjerë në një formë më të palëvizshme gjatë adoleshencës së vonë. Vajzat 13 vjeçare amerikane, norvegjezet, britaniket, çekoslovakët peshojnë rreth 45 kg. më tepër kjo se pesha e vajzave kineze, ndërkohë që vajzat afrikane peshojnë 36 kg.

Djemtë 15 vjeç në Amerikë, Suedi dhe Australi peshojnë 54.5 kg. krahasuar me djemtë nga egjipti dhe india pesha e të cilëve varjon diku tek 45 kg., por kjo varet edhe nga raca.

Deri në moshën 12 vjeçare, si meshujt dhe femrat kanë pak a shumë të njëjtin zhvillim të muskulaturës, ndërkohë që tek vajzat kjo ngelet pak a shumë në të njëjtat nivele, tek djemtë kemi një zhvillim më të shpejtë dhe më të fuqishëm të saj. Kjo dukuri, madje shihet dhe si një nga arsyet kryesore që gjatë kësaj faze zhvillimi djemtë janë dhe më të prirur për t'u marrë me aktivitete sportive. Djemtë e arrijnë pikun e rritjes fizike midis moshës 17-20 vjeç, ndërsa tek vajzat 15 – 18 vjeç (Wohlman, 1998).

Presioni i gjakut në pubertet është më i lartë tek vajzat se tek djemtë. Pas vitit të 13- të të jetës presioni i gjakut të djemve afrohet me atë të vajzave dhe kryesisht në tre vitet e fundit të adoleshencës presioni i gjakut është më i lartë tek djemtë se tek vajzat (Stoff, 1996).

Pasojat e rritjes në adoleshencë janë të ndryshme për të dyja gjinitë.

Shpesh zhvillimi fizik i bën djemtë që të jenë më në vështirësi për t'u përshtatur me koordinimin e lëvizjeve të tyre. Vajzat dallohen për zhvillimin e motorikës fine dhe kjo shfaqet tek jeta e tyre e mëvonshme, ato janë më të kujdesshme për gjërat e imta si, në punët me dorë ose me grep. Ndërkohë që djemtë dallohen për zhvillimin e motorikës së trashë (Schenk-Danzinger, 1988).

Natyrisht, këtu shtrohet dhe pyetja se a mos kjo ndodh si pasojë e edukimit? Ndoshta roli i dy gjinive për t'u marrë me disa lloj punësh të veçanta përcaktohen nga kultura e vëndit, edukatorët apo familjarët e tyre (Stangl, 1997).

Hormonet përgjegjëse për rritjen puberiale, si dhe për formimin e pjekurisë seksuale në adoleshencë janë përkatësisht hormonet e gjendrës mbiveshkore, hipofizës, hipotalamus, teroides dhe ovaret.

Në këtë fazë zhvillimi është tepër i rëndësishëm funksionimi i gjendrave endokrine. Vëndin kryesor e ka hipotalamusi që luan rol kryesor në prodhimin e hormonit të rritjes (GnRH), si dhe në prodhimin e disa hormoneve të tjera në gjendrat endokrine, të cilat lëshojnë sinjale të caktuara të cilat çojnë indirekt në prodhimin e hormonit të rritjes dhe procesin e zhvillimit (Kaza, L. 2011).

Një funksion të rëndësishëm kanë tiroidja, gjendra mbiveshkore, gjatë fazës së pjekurisë dhe asaj embrionale, të cilat janë përgjegjëse për prodhimin e hormoneve, përkatësisht ato mashkullore androgjene dhe femërore estrogjene. Këto vazhdojnë të mbeten hormonet



përgjegjëse dhe ndikuese në formimin e tipareve seksuale. Hormoni i tiroides është indirekt ndikues në rritje. N.q.s. kemi mosfunksionim normal të tij kjo mund të çojë në moszhvillim fizik (psh. Xhuxh) ose në rritje të përmasave të mëdha (psh. gjigandizëm).

Në të dyja rastet vërehen ndryshime psikologjike. Kjo pjekuri njihet në fazën fillestare dhe sekondare të pjekurisë seksuale. Ndryshimet hormonale janë ato që çojnë në zhvillimet sekondare (Mutz, & Scheer, 1997).

Një përshkrim i thjeshtë i pubertetit hormonal është si vijon:

- Hypotalamusi fillon çlirimin e hormonit të rritjes GnRH.
- Qelizat e hipofizës përgjigjen për kontrollin e LH dhe FSH në qarkullim.
- Si përgjigje e sasisë në rritje të LH dhe FSH, duke ndikuar në ovare nxitjen e prodhimit të hormoneve estrogjene, testosteron dhe progesteron.
- Rritja e niveleve të estrogjeneve dhe testosteroneve çojnë në ndryshime të trupit gjatë pubertetit, si tek femrat ashtu dhe tek meshkujt.

Fillimeve të këtij procesi neurohormonal mund t'i paraprijnë ndryshime të dukshme në trup. Kjo periudhë mund të zgjatë nga 1-2 vjet (Kaza, L. 2011).

#### **Në fazën e parë dallohen:**

- tek vajzat: floku pubik, rritja fizike e gjymtyrëve, formimi i legenit, i vaginës, i mitrës, i vezoreve dhe rritja parapuberiale e gjoksit.
- tek djemtë: muskulatura, floku pubik, zëri, zmadhim i testikujve, i penisit etj.

### **Në fazën e dytë identifikohen:**

- Tek vajzat: Rritja dhe formimi i plotë i gjoksit, menarka, gjëndrat e yndyrës, aknet etj.
- Tek djemtë: Formimi i plotë i zërit, flokët në trup dhe mjekër, formimi i gjoksit, fundi i rritjes së muskulaturës, rritja e plotë e testikujve, ejakulacioni, gjëndrat e djersës si dhe aknet (Mogler, 2008).

Një ndryshim tjetër i rëndësishëm, që ndosh në adoleshencë, është madhësia e trurit. Gjatë pubertetit kemi dhe një ndryshim të masës së trurit. Nga matjet e kryera nga një elektroencefalogram (EEG) vihet re një ndryshim frekuence e potencialit elektrik të trurit. Në moshën e hershme shkollore matjet kanë treguar valët alpfa me një frekuencë nga 8-13 ritme në çdo sekondë. Ndërsa gjatë pubertetit, këto matje tregojnë valët Theta me një frekuencë 5 ritme në çdo sekondë, gjë që është e matshme me po këtë masë vetëm në moshën parashkollore, madje prej shumë autorësh kjo prezantohet si një regres në pubertet. Ndërkohë matjet tregojnë se këto valë më vonë shkojnë përsëri Alpha, përkatësisht në moshën 16 vjeçare ato qëndrojnë kështu të pandryshueshme dhe në moshën adulte Me fillimin e pubertetit nuk ka përfunduar ende pjekja dhe arritja e madhësisë normale të trurit. Për këtë arsye duhet patur parasysh lidhja e valëve të lobit qëndror me atë të mesëm që është përgjegjës për personalitetin apo zhvillime të tjera karakteristike të individit (Kaza, A., 2008).

### **2.2.2 Zhvillimi konjitiv**

Në adoleshencë krahas pjekurisë somatike vërehen dhe një sërë ndryshimesh konjitive, ku konstatohet dukshëm kapaciteti i rritjes së aftësisë, që mund të klasifikohen: në arsyetimin gojor, sasior, abstrakt si dhe aftësi për kujtesë.

Gjatë kësaj faze zhvillohet aftësia e njohjes së situatave problematike dhe lidhjeve komplekse të ngjarjeve dhe mendimeve, duke arritur një aftësi formale intelektuale dhe abstraksioni.

Sipas Susman, Feagans, & Ray,( 2013) zhvillimi konjitiv është tepër i rëndësishëm për shëndetin e fëmijve dhe adoleshentëve. Zhvillimi konjitiv reflekton sesi ata mendojnë dhe si përthithin dhe perceptojnë informacionin mbi botën e tyre të brendshme fizike dhe atë emocionale, kjo aftësi konsiderohet tepër e rëndësishme për implikimet e shëndetit të tyre. Referuar literaturës hulumtimet sugjerojnë një nga arsyet e niveleve të larta të agresivitetit, është ndjekja e video lojërave të dhunshme ato që ndikojnë fillimisht në komponentin konjitiv dhe lidhjes që ekziston mes tij dhe formave të ndryshme që mund të shfaqet më pas me agresivitet (Anderson & Bushman, 2002).

Që të jenë të shëndetshëm apo të mendojnë për shëndetin e tyre, presupozohet që ata të kenë aftësinë për të menduar dhe zhvilluar nocionin abstrakt mbi shëndetin vetjak. Aftësia e mendimit operacional formal ndodh diku rreth moshës 13- 14 vjeç, ndërsa aftësia për të menduar në mënyrë abstrakte mbi shëndetin e tyre zhvillohet paralel me zhvillimin e mendimeve dhe koncepteve të tjera abstrakte (Bibace & Walsh, 1980).

Koncepti mbi sëmundjet dhe trajtimin e tyre ndjek afërsisht të njëjtën trajektore zhvillimi tek fëmijët dhe adoleshentët, të cilët bëhen vet viktimat të sëmundjeve serioze (Susman, Dorn & Fletcher, 1987).

Paralel me aftësinë e mendimit abstrakt ndryshon dhe gjuha e përdorur. Vihet re një zhvillim intensiv i fjalorit për pasojë rritet aftësia e krijimit. Paralelisht me rritjen e aftësive të arritjes mendore zhvillohet dhe aftësia e organizimit dhe planifikimit, sikundër mendohet të jetë kjo faza e të mësuarit nga gabimet.

Gjatë kësaj periudhe kemi zhvillim të kuptimit të simboleve dhe të figurave (p.sh. në matematikë) ose të operacioneve logjike (Stangl, 1997).

### **2.2.3 Zhvillimi Social**

Mosha e adoleshencës karakterizohet nga vetëpërkushtimi dhe vetëreflektimi. Me arritjen e pjekurisë seksuale, rritja e adoleshentëve është thuajse e menjëhershme dhe e dukshme tek të dy sekset. Natyrisht kjo shoqërohet dhe me dyshime mbi pozicionin e tyre në familje dhe në shoqëri.

Sipas American Psychological Association, 2002 zhvillimi social i adoleshentëve nuk mund të trajtohet jashtë kontekstit në të cilën ajo ndodh, në lidhje me kolegët, familjen, shkollën, punën dhe komunitetin.

N.q.s. një adoleshenti apo adoleshenteje do t'i drejtonim pyetjen se: cili është mendimi i tij/saj më i shpeshtë? shumica e tyre do të përgjigjeshin “pamja e jashtme”.

Adoleshentët fokusohen në detaje që janë tepër të rëndësishme dhe domethënëse për shoqërinë, kulturën nga vijnë, ambjentin familjar dhe sidomos mjedisin shoqëror në të cilën jetojnë si: p.sh. një hundë e gjatë, mjekër e shëmtuar, këmbë ose shputë e madhe, apo pesha tek vajzat, puçrat në fytyrë, si tek vajzat dhe djemtë.

Adoleshenti ndërjegjësohet për faktin se ky zhvillim është i domosdoshëm dhe i

natyrshëm për moshën, si dhe për t'u pranuar për rolin e tij, si i rritur, duke bërë përpjekje të reflektojë mbi pozicionin e tij në shoqëri.

Gjithnjë ky proces është në varësi të edukimit dhe të rolit parapërgatitës që luan familja dhe shkolla, që të shmanget sa të jetë i mundur përjetimi dramatik i kësaj rritje të menjëhershme. Marrëdhëniet prindër fëmijë përfshin një pjesë të mirë të studimeve, si, në Europë ashtu dhe në amerikë.

Dy pikëpamjet që prevalojnë më tepër janë: (Smetana, 2011)

1. Njëra, e cila e shikon adoleshencën si periudhë zhvillimi shqetësuese, ku marrëdhëniet prind-adoleshent karakterizohen nga rebelimi dhe konflikti.

2. Adoleshenca e vlerësuar si një periudhë marrëdhëniesh të afërta dhe të ngrohta.

Adoleshenti përmes procesit të vetreflektimit kërkon identitetin personal, përcaktimi i të cilit mund të konsiderohet si krijimi i vetvetes, si një qenie individuale e një individi të veçantë dhe i patjetërsueshëm, që fillon nga jashtë, duke ju referuar ndryshimeve fizike, për të arritur brenda, me zhvillimet psikike.

Karakteristikë tjetër psikike e vërejtur nga jashtë, është edhe tendenca e adoleshentëve për të manifestuar interesa të reja, sikundër shfaqin dukshëm edhe qëndrime të tjera kundër normave dhe vlerësimeve të ndryshme të sjelljeve të tyre. Ata kërkojnë të krijojnë një lidhje ose formë të re bashkëjetese, duke filluar me eksperiencat e para me seksin e kundërt (ku takimet e para fillojnë në adoleshencë e mesme, ndërmjet moshës 14 dhe 16 vjet), si dhe shoqërohet me dyshimin e vazhdueshëm në përzgjedhjen e llojit të studimeve apo të formimit arsimor që do të vazhdojnë në të ardhmen.

Tek të gjithë adoleshentët konstatohet se mbizotëron dëshira për të qënë të lirë dhe të pavarur. Djemtë janë të prirur ta fitojnë pavarësinë më tepër duke u rebeluar, ndërsa tek vajzat kjo dukuri shfaqet në një formë më të zbutur (Stoff, 1996).

Detyrë e psikologjisë është të analizojë adoleshencën dhe konfliktet që lindin gjatë këtij stadi moshor. Përgjithësisht pranohet se këto zhvillime të rëndësishme ndikojnë në psikikën e tyre e për pasojë reflektohen edhe në statusin Bio- Psiko- Social.

Adoleshenti i zhvilluar dhe i formuar seksualisht ndodhet në një gjendje tranzicioni të krijimit të personalitetit të tij, të ndryshimeve konjitive dhe të aftësive intelektuale.

Ky ndryshim dramatik dhe statusi i tij i ri social gjenden në krizë mes të qënit ende fëmijë dhe të njëjtën kohë edhe i rritur. Adoleshentët janë biologjikisht të rritur dhe tentojnë të sillen si të tillë, por zhvillimi i tyre social- kulturor nuk i përgatit ata për jetën si adult (Wolman,1998).

Ndryshimet biologjike qëndrojnë në fokus edhe të psikologjisë për arsye se ato shpesh bëhen shkak për fenomene që paraqesin interes social.

Në vëmendje të psikologjisë ngelen perceptimet, emocionet, motivimet, sjelljet sociale, gjykimet dhe zhvillimi mendor të cilat vijnë si pasojë e zhvillimit fiziologjik në periudhën e adoleshencës. Për ta kuptuar psikologjinë e adoleshencës është njësoj si ta shikosh atë si variabël të procesit të të mësuarit, të organizimit intelektual, të gjyimit personal, të trendit moshor, të statusit të tij seksual, po aq sa dhe atij social – ekonomik.

Në fokus të studimit të adoleshencës në planin psikologjik, qëndron fakti i të kuptuarit të adoleshentëve dhe problemeve moshore të tyre.

Të gjitha dukuritë e konstatuara nga moshën 13 -19 vjeç, duke filluar nga marrëdhëniet seksuale me ose pa pasoja, përdorimi i drogës apo varësia prej saj dhe kriminaliteti kanë

sjellë pasoja në kontekstin social. Në fakt marrëdhënia familjare dhe lidhjet afektive janë faktorë të rëndësishëm lidhur me ose mos pirjen e duhanit, përdorimin ose mospërdorimin e alkoolit dhe drogave të tjera, fillimin e hershëm ose të mëvonshme të marrëdhënieve seksuale si dhe ndikojnë nivelin e vetëvrasjeve tek adoleshentët (Resnick, Berman & Blum, 1997).

### ***Varësia nga duhani, droga dhe alkoli.***

Shëndeti i adoleshentëve është në risk, pasi ai varet nga sjelljet e tyre si: vetëvrasja, shtatëzani të padëshiruara, delikuenca, alkooli, droga apo duhani, kjo lidhet ngushtë si me faktorë individual dhe kontekstual (Dryfoos, 1990; Colten & Gore, 1991).

Sjelljet shëndetësore ndryshojnë në adoleshencë. Kjo periudhë njihet si një periudhë ku i riu preferon të provojë me elementë të ndaluar pa patur parasysh pasojat. Kur hyn në adoleshencë fëmijët janë normalisht aktiv përsa i takon fizikut dhe është vështirë të thuash se ata do të fillojnë dhe ndoshta do të bëhen përdorues të rregullt të duhanit, alkoolit apo substancave të tjera.

Kur dalin nga adoleshenca një pjesë e konsiderueshme e të rinjëve janë fizikisht joaktiv, ata jo vetëm kanë filluar por janë konsumues të rregullt të duhanit, alkoolit apo substancave të ndryshme. Ajo që gjithnjë e më tepër bëhet shqetësuese është varësia që këta të rinjë krijojnë prej tyre. Shifrat gjithnjë e më shumë tregojnë një gjëndje shqetësuese (Ayers, 2007).

Sipas një raportimi të Organizatës Botërore të Shëndetësisë studimi mbi sjelljet shëndetësore riskuese në shkollë rriten gjatë adoleshencës së hershme. Po sipas kësaj organizate mesatarja e moshës për 35 shtete, gjatë të cilës rritet manifestimi i këtyre

sjelljeve janë: 11 vjeç që përbën 2%, në moshën 13 vjeçare 8% dhe 15 vjeç 24% të manifestimit të këtyre sjelljeve (Currie, 2004).

Diferencat moshore variojnë në shtetet e Europës, USA dhe Kanada. Përsa i takon konsumit javor të alkolit sipas grupmoshave të sipërpërmendura ato variojnë në 5%, 12% dhe 29% në moshën 15 vjeçare, ndërkohë djemtë janë konsumatorë më tepër sesa vajzat në moshë 15 vjeçare përkatësisht 34% djemtë dhe 24% vajzat (Ayers, 2007).

Për të dhënat në vendin tonë do t'i referohemi studimit më të fundit të ISHP (2001-2004), ku vihet në dukje se 40% e të rinjve meshkuj dhe 5% femra janë përdorues të alkolit çdo ditë, konsumi i të cilit shpesh bëhet shkak i kryerjes së sjelljeve antisociale. Nga këta adoleshentë 8 % e tyre e kanë marrë pijen alkolike që në moshën 8 vjeç, 19% nga moshë 9 – 12 vjeç dhe 32% duke filluar nga 12 vjeç.

Marrëdhëniet seksuale janë shoqëruese të adoleshencës, një pjesë e mirë e tyre bëjnë jetë seksuale pa mjete mbrojtëse që mund të çojë në shtatzani të padëshëruara apo përhapjen e sëmundjeve të transmetueshme seksualisht (Kaza,L., 2011).

Nga ISHP (2005) vjen një tjetër e dhënë, sipas një sondazhi të kryer përfundimet kanë treguar se 60% e adoleshentëve, nga 13 -18 vjeç në shkollat e mesme të kryeqytetit, kanë provuar të kryejnë minimalisht një herë marrëdhënie me bashkëmoshatarë të të njëjtit seks, shkaqet që ata vet renditin janë presioni i grupit apo problemet familjare etj.

Sikundër ngelet ende në vemendje të psikologëve që të mund të sensibilizojnë gjithë popullsinë. Me këtë nënkuptojmë jo vetëm ata që janë në marrëdhënie direkte me adoleshentët, qofshin këta mësuesit, prindërit dhe këshilluesit, por dhe gjithë shoqëria, duhet të jetë në gjendje të kuptojë dhe të shpjegojë këto sjellje.



### *Çështje të edukimit*

Të rriturit ndërtojnë marrëdhënie ndërvarësie me fëmijët e tyre. Adoleshentët kërkojnë të jenë të varur nga prindërit, pasi mendojnë se janë të paaftë të marrin pjesë në sistemin e pavarësisë dhe ndërvarësisë së të rriturve. Në të vërtetë ata rebelohen përpara se të kalojnë në marrëdhëniet e ndërvarësisë. Adoleshentët kërkojnë të kenë pavarësi përmes të qenit rebel (Colerman, 1974).

Marrëdhëniet prindër fëmijë në adolehencë përfshijnë një pjesë të mirë të studimeve jo vetëm në Europë, por kudo. Në këtë periudhë moshore të konfliktit prind-fëmijë, pra shfaqet rebelim kundrejt familjes dhe shoqërisë (Semetana, 2011).

Nëpërmjet identifikimit me bashkëmoshatarët, adoleshentët fillojnë të zhvillojnë gjykimin e tyre mbi moralin dhe vlerat duke dalluar qartazi nga prindërit e tyre (Micucci, 1998).

Prindërit reagojnë dhe e përjetojnë në mënyra të ndryshme adolehencën e fëmijëve.

Baballarët raportojnë nivel më të lartë stresi, kur adoleshentët nuk ja vënë veshin këshillave të tyre, ose kur ata përfshihen në aktivitete deviante. Nënata raportojnë nivel të lartë të stresit kur adoleshentët kërkojnë autonomi (Semetana, 2001).

Kur djemtë shkëlqejnë në sport, debate, muzikë, baballarët janë ata, që shprehen me krenari si: “është djali im,, Kur bëhet fjalë për akte vandalizmi ose faji nuk ndodh kështu, ata nuk preferojnë të shprehen në raste të tilla. Nëna, të cilat kanë patur një jetë të gjerë sociale dhe me pasoja në rini, për vajzat e tyre shprehen “ nuk dua të ndodh me të, njësoj si me mua (Flexner, 2004).

Një numër i konsiderueshëm djemsh janë të fiksuar pas fantazive mbi nudizmin dhe sadizmin, ndërsa vajzat janë më të prirura të vizionojnë veten në raste viktime. Pra është e

kuptueshme pse prindrit i keqkuptojnë dhe merakosen për të rinjtë. Ata jetojnë ndryshe nga adoleshentët e gjeneratës paraardhëse dhe mënyra si ata sillen ndryshon nga ajo e të rriturve.

Është logjike që çdo adoleshent do të jetojë dhe rritet jo si në ditët kur prindrit e tyre kanë qënë adoleshent p.sh. në kohën kur pantallonat xhins, ishin veshje pune, apo kur televizionet nuk kishin programe për çdo orë të ditës ose mungesë të aparaturave të tyre në shtëpi, apo të mund të bashkohen me idenë e prindërve të tyre për të zhvilluar party në shtëpi, ku në një qoshe të banesës mund të jetë vendosur manjetofoni, ndërsa hapësira tjetër e shtëpisë të mund të përdoret për të kërcyer.

Ka shumë të rritur që ju pëlqen të bëhen pjesë e jetës së adoleshentëve, të fëmijve të tyre dhe kjo sjell tek ata një pavarësi që nuk e kishin menduar më parë, kjo mund ta bëjë një adoleshent që të mos rritet kurrë, duke parë pikërisht një shembull të tillë nga adulti.

(Flexner, 2004).

Studime të shumta, në vende të ndryshme kanë treguar *se zhvillimi fizik i adoleshentëve është i lidhur ngushtë me shkallën shoqërore, të cilës i përket familja e tij, madhësisë dhe ndikimit të saj në shoqërinë që e rrethon. Moshë e menarkës për vajzat është më e shpejtë tek ato që jetojnë në mirëqenie ekonomike. Këtu një rol të rëndësishëm luajnë edhe mënyra se si adoleshentët ushqehen, shqetësimi dhe kujdesi që tregohet për ta si edhe higjena.*

(Wolman, 1980).

Në literatura të ndryshme gjenden faktorë të ndryshëm duke patur parasysh faktorin socio-kulturor, një nga të cilët janë grupet etnike, që luajnë rol të rëndësishëm, kështu p.sh. vajzat amerikane e fillojnë menarkën më herët se ato europiane.

Ndërkohë vajzat afrikane duke u krahasuar me vajzat e bardha e fillojnë menarkën 8 muaj më herët, ky fakt sillet nga Wohlman, 1980 si një shembull i qartë i ndikimeve etnike në zhvillimin e adoleshentëve. Mjedisi dhe kushtet mjedisore janë gjithashtu faktorë të rëndësishëm në zhvillimin e individit adoleshent.

Natyrisht që pjekja biologjike dhe rritja ndikohen nga gjenetika e një individi, por studimet kanë treguar se ato varen mjaft edhe nga kushtet e jetesës. Nëse ata jetojnë në mjedise me ajër ose jo, me kushte komode ose jo, nëse ata janë të detyruar të punojnë në fazat e hershme të adoleshencës.

Në këtë kontekst mund të nxjerrim në pah edhe dallimet që konstatohen qartazi për fëmijët që rriten në qytet me ata që rriten në fshat (Stangl, 1997). Mënyra e të ushqyerit ndryshon nga njëra kulturë në tjetrën. Në këtë pikëpamje është e vështirë të flasësh për një zhvillim me tipare apo moshë tipike kur flitet për adoleshentë që rriten mes urisë.

Këtu mund të sjellim në vëmendje faktin se në kohën e luftës së parë dhe të dytë botërore madje dhe pas këtyre viteve, fëmijët e arrinin zhvillimin e tyre trupor 10 -20 muaj më vonë nga mesatarja e zhvillimit të viteve të paraluftrave (Nickel, 1975).

Ndërkohë që sot shumë vajza vuajnë nga dëshira e të qenit elegante në këtë moshë, madje provokojnë “grevat e urrisë”. “Dëshira e të qenit elegante” është një nga arsyet që gjatë këtij shekulli ka patur një zhvillimin të shpejtë të një numri sëmundjesh si: bulimia dhe anoreksia.

**Klima** është gjithashtu një tjetër faktor, i cili ndikon fuqishëm në zhvillimin trupor dhe pjekurinë e adoleshentit. Në disa vende ky zhvillim realizohet më herët dhe në disa të tjera më vonë si p.sh. në vëndet skandinave, ku, fakti që ndriçimi diellor është më i pakët dhe

më i vonë se sa në vendet e Europës qendrore dhe jugore, ndikon në realizim më të vonë të zhvillimit dhe pjekurisë së tyre (Stangl, 1997, cituar: Nickel, 1975).

**Ndikimet e mjedisit** në kohën e pubertetit, krahas efekteteve gjenetike apo mënyrës së të ushqyerit, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në ecurinë e shëndetit të përgjithshëm, mund të sjellin shpesh dhe probleme sociale.

**Në faktorët social** mund të veçojmë shoqërinë, si një nga faktorët që luan një rol shumë të veçantë, por pjesa më e rëndësishme e mjedisit psikosocial të fëmijës ka qënë dhe është **familja** (Stoff, 1996). Si sjelljet agresive ashtu dhe agresiviteti në adoleshencë shpesh janë produkt i një game bashkëveprimi, si fëmijë – rritje, fëmijë - probleme të sjelljes, kjo sipas Dishion & McMahon, 1998; Patterson, Dishion, & Bank, 1984.

Disa nga format e agresivitetit lidhen ngushtësisht me familjen, pasi prindërit dështojnë në monitorimin e fëmijëve të tyre, fëmija sillet keq, prindërit reagojnë ashpër dhe ushtrojnë disiplinë. Ky është momenti ku adoleshenti dhe prindërit fillojnë të kenë ndërveprime shtrënguese brenda familjes, të cilat "mësojnë" adoleshentin që të sillet në mënyrë agresive. Adoleshenti refuzon të sillet si prindërit duan. Prindërit i përgjigjen për sjellje të keqe të adoleshentit me agresivitet, një përpjekje kjo për të detyruar fëmijën për të bërë atë që ata dëshirojnë. Adoleshenti i zemëruar vazhdon përsëri. Prindërit tërhiqen, kjo nuk bën gjë tjetër veçse përforcon agresivitetin e adoleshentit.

Ky cikël në rënie vazhdon dhe adoleshenti tashmë ka mësuar se përmes agresivitetit prodhon rezultate të dëshirueshme, duke e konsideruar mjedisin familjar tepër përcaktues në sjelljet e adoleshentit (Bushman & Huesmann, 2009).

Në shumicën e hulumtimeve është konstatuar se veçoritë e strukturës së familjes dhe funksionet e saj në raport me më parë ose më vonë pubertetit, kanë ndikim social.

Shumica e studimeve kanë treguar se menarka mund të ndodhë disa muaj më parë tek vajzat që përjetojnë një gjëndje të lartë stresi familjar, apo në rastet ku prindërit mungojnë gjatë fëmijërisë së tyre të hershme.

Vajzat, që kanë një njerë në shtëpi shpesh mund të bëhen subjekt i abuzimit seksual të zgjatur në fëmijëri. Në anën tjetër, menarka mund të ndodhë të shfaqet pak më vonë, kur një vajzë rritet në një familje të madhe e me praninë e një babai biologjik. Zakonisht kemi një ndikim në gradë ekstreme të stresit të shkaktuar nga mjedisi social, në raste të tilla si statusi i refugjatit të kohës së luftës me kërcënim për mbijetesën fizike etj. Shumica e këtyre efekteve të raportuara, si faktorë socialë na vijnë në ndihmë për të kuptuar më tepër tiparet e kësaj moshe (Berk, 2004).

#### **2.2.4 Zhvillimi Emocional**

Së bashku me zhvillimin fizik dhe kognitiv, te çdo fëmijë dallohet faza e zhvillimit emocional. Ndoshta, të gjithë fëmijët ndryshojnë në zhvillimin e tyre individual.

Zhvillimi social dhe ai emocional janë të lidhura fort dhe jo rrallë herë janë studiuar dhe rezultatet janë raportuar së bashku.

Studimet kanë treguar se prindërit pranojnë se kanë pak informacion mbi zhvillimin emocional, të të rinjëve edhe pse ata gjithashtu e pranojnë se veprimet e tyre kanë ndikim të madh në zhvillimin emocional të fëmijëve të tyre. Prindërit dhe kujdestarët e tjerë luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin emocional, por si bota e fëmijës zgjerohet, njerëz të tjerë në kontekstin shoqëror, gjithashtu luajnë një rol në zhvillimin emocional (Kaza, N., 2006)

Emocionet nuk janë aq të lehtë për të studiuar dhe për shumë dekada studimi i zhvillimit emocional mbeti prapa nga fushat e tjera të zhvillimit të fëmijës (Robinson, 1995).

Megjithatë, hulumtuesit e fillim shekullit njëzetë kanë përfunduar disa teori mbi zhvillimin emocional. Zhvillimi emocional është emergjenca për të shprehurit, të kuptuarit, dhe rregullimin e emocioneve nga lindja e deri në fund të adoleshencës, e cila gjithashtu përfshin dhe ndryshimet në këto proces rritje në lidhje me emocionet (Kaza, N.2004).

Zhvillimi emocional nuk do të ndodhë në mënyrë të izoluar nga ai fizik, cognitiv dhe me zhvillimin e sjelljes, por bashkëveprojnë me zhvillimin emocional dhe ndikimet sociale dhe kulturore Trentacosts & Izard (2007). Ankthi, kënaqësia, zemërimi, frika dhe interesi janë ndër emocionet që shoqërojnë adoleshencën. Fëmija e fillon jetën me të qeshura rreth 3 deri në 4 muaj e parë të jetës. Frika fillon të shfaqet shpejt dhe foshnjat jo rallë ndjekin emocionet e kujdestarëve të tyre duke formuar lidhje të fortë me ta.

Në adoleshencën e hershme, fillojnë të zhvillohen më shumë ndjenja të tilla, si krenaria apo turpi. Këto zhvillime emocionale zbehen pjesërisht nga maturimi i shpejtë i lobit frontal dhe qarkullimi limbik në tru. Zhvillimi i emocioneve negative vijon më pas, zemërimi fiton mbi trishtimin si formë për të shprehur ndjenjat negative (Corso, 2007).

Në adoleshencën e mëvonshme, ata mësojnë "rregullat" si të shfaqin emocionet, e cila është një formë e zhvillimit social dhe emocional. Aftësia për të shtypur emocionet negative është një faktor i zhvillimit normal, ndikimet e tjera të tilla si, gjinia, situata specifike, ndikimeve kulturore mund të ndikojnë, si në shfaqjen ashtu dhe në shtypjen e emocioneve negative.

Një arsye tjetër për emocionet negative mund të jetë zhvillimi kognitiv i aftësive abstrakte të të menduarit. Nga ana tjetër fakti që problemet sociale bëhen më komplekse, adoleshentët kërkojnë ndihmë të bashkëmoshatarët e tyre për tu ndihmuar për mënyrën se si të menaxhojnë emocionet që ata ndjejnë (Goleman, 1995).

Zhvillimi i ndjeshmërisë është një nga format e zhvillimit emocional. Duke njohur emocionet e tyre, adoleshentët kërkojnë që të rriturit apo bashkëmoshatarët të kuptojnë që ata kanë ndjenja dhe se këto të fundit duhet të merren në konsideratë prej tyre.

Ka adoleshentë që shfaqin vështirësi specifike në "leximin" me saktësi të emocioneve të cilat bëjnë që të lindin armiqësi. Empatia, e cila si rregull duhet të lind që në fëmijërinë e hershme mund dhe të mësohet në kontekste të ndryshme (Aronson, 2000).

Çështjet familjare, presioni akademik dhe ndjenjat romantike shkaktojnë presion mbi emocionet e adoleshentëve. Adoleshentët kuptojnë se ndjenjat e tyre, ku tashmë ka filluar procesi i i autonomisë emocionale, janë të ndara nga emocionet e prindërve të tyre.

Adoleshentët mund të ndjehen të tërhequr përse i takon lidhjeve të ngushta emocionale që ata kanë me prindërit e tyre dhe nevojën për të zhvilluar përgjigje të pavarura emocionale. Depresioni përgjithësisht ndodh në këtë moshë dhe është më e zakonshme te vajzat sesa tek djemtë Wagner, Friend, Bursuck, Kutash, Duchnowski & Sumi (2006).

Një pjesë e rëndësishme e zhvillimit emocional të fëmijëve dhe adoleshentëve ka të bëjë me faktin se si fëmijët njohin dhe kontrollojnë shprehjen e emocioneve të tyre, në ato mënyra që në përgjithësi janë në përputhje me pritshmëritë kulturore. Studimi i fëmijëve dhe i zhvillimit të adoleshentëve dhe zhvillimi i strategjive pozitive mësimore është ndërveprim

kompleks i rregullimit dhe zhvillimit të sferës emocionale. Vetë-rregullimi i emocioneve përfshin njohjen dhe përcaktimin e emocioneve. Shpesh është familja që ofron një gamë të sjelljes-rregulluese, që lidhet me funksionet sociale-rregullatore dhe sjelljeve të brendshme rregullatore për një individ.

Proceset neurokimike lidhen me ndryshimet automatike dhe funksionet trupore dhe sjelljore. Seksione të veçanta të trurit janë të lidhura me emocione të veçanta. Zhvillimi kognitiv ndikon në zhvillimin e aftësive për të kuptuar vetë-rregullimin emocional.

Emocionet dhe shëndeti luajnë një rol qëndror në teoritë psikoanalitike. Stresi i lidhur me emocionet janë koncepte kryesore në perspektivën teorike në shëndetin sjellor.

Ndryshimet fiziologjike të cilat shoqërohen me rritjen e nivelit të hormoneve të ndryshme tek adoleshentët shfaqen me ndryshime emocionale. Këto mund të jenë emocione negative duke bërë që ata të lindin patologji të ndryshme dhe shkaktojnë stres (Dienstbier, 1989), sikundër në të kundërt nëse kanë një suport të mirë social, adoleshentët shfaqin emocione pozitive.

Ndikimet negative emocionale të jetës familjare mund të jenë të ashpra, veçanërisht në modelin e disiplinës së fëmijës, ato mund të çojnë në probleme në zhvillimin emocional dhe madje edhe psikopatologjisë.

Sipas Carolyn Saarni, profesor i këshillimit në Universitetin e Shtetit Sonoma (Kaliforni), i cili trajton dy lloje të zhvillimit emocional në adoleshencë: atë prosocial dhe vetë-mbrojtëse, emocioni prosocial ndryshon për të mbrojtur ndjenjat e njëri-tjetrit. Ndërsa ato vetë-mbrojtëse përdoret për të shmangur ndrojtjen apo për të mbrojtur veten e tyre nga



pasojat e mundshme negative. Djemtë kanë më pak gjasa se sa vajzat për të shprehur frikën në kohët e stresit nga frika e nënvlerësimit (Zimmerman, Copeland, Shope, & Dielman, 1997; Brown, 1998).

Sipas Erikson, 1968 krijimi i një ndjenje identiteti tradicionaliste mendohet se është emocion qendror në adoleshencë edhe pse krijimi i tij te çdo individ konsiderohet, si një zhvillim normal që fillon dhe mbaron gjatë adoleshencës (Carlson, Uppal, & Prosser, 2000).

Zhvillimi emocional gjatë adoleshencës përfshin dhe krijimin e një ndjenje realiste dhe koherente të identitetit në kontekstin e lidhur me të tjerët dhe të mësuarit për të përballuar stresin dhe menaxhim i emocioneve (Santrock, 2001).

### **2.3 Teoritë e zhvillimit në adoleshencë**

Gjatë kësaj pjese do të trajtohet Adoleshenca, në kuadër të rëndësisë së studimit të individit si një qenie Bio-Psiko-Sociale, përkufizimi i fjalës, terminologjitë që përdorin shkencë të ndryshme në varësi të lëmit të tyre të studimit si p.sh. Pubertet - Rini - Adolehencë.

Periudha moshore që adoleshenca përfshin, varion nga njëri vend në tjetrin, nga njëri shtet në tjetrin, për rrjedhojë dhe përkufizimet për adoleshencën variojnë në kultura të ndryshme (Arnett, 2007). Fazat e zhvillimit, përfshijnë zhvillimin: fizik, psiko - motor, konjitiv, intelektual, emocional, psikik, pjekurinë seksuale, masën e trurit.

Adoleshenca ndahet në tre etapa për studimin e saj. Në etapën e parë përfshihen disa nga teoritë e zhvillimit të adoleshencës, duke filluar me Hall, e vijuar me Frojd dhe Erikson.

Janë vitet 1970- 1998, ato vitet që përfshijnë etapën e dytë të studimit të adoleshencës.

Etapë e cila u fokusua jo vetëm në zhvillim biologjik apo psikik, por një rol të rëndësishëm ju dha dhe marrëdhënieve në familje dhe shoqëri, natyrisht kjo gjithnjë sipas

karakteristikave individuale të adolehentit. Adolehenca apo puberteti, si një akt biologjik i cili modifikon sjelljen vijoi me studimet e Parker,( 2000) kohë që shënon dhe fillimin e etapës së tretë të studimit të adoleshencës.

Kjo teori në fakt dominoi që në fillim të shekullit të 20-të, nga përfaqësuesit e

psikodinamikës, ku spikat perceptimi se maturimi seksual, i cili konsiderohet sinjifikativ në zhvillimin psikologjik, duke ndikuar thellësisht mbi predispozicionin biologjik (Brooks-Gunn & Petersen, 1984).

Në tre dekadat e më vonëshme bihejvioristët, kontekstualistët dhe teoria e të mësuarit zëvendësuan teoritë e zhvillimit dhe evoluimit (Lerner, & Steinberg, 2004).

Disa nga teoritë më të rëndësishme të zhvillimit për moshën e adoleshencës janë: Teoria biologjike (Granville Stanley Hall, 1844 - 1924), teoria psikoanalitike (Sigmund Frojd, 1856 - 1939), kulturore (Margaret Mead, 1901 - 1978 dhe Ruth Benedict, 1887 - 1948), teoria konjitive (Jean Piaget, 1896 - 1980) dhe ajo psikosociale (Erik Erikson, 1902 - 1994).

Një rol të rëndësishëm luan psikologjia e adoleshencës dhe faktorët që ndikojnë në zhvillimin e adoleshencës si: social-kulturor, gjenetik, mjedisi, mënyra e të ushqyerit, klima, sëmundjet fizike dhe mendore, stresi, faktorët social si dhe etnia.

Ky stad i zhvillimit të rëndësishëm jetësor, të kalimit nga fëmijëria në adult njih momentin e vet të kërkimit shkencor që në kohë të herëshme, duke filluar me Platonin dhe Aristotelin. Sipas studiuesit Muuss, pretendohet se termi adoleshencë është përdorur për herë të parë që në shek. XVII. Ndërsa studiuesit e shek. XIX e trajtuan këtë perudhë jetësore në aspektin biologjik dhe sociologjik. Këtu mund të veçohet roli i Carls Darwin, i cili hodhi idenë për të gjithë studiuesit, se vetëm nëse studiojmë zhvillimin biologjik dhe psikologjik të kësaj moshe mund të arrihej në një stad të tillë që të mund studiohej adulti dhe sjelljet e tij.

Të analizohet zhvillimi teorik përmes disa teorive do të thotë të kuptohen dhe integrohen aspekte të fenomeneve që nuk janë të vëzhgueshme direkt, përkundrejt fakteve empirike, të cilat besohet se mund të provohen në realitetin objektiv, por ajo që vëzhgohet është indirekte, çfarë adoleshenti percepton përsa i takon emocioneve apo dëshirave.

Për të vëzhguar direkt fenomene, është teoria ajo, që na çon drejt një studimi për të kuptuar mirë zhvillimin mendor dhe fizik (Gemelli, 1996).

Realisht teoritë e mirëfillta që filluan të merren me studimin e adoleshencës i përkasin fundit të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX, ku individi në adoleshencë u trajtua përfundimisht, si një qenie Bio- Psiko- Sociale. Megjithëse kjo teori ndeshi në kritika të mëdha gjatë asaj kohe, pasi ndryshe nga fenomenet objektive që janë të vëzhgueshme, fenomene të tilla si: strukturat e funksionimit mendor, emocionet, perceptimet, dëshirat apo kujtesa, janë shumë më të vështira për tu studiuar.

Këto dukuri ne mund t'i përcaktojmë vetëm sipas vlerësimit të fjalëve me të cilat individët shprehen për këto fenomene joobjektive.

Gradualisht gjithnjë e më shumë kërkimet thellohen si pjesë e evolucionit njerëzor si dhe e atij teknologjiko- shkencor. Më poshtë do të hedhim dritë vetëm mbi pesë teori kryesore të shekullit të XX-të që ndikuan fuqishëm në njohjen më të mirë të adoleshentit, si një qenie bio – psiko – sociale, si dhe faktorët e riskut në zhvillimin e përgjithshëm të adoleshentit, por dhe në zhvillimin e agresivitetit apo sjelljeve anti-sociale si: krizat botërore, varfëria, marrëdhëniet jo të mira në familje, divorci apo humbja e vendeve të punës së prindërve (Berk, 2011).

**Pesë teoritë kryesore janë:**

1. Teoria biologjike (1844 – 1924)
2. Teoria psikoanalitike (1856 – 1939)
3. Teoria kulturore (1901 – 1978)

4. Teoria Konjitive (1896 – 1980)

5. Teoria psikosociale (1902 – 1994)

### **2.3.1 Teoria biologjike me përfaqësues Granville Stanley Hall (1844- 1924).**

Studimet e veta Hall i kufizoi në shoqërinë amerikane dhe ato perëndimore, por ai nuk mori parasysh kulturat e tjera. Sipas tij, në këtë fazë zhvillimi çdo qenie humane është e ndikuar nga ndryshimet biologjike të kësaj moshe, prandaj G.S.Hall, 1904, do ta cilësonte adoleshencën një fazë, ku interesat personale, si dhe të qenit rezultativ në shoqëri çojnë në një periudhë që u cilësua dhe u njoh me emërtimin “Stuhi dhe vrull” (Wolman, 1998).

Puna e tij, kulmin e vet e arriti me enciklopedin “Adoleshenca”, jo vetëm me përmbajtjen e kësaj enciklopedie, por dhe në titull, ai formuloi teorinë e tij të madhe të adoleshencës.

Në fakt Hall, stuhinë dhe stresin e adoleshentëve në shoqërinë amerikane e shikonte të lidhur me globalizimin. Hall, veçoi tre aspektet bazë të periudhës “Stuhi dhe Vrull” përkatësisht (Smetana, 2001):

- a) konflikte me prindërit,
- b) luhatje humori
- c) sjellje të rrezikshme.

Një adoleshencë normale është në vetvete një periudhë intensive e karakterizuar nga emocione të fuqishme dhe stres i shtuar. Emocionet janë ekstreme, adoleshentët nga gjendja e të qenit të heshtur, të trishtuar, shumë shpejt kalojnë në euforizëm apo indiferentizëm.

Sipas Hall, disa nga dimensionet e zhvillimit në adoleshencë, si: zhvillimi intelektual, seksual, fizik, mendor e motor, të cilat shoqërohen edhe me shfaqje të sjelljeve kriminale dhe antisociale në adoleshencë, çuan në hipotezën se adoleshentët, universalisht

karakterizohen nga shqetësime jo të zakonshme, si dhe përjetojnë një periudhë jetësore të mbushur me stres (Wolman, 1998).

Duke qënë se G.S. Hall, ishte tepër i njohur dhe punoi shumë në fushën e zhvillimit të arsimit, hodhi për herë të parë idenë se këto zhvillime biologjike do të ishte e udhës të trajtoheshin në klasa, atje ku mësonin të dyja gjinitë.

Hall, vuri theksin se shkolla e mesme duhet të hiqte dorë nga fokusimi drejt lëndëve tradicionale, përkundrazi ajo duhej të përqëndrohej më së tepërmi në punën e vet mbi edukimin e adoleshentit, ku më e rëndësishme për këtë studiues, ishte përgatitja e adoleshentit për në kolegji. Ai vlerësohet edhe për kontributin e tij të madh në në lëmin e psikologjisë së aplikuar dhe këshillimin e studentëve të doktoraturës.

Veprimtaria e këtij studiuesi, ishte dhe një ndihmesë e jashtëzakonshme për zhvillimin e psikologjisë (Gemelli, 1996).

Sipas Compas (2004), të gjithë ata që shkruajnë për adoleshencën se karakterizohet si një periudhë stresi i referohen procesit të përballjes. Shembull për këtë mund të cilësohet puna e famshme e Seiffge – Krenke (1995), e cila propozon skemën e katër fazave të kësaj periudhe zhvillimi: natyrën e sensorve, burimet individuale, tipet e suportit social dhe procesi i përballjes, moment ky që në shumicën e adoleshentëve shoqërohet me stres (Yen, 2008).

Studimet shkencore bazuar në zhvillimin biologjik dhe social të individit të kësaj periudhe patën arritjen e tyre më të madhe me përgatitjen e testeve të inteligjencës nga studiuesit Alfred Binet dhe Theodor Simon si të G.S.Hall (Berk, 2011).

### **Teoria biologjike kishte si qëllim studimi:**

- a.** Se si faktorët fiziologjik ndikojnë ose janë përgjegjëse për dukuritë psikologjike të cilat shfaqen në adoleshencë.
- b.** Se përcaktimet gjenetike të këtyre ndryshimeve fiziologjike vënë në pikëpyetje garancinë e nevojshme se pasojat psikologjike të adoleshentët do të ishin të njëjta tek individë të ndryshëm.
- c.** Ndryshimet fiziologjike prodhojnë direkt ndryshime sjellore dhe indirekt kontribuojnë në formimin e personalitetit.

Teoria biologjike u kritikua që për emërtimin që Hall përdori për të si periudha “Stuhi dhe Vrull”. Kjo periudhë u identifikua më së shumti dhe me termin “stuhi dhe stres”.

Psikologët nuk e pranuan këtë si teori universale, sipas tyre jo të gjithë adoleshentët përjetojnë stuhë dhe stres, por ama ka shumë gjasa që stuhë dhe stres të përjetohet më shumë në këtë fazë zhvillimi se në asnjë fazë tjetër jetësore (Vasta & Haith, 2007).

### **2.3.2 Teoria Psikoanalitike me përfaqësues Sigmund Frojd (1856 – 1939 )**

Sigmund Frojd e filloi punën hulumtuese, si mjek në degën neuro - fiziologji. Gjatë studimeve të tij ai vendosi të studiojë zhvillimin e individit, duke e ndarë atë në pesë faza, të cilat ndikojnë më pas në jetën e individit adult.

Frojd e mbështeti teorinë e vet të zhvillimit në pesë stadet psiko-seksuale, mos realizimi apo moszgjidhja e konfliktit të cilave ndikon fuqishëm në jetën e mëvonshme, duke përfshirë dhe agresivitetin (Vasta, & Haith, 2007). Ai nuk e shikon adoleshencën detyrimisht të ndikuar nga faktorët e ndryshimit fiziologjik, prandaj më shumë i mëshon moszgjidhjes se

konfliktit të individit të rritur nga moszgjidhja e konflikteve të fëmijërisë, ku mos plotësimi çon në “frustracion” dhe teprimi në “abuzim” (Berk, 2011).

- a. Stadi oral,** ku fëmija krijon marrëdhënie me mjedisin përreth, veprimtaria e foshnjës lidhet rreth ndjeshmërive dhe veprimtarive orale (marrja e kënaqësisë së foshnjës në gjirin e nënës) i cili transferohet dhe në subjekte autoerotike si thithja e gishtit etj.
- b. Faza anale,** kufizohet diku në moshën dy vjeçare, ku fëmija përjeton konfliktin midis idit (kënaqësisë) – egos dhe superegos, të cilat përfaqësojnë presionet shoqërore për të kontrolluar funksionet trupore, fazë ku fëmijës synohet t’i mësohet vetkontrolli dhe stërvitja për në tualet.  
Në këtë mënyrë zgjidhja e këtij konflikti çon në zhvillimin e egos e cila do të ndikojë në sjelljet e mëvonshme të individit.
- c. Faza falike,** fokusi i kënaqësisë janë organet gjenetale, fëmijët shfaqin kuriozitet për genetalet e veta dhe për trupin e njerëzve të tjerë, ata përjetojnë dëshirën e pavetëdijshme për të zotëruar prindin e seksit të kundërt.  
Këtu kërkohet zgjidhja e kompleksit të Edipit (tek djemtë) dhe Elektrës (tek vajzat). Sipas Frojdit moszgjidhja e këtij konflikti për krijimin e identitetit gjinor mund të çojë në homoseksualitet.
- d. Faza latente,** që shkon deri në paraadoleshencë. Është momenti ku fëmijët e kanalizojnë energjinë e tyre libidinike në aktivitete jo seksuale si shkolla, sporti dhe miqësitë me shokët e të njëjtit seks.
- e. Faza gjenitale,** e cila përkon me fillimin e adoleshencës, është koha gjatë të cilës krijimi i balancës së tre komponentëve ego – idi - superego në fazën latente prishet duke sjellë tek adoleshenti stres dhe shqetësime emocionale.



### 2.3.3 Teoria kulturore me përfaqësues Margaret Mead (1901 – 1978) dhe

#### Ruth Benedict (1887 -1948)

Në vitin 1920, duke qënë se studimet e mëparshme dhe përfundimet e Hall, ishin fokusuar vetëm në USA dhe në vëndet perëndimore, këto dy përfaqësuese të kësaj teorie e studiuuan këtë fazë të zhvillimit dhe në kultura të tjera.

Ruth Benedict, në studimet e saj arriti në përfundimin se në kultura të ashtuquajtura “jo stresante” ku ajo u fokusua kryesisht tek gjinia femërore, socializimi i këtyre individëve me këto lloj ndryshimesh fiziologjike të fuqishme është në vazhdimësi dhe graduale.

Ajo solli rastin e një pjese të mirë kulturash ku nëna qendronte në shtëpi dhe merrej me edukimin e fëmijëve, me përgatitjen e ushqimit. Nëna e mësonte dhe e përgatiste vajzën e vet që në fëmijëri dhe më vonë në adoleshencë, që të zhvillonte të njëjat tipare si ajo, kur të rritej. Ruth Benedikt, studimet i fokusoj dhe në kulturat e ashtuquajtura “stresuese”, referuar kryesisht gjinisë mashkullore, ku zhvillimi që ajo konstatoi ishte jogradual dhe jo i vazhdueshëm (Adams & Gullota, 2005).

Ndërsa Margaret Mead, u përqendrua tek disa lloj kulturash të quajtura stresuese ose jo dhe vlerësoi në to raportin Adoleshent – Stres – Përgatitje praktike, duke konstatuar se kultura me të cilën dhe brenda të ciles adoleshenti jeton, është përcaktuese dhe në llojin e marrëdhënieve që ai krijon në familje dhe shoqëri (Adams & Gullota, 2005).

Mead specifikoi tre tipe kulturash:

- a. Postfigurative**, ku e shkuara prezanton të ardhmen, ku tradita është orientuese e kulturës.
- b. Cofigurative**, një ndryshimi i moderuar, ku prindërit dhe mësuesit e përgatitin adoleshentin për jetën adulte.

**c. Prefigurative**, ku i jepet rëndësi që të riut t'i mësohet si të mendojë, si të evoluojë, si të zgjidhë problemet dhe jo çfarë të mendojë, të bëjë, të besojë, apo çfarë të vlerësojë.

#### **2.3.4 Teoria Konjitive me përfaqësues Jean Piaget (1896 – 1980)**

Biologu, i cili e trajtoi individin në teorinë e tij, si një sistem i hapur, me të cilin ai nënkuptonte një organizëm i cili është në ndryshim.

Individi reagon nga ndikimi i mjedisit dhe më pas mëson të përshtatet në të, duke e ndikuar përsëri mjedisin.

Piaget u mbështet në teorinë darviniane, duke parë dhe analizuar këtë prespektivë nga ana biologjike dhe psikologjike. Këtij sistemi të hapur i perkasin, si strukturat e të menduarit ashtu dhe ndjenjat, sipas të cilit operacionet e të menduarit tek adoleshenti ndryshojnë nga ato të adultit.

Në qendër të teorisë së tij, janë dy procese të rëndësishme funksionale, asimilimi dhe përshtatja konjitive, të cilat qëndrojnë dhe në thelb të aktivitetit të zhvillimit konjitiv e intelektual të çdo adoleshenti. Të dyja këto aspekte ndihmojnë në përshtatjen e individit me mjedisin përreth (Vasta & Haith, 2007).

Sipas Piaget “mendja” është formë e përpunuar e përshtatjes organike. Ai ishte i mendimit se njerëzit në luftën për mbijetesë duhet të vendosin një balancë midis asimilimit dhe përshtatjes.

Piaget përshkruan katër faza të rëndësishme të zhvillimit që janë:

- a.** Faza e inteligjencës sensomotore.
- b.** Faza paraoperative (2-6 vjeç).
- c.** Faza e operacioneve konkrete të inteligjencës (6- 19 vjeç).

**d. Faza e operacioneve formale 10-16 vjeç (Adoleshenca).**

(Berk, 2004).

Në këtë fazë individi nuk është i kënaqur me një logjikë konkrete, ai ndjen nevojën të bëjë supozime dhe të bëjë arsyetime hipotetike.

Gjatë kësaj faze të zhvillimit adoleshenti, duhet të jetë në gjendje të realizojë lidhjen midis realitetit dhe mundësisë. Sipas këtij studiuesi një grup i strukturuar konceptesh, që përdoren për të përfaqësuar objekte, projekte ose sekuenca ngjarjesh, përbëjnë të ashtuquajturat “Skema” (Vasta & Haith, 2007). “Skema” është një kornizë mendore e krijuar nga një individ në mënyrë që ai të ndërveprojë me mjedisin fizik dhe atë social.

Piaget paraqet tre lloje strukturash intelektuale:

**a. Sensomotore**

**b. Simbolike**

**c. Operative**

(Vasta & Haith, 2007).

Nëse adoleshenti nuk është i aftë të zgjidhë skemat, atëherë kjo e çon atë në mosekuilibër, i cili prodhon zhvillim konjitiv dhe e nxit adoleshentin për rikërkimin e përsëritjes së skemave.

Piaget vuri në dukje që fëmija është një qenie aktive, por ky studiues nënvleftësoi aftësitë e fëmijve, si dhe ndikimin që ka procesi i të mësuarit në zhvillimin mendor të tyre.

Kjo teori u kritikua dhe për faktin se nuk ishte e mbështetur në të dhëna statistikore.

### 2.3.5 Teoria Psikosociale me përfaqësues Erik Erikson (1902 – 1994)

Erik Eriksoni ishte një neu – Frojdian (pasues i Frojdi) dhe bashkëpunor i Anna Frojdi, por në ndryshim nga Sigmund Freud, ai i zhvilloi edhe më tej këto ide, me tre stadi të tjera, zhvillimin e individit deri në adult.

Erik Erikson përpunoi tetë faza të zhvillimit të plotë të individit dhe njëkohësisht përfundoi fazën e pestë, atë gjentile, të Frojdi në adoleshencë.

Për Erikson tendenca e formimit të identitetit dhe personalitetit në adoleshencë është kyçi i teorisë së zhvillimit psiko-social të personalitetit.

Tetë fazat e zhvillimit sipas E.Erikson:

**a. Besimi ose mosbesimi** – Faza e fëmijërisë nga 0-1 vjeç, ku fëmija krijon ndjenjën e besimit ose mosbesimit për nënën ose kujdestarin e vet që në këtë fazë përbën dhe fushën e marrëdhënieve sociale.

**b. Autonomia përkundrejt turpit** nga 1-3 vjeç.

Fëmijët mësojnë të eksplorojnë botën, ata e ndërpresin këtë proces nëse prindërit janë shtrëngues ose plotësisht neglizhent.

**c. Iniciativa përkundrejt fajit**

Mosha parashkollor nga 3-6 vjeç, është faza ku fëmija mëson të imagjinojë, të zgjerojë aftësitë e tija në lojë.

Përmes lojrave aktive që nxitin fantazinë, zhvillohet bashkëpunimi me të tjerët, ata mësojnë të udhëheqin, por dhe të ndjekin të tjerët, duke qëndruar të varur nga grupi, por sidomos në mënyrë të pashmangshme nga të rriturit.

Në këtë fazë fëmija mëson shpejt dhe merr pjesë në veprimtari të reja. Kur iniciativa e fëmijës mund të kufizohet atëherë tek ai shfaqet ndjenja e fajit dhe e shqetësimit.

Kështu prindërit privojnë fëmijët ndaj dëshirave dhe i ndëshkojnë ata për gabimet, duke shkaktuar ndjenjën e fajit dhe frikën ndaj ndëshkimit.

**d. Zelli kundrejt inferioritetit apo të qëniet kompetent**

Mosha shkollore nga 6-11 vjeç. Tek fëmijët e kësaj moshe mund të identifikohen dallime të mëdha në aftësitë personale në lidhje me aftësitë e tjera. Erikson vë theksin për mësuesit e kësaj moshe, të cilët duhet të sigurojnë të gjitha kushtet e nevojshme që nxënësit e tyre të mos ndihen inferiorë.

**e. Identiteti përkundrejt konfuzionit (identitetit të paqartë)**

Adoleshenti nga 12 deri 20 vjeç pyet : Kush jam unë? Si mund të përshtatem ? Ku jam duke shkuar në jetë? Erikson beson se nëse prindërit i lejojnë fëmijët për të eksploruar, ata do të mund të arrijnë të përfundojnë krijimin e identitetit të tyre. Nëse prindërit vazhdimisht i nxitin ata me pikëpamjet e tyre, adoleshentët do të përballen me një situatë konfuzë për krijimin e identitetit personal, prandaj është e domosdoshme që ata të kërkojnë, të eksperimentojnë duke provuar role të ndryshme dhe duke gjetur atë pozicion në të cilin adoleshentët ndihen më mirë.

**f. Intimiteti përkundrejt izolimit**

Kjo periudhë i përket fazës së parë të zhvillimit, nga 20 deri më 24 vjeç, ku martesat, familja dhe miqësitë, janë mjaft të rëndësishme në jetën e çdo individi. Adoleshentët realizojnë me sukses formimin e marrëdhënieve me njerëzit e tjerë. Kjo është koha kur individët janë të aftë të përjetojnë dashuri dhe intimitet. Ndërsa ata që dështojnë për të formuar marrëdhënie të qëndrueshme por mund të ndjehen shpesh edhe të izoluar dhe të vetmuar.

**g. Stanjacioni, prodhueshmëria përkundrejt vetëpërvetësimit:**

Kjo është faza e dytë e të rriturve dhe ndodh midis moshës 25-64 vjeç. Gjatë kësaj kohe, një person është duke shijuar rritjen e fëmijëve, duke marrë pjesë në aktivitetet që u jep atyre, apo ndonjë ndjenjë përjetimesh dhe kënaqësish.

**h. Integriteti kundrejt dëshpërimit.**

Kjo fazë fillon me moshën 65 vjeç. Gjatë kësaj kohe individi përgatitet për daljen në pension, po i afrohet, ose i ka ndodhur kjo gjë tashmë.

Erik Erikson nuk e mbështeti studimin e tij në punë eksperimentale, por e arriti atë përmes një përvoje disa vjeçare në psikoterapi, përfshi këtu punën me adoleshentë dhe shtresa të ndryshme shoqërore (Berk, 2011).

**2.4 Fenomeni i përshpejtimit “Acceleration – Akzelaracion”.**

**2.4.1. Përkufizimi**

Acceleration – vjen nga latinishtja “*acceleratio*”, që do të thotë përshpejtim. Që prej dhjetrvjetësh në vendet industriale po përshpejtohet hyrja në periudhen e pubertetit, në etapat e zhvillimit dhe përjetimit të hershëm të adoleshences. Në këtë mënyrë dhe problemet bëhen më të mprehta.

Ky fenomen është tepër i përhapur dhe tipik tashmë në qytetet me lëvizje të mëdha. Sot njerzit për arsye të lëvizjes për shkaqe sociale, si punësime, nevoja për kushte më të mira jetese, nuk janë shumë të lidhur me vendlindjen dhe tiparet tipike të tyre, kjo gjë ndikon në zhvillimin fizik dhe si pasojë ka ndikim e vet psikologjik .

Të rinjtë e sotëm e arrijnë pjekurinë tre vjet më shpejt se bashkëmoshatarët e tyre në vitet e pas luftës së parë botërore. Pra, në vetvete ky fenomen nënkupton një zhvillim të shpejtë trupor, psikik dhe emocional. Ndërkohë që kur ky zhvillim ngadalësohet, kjo krahasuar me normën, njihet si fenomeni i zhvillimit të vonë “Retardierung”, që karakterizohet nga një ose më tepër defiçite ose sjellje joadaptive (Stangl, 1997).

#### **2.4.2 Përshpejtimi skollastik “secular acceleration”**

Ky përshpejtim nënkupton zhvillimin në kohë si nga ana trupore dhe ajo psikike, gjithnjë duke u krahasuar me gjeneratat e mëparshme. Nga shumë studime është arritur në përfundimin se çdo gjeneratë paraardhëse është përcaktuese e zhvillimit fizik të brezit pasardhës, duke konsatuar që në 100 vjet, rritja mesatare në ndryshim nga paraardhësit, varion me një diferencë në rritje prej 22 cm (Stangl, 1997, cituar: Nickel, 1975).

#### **2.4.3 Përshpejtimi individual “acceleration individual” dhe i vonuar “mental retardierung”**

Përveç përshpejtimit skollastik që u trajtua më lart ekziston dhe përshpejtimi individual. Kjo dukuri përcaktohet në varësi të mjedisit, kushteve të jetesës, mënyrës të të ushqyerit etj.

Pjekuria cilësohet e përshpejtuar kur ajo fillon shumë më herët me elementët tipik të saj. Ndërkohë, në të kundërt kur tek të rinjtë pjekuria vonon shumë më vonë se mosha mesatare e pranuar, kemi të bëjmë me atë që njihet, si fenomeni “retardiert”.

## KAPITULLI III

### AGRESIONI DHE SJELLJET ANTISOCIALE NË ADOLESHENCË

#### 3.1. Qasjet teorike mbi agresivitetin

Sipas psikoanalistit Sigmund Frojd dhe etiologut Konrad Lorenz, mbështetës të teorisë së instikteve, të gjitha qëniet humane zotërojnë agresivitet që në lindjen e tyre, i cili së bashku me seksualitetin janë elementë kyç në zhvillimin e individit, duke e gjetur shprehjen e tyre në sjelljet që kryen individi.

Ndërkohë që shumë studiues, agresivitetin e trajtojnë si forcë primare ku ai mund të shkaktohet si reaksion ose frustrim i nevojave primare. Ky lloj agresiviteti vjen si rezultat i një irritimi, mund të jetë një formë përgjigje kundrejt një sulmi të paplanifikuar (Berkowitz, 1989).

Kështu sipas John Dollard në vitin 1930, si dhe Dollard dhe kolegëve të tij, Doob, Miller, Mowrer dhe Sears (1939), të cilët ngacmuan idetë psikoanalitike, hodhën hipotezën në dy drejtime:

- Agresiviteti që sjell Frustracion
- Frustracioni sjell si përgjigje të paevitueshme agresivitetin.

Me frustracion Dollard, kuptonte një bllokim të papritur të asaj që synohet të arrihet (Berkowitz, 1989). Pas disa studimeve të kryera prej tij, ai la drejtimin e parë të hipotezës, duke ju dorëzuar drejtimin të dytë të saj (Miller, 1941), pasi një gjendje e frustruar mund ose jo të çojë në agresivitet, madje sipas Varbelow (2000) pjesa e dytë e hipotezës ishte ajo që u diskutua, vlerësua dhe zhvillua në qarqet e studiuesve.



Pas shumë eksperimenteve që u kryen me fëmijët, kryesisht u konstatua se agresiviteti nuk është gjithmonë pasojë e frustracionit (Essau & Conradt, 2004).

Në 1970, një grup studiuesish mendonin se të gjithë ata që lindin me një kromozom më tepër "Y" janë të prirur të kryejnë sjellje agresive ose të shfaqin agresivitet, ndërsa sot mendohet se hormoni testosteron tek djemtë dhe estrogen tek vajzat shihen si nxitës të agresivitetit.

### **Agresiviteti mund të shfaqet në dy forma:**

**a. i hapur**, i shprehur me forma luftarake tipike tek dy sekset në moshë të hershme dhe më vonë është në rritje tek djemtë.

**b. i fshehur**, ku ketu mund të listojmë vjedhje, vënie zjarri, braktisje të shkollës, ikje nga shtëpia. Brenda këtij lloji agresivitet të fshehur hyn dhe agresiviteti marrëdhënor, që është formë indirekte dhe paraqitet tipike tek vajzat, të cilat kërkojnë dhe e realizojnë këtë përmes krijimit të lidhjeve (Varbelow, 2000).

Agresiviteti mund të jetë:

**a. i përshtatur ose i adaptuar** dhe në këto raste trajtohet me këshillime.

**b. i keqpërshtatur ose maladaptiv**, i cili trajtohet nga psikiatri.

Sipas Conner, 2004 agresiviteti mund të jetë:

1. Fizik (ky lloj agresiviteti synon të lëndojë, apo dëmtojë duke shkaktuar plagë tek të tjerët përmes të goditurit, gjuajtur apo shpuar me mjete të forta dikë apo pronën e dikujt).
2. Psikologjik (agresiviteti verbal, i cili përfshin veprime fyerje, përdorimin e një gjuhe të keqe, duke shfaqur zemërim, kërcënim, përdorim sharjesh deri në nivel sarkazme, të cilat shkaktojnë dhimbje emocionale dhe psikologjike (Sameer & Jamia, 2007)

3. Social (ky lloj agresiviteti synon të lëndojë të tjerët përmes shpifjeve, thashethemeve, si dhe refuzimin e dikujt nga grupi shoqëror)

Sipas Geen (2001) për nga mënyra e realizimit agresivitetit mund të jetë:

- a. Afektiv, i cili përfshin aktivizimin intensiv të sistemit autonom, duke stimuluar ndjenjën e simpatisë dhe rritjen e adrenalinës, të cilat shoqërohen nga modele të dallueshme të aktivitetit në sistemin nervor qendror, duke përfshirë aktivizimin e hipotalamusit, i cili rrit rrjedhjen e gjakut në muskulaturë, duke ngritur presionin dhe rrahjet e pulsit, por duke zvogëluar rrjedhjen e gjakut në organet e brendshme (Johansson, 2003).
- b. Instrumental, i cili nuk ka nevojë të ketë baza të forta emocionale, bëhet shkaktim i një dëmtimi si mjet pa patur qëllim paraprak për të shkaktuar dhimbje. Sipas Silva, 1984 agresiviteti instrumental është sjellje kundrejt një personi tjetër, që përdoret si një mjet për të siguruar ndonjë shpërblim apo për të arritur një qëllim të jashtëm. Kjo vlerësohet si të ishte një fitore. Dëmi për të tjerët është i rastit dhe nuk është i qëllimshëm apo i paravendosur.
- c. Imitativ, i cili i ka rrënjët tek teoria e të mësuarit. Ky lloj agresiviteti lidhet me imitimin e sjelljes së një individi, qoftë ky model në shoqërinë, familjen ku individi jeton apo modeli mediatic.

- d. Biogjenetik, ky lloj agresiviteti që u shfaq për një kohë të gjatë veçanërisht në Shtetet e Bashkuara, kohë kjo kur bihevizorizmi dominonte në psikologji, prandaj kjo dukuri gjeti trajtim të veçantë. Psikologët besonin se sjellja e njeriut e kishte origjinën e trashëgueshme.
- e. Teritorial, ky lloj agresiviteti drejtohet drejt mbrojtjes së një zone nga ana e një individi apo një grupi, kundër hyrjes nga të tjerët, zakonisht kjo ndodhte tek anëtarët e së njëjtës specie.

Albert Bandura, psikologu i famshëm kanadez, e fokusoi studimin e tij të agresivitetit të adoleshentëve tek teoria e të mësuarit. Bandura këmbëngul në faktin, se agresiviteti është një sjellje që mësohet.

Duke studiuar një grup fëmijësh, ai provoi se shikimi i një personi gjatë aktivitetit të tij të dhunshëm bën që tek fëmija të lind dëshira për ta kthyer këtë në një eksperiencë personale. Sipas tij agresiviteti mund të mësohet, këtu ai e vë theksin sidomos mbi agresivitetin e prezantuar në televizion dhe në media.

Skema e Albert Bandura sipas të cilës nxitet agresiviteti është : Model - vëzhgim – memorizim – përforcim – sjellje (Bandura, 1971).

Sipas Leonard Berkowitz, të gjitha qëniet e gjalla mësojnë llojet e përgjigjeve efektive një prej të cilave është dhe agresiviteti i shfaqur në situata të caktuara.

Agresiviteti mund të jetë:

- Reaktiv / teoria e agresion – frustracionit, ku nxitës mund të jenë problemet sociale, jostabiliteti familjar, dhuna apo probleme neuropsikiatrike që mund të shkaktojnë këtë formë agresiviteti.
- Proaktiv /teoria e të mësuarit, të cilët kanë peshë specifike në jetët e mëvonshme kur fillojnë të adoptohen që në vitet e shkollës fillore
- Kombinacion i dy formave të sipërpërmendura të agresivitetit. Në këtë drejtim mund të përmendet kontributi që sollën dy studiuesit Hubbard & Mathews me studimin e tyre në 2008, (Conner, 2004).

Sipas Onukwufor, 2012, disa nga tipet e agresivitetit janë:

- **Agresiviteti armiqësor**, i cili shfaqet kur qëllimi i agresorit është ti bëj keq viktimës së vet, si rezultat i inatit. Sipas studimit të Hasman dhe Silva (1984), sjellja agresive është një formë e agresivitetit që është realizuar për të arritur një qëllim jo-agresiv. Agresiviteti armiqësor është sjellje që kryhet, duke patur si qëllimin e vetëm të saj, ti shkaktojë dëm një personi tjetër. Ky lloj agresiviteti vërehet se është i shoqëruar gjithmonë nga zemërimi (Silva, 1983).
- **Agresiviteti instrumental**, zakonisht përdoret për të arritur një qëllim të caktuar, shembuj të këtij agresiviteti janë vjedhjet, rrëmbimet si dhe aktet terroriste.
- **Agresivitet relacional**, i cili zakonisht synon të çënoj statusin social të një personi të caktuar. Kërcënimi për ti dhënë fund një miqësie edhe thashethemet janë shembuj të këtij

agresiviteti (Brehm, Kassin & Fein, 2005). Sipas Sameer & Jamia, 2007, ky lloj agresiviteti ndahet në agresivitet fizik dhe verbal.

- **Agresiviteti fizik** është një formë agresiviteti që shkakton dëme si: ngacmim, vandalizëm, shkatërrim, shkulje flokësh etj.

- **Agresiviteti verbal** i cili përfshin përdorimin e një gjuhe kërcënuese apo fyerje që shkaktojnë dhimbje emocionale apo psikologjike.

Shumë studiues vazhdojnë ende të jenë të mendimit se fëmijët dhe adoleshentët janë vulnerabël kundrejt dhunës së shfaqur në media, sidomos në filma dhe televizion. Sikundër shumë prej tyre mendojnë se agresiviteti i mbartur tek qëniet njerëzore ka një bazë biologjike, duke analizuar gjithashtu se ata janë vet përgjegjës për agresivitetin apo sjelljet agresive. Agresiviteti është një nga fenomenet që janë trajtuar jo vetëm nga teoritë psikologjike, por dhe ato sociologjike.

*Sipas teorive sociologjike*, jo vetëm mos plotësimi i nevojave primare, një situatë e caktuar apo reagim kundrejt një ngacmimi e çojnë njeriun drejt sjelljeve agresive apo të dhunshme, por shpesh janë kushtet shoqërore apo socialstrukturore që e nxisin individin drejt sjelljeve të dhunshme apo agresivitetit si: pasiguria apo shpërbërja sociale ( Krall, 2004).

Teoritë më të njohura për këto fenomene janë ato të : anomisë, subkulturës dhe teoria e etiketimit social.

Termi Anomi u trajtua për herë të parë nga Emil Durkheim në kontekstin e shoqërive që kishin një zhvillim të shpejtë. Ai e përshkroi atë si një gjëndje ku mungojnë normat dhe rregullat sociale, si pasojë e prishjes së ekuilibrit apo mungesës së ekuilibrit social.

Kjo marrëdhënie jo e stabilizuar mund të shkaktojë tek të rinjtë dhe adoleshentët një çekuilibër të dukshëm, duke dobësuar efektin e normave dhe duke rritur mundësinë e akteve të dhunshme. Ndërkohë që si pasojë e kushteve sociale të konfliktit dhe mos ekzistencës së vlerave dhe normave, shfaqet si reaksion dhe dhuna individuale.

Kuptimin e mirëfilltë të strukturës së anomisë, dhuna e merr pikërisht në shkolla, ku formohet një konstelacion kushtesh që i çojnë drejt dhunës adoleshentët (Krall, 2004):

1. Hapja dhe shthurja, si eksperiencë nga izolimi apo dështimi.
2. Presioni për tu përshatur si eksperiencë nga nënshtrimi apo të qenit i pafuqishëm.
3. Probleme me ecurinë dhe arritjet në shkollë (mossukses akademik), që vijnë si eksperiencë nga mospërputhjet, humbja e sigurisë dhe ankthet për të ardhmen.

Sipas Robertz (2001 ), njerëzit në situata shoqërore të jetës së përditshme reagojnë sipas disa mënyrave.

Merton, dallon pesë prej tyre:

1. Pajtueshmëria me rregullat shoqërore.
2. Përtëritja, ku njerëzit janë të ndërgjegjshëm se cilat janë qëllimet e tyre për tu arritur, por refuzojnë përdorimin e mjeteve ligjore.

3. Ritualiteti, ku njerzit janë të destinuar të ecin në rrugën që ju paracakton shoqëria dhe nuk ndjekin më dot qëllimet e tyre.
4. Tërheqje, ku nuk kujdesesh më për normat dhe vlerat, pasi ato janë thyer nga shoqëria.
5. Rebelimi, ku sistemi i normave dhe vlerave janë shpërbërë dhe gjithkush përpiket të krijojë sistemin e vet (Merton, 1967) .

**Teoria e subkulturës** i ka fillesat e veta në studimet me grupet deviante që vijnë si pasojë e dobësimit të rregullave shoqërore. Mendohet se adoleshentët në subkulturat e tyre përmes përshtatjes me modele sjelljesh deviante arrijnë të jenë jo vetëm të njohur, por dhe të suksesshëm.

Në këtë pikëpamje sjellja e adoleshentit shihet si sjellje konform subkulturës së tyre, por ajo konsiderohet si e ndryshme dhe deviante në kontekstin social.

Teoria e Subkulturës jep një kontribut të rëndësishëm në kuptimin dhe analizimin e fenomeneve të dhunës, që më shumë vëzhgohen, në lidhje kjo me tendencën e ndryshimit të normave nga adoleshentët.

Kjo teori përpiket të analizojë fenomenin e agresivitetit dhe sjelljeve antisociale në elementë makro. Ajo që në sociologji emërtohet dhunë në psikologji shpjegohet me sjellje agresive (Wahl, 2001).

**Teoria e etiketimit** fokusohet jo më tek individi, por edhe tek kriteret dhe cilësitë e përshkrimit të sjelljeve. Kështu etiketimi nuk lidhet më vetëm me dënimin që dikush mund të ketë marrë, por ajo shtrihet në aspektin social, kur dikush thërritet kriminel, delikuent etj.

Teoria e etiketimit nuk kuptohet dhe nuk vjen si pasojë e agresivitetit dhe sjelljes antisociale direkte, por me “rolin” e agresorit apo kriminelit, si terminologji që konsolidohet brenda një shoqërie apo rrethi social (Robertz, 2001).

### ***Inteligjenca Emocionale dhe Agresiviteti***

Inteligjenca emocionale (IE) - (Emotional Intelligence, EI), është një teori e re e bazuar mbi shumën e inteligjencave, sipas të cilave qenia njerezore zotëron. Inteligjenca emocionale (IE) ka marrë tepër vëmendje në literaturë (Petrides, Pita & Kokkinaki, 2007; Saklofske, Austin & Minski, 2003; Ciarrochi & Heaven, 2008).

IE i ka rrënjët pjesërisht (1920) tek ideja i Thorndike - së mbi Inteligjencën Sociale dhe teorisë së Gardner (1993), mbi Teorinë e shumatoreve të inteligjencave” ( asaj intrapersonale, ndërpersonale etj). IE si një term u shfaq në literaturë për një kohë të gjatë (Greenspan, 1989; Leuner, 1966). Salovey dhe Mayer (1990) paraqitën, një model teorik që fokusohet në aftësitë emocionale të cilat mund të zhvillohen përmes mësimi dhe përvojës, duke parashtruar katër aftësitë qendrore: perceptimi, përdorimi, kuptimi dhe menaxhimi i emocioneve.

Agresiviteti është i lidhur drejtpërdrejt me emocionet, kështu që është dhe një faktor i rëndësishëm për përcaktimin e natyrës së një individi. Sipas Patrick, Bradley dhe Lang (1993), agresiviteti lidhet me balancimin e mekanizmave nervore që rregullojnë emocionet tona.

Një hulumtim i kryer nga Goleman (1995), rezultoi se aftësitë dhe kompetencat e IE kanë ndikim real dhe pozitiv në jetën personale të adoleshentëve si dhe jetën e tyre shkollore. Ai



gjeti se adoleshentët të cilët zotërojnë nivele të larta të inteligjencës emocionale, kanë nivele të larta të përshtatjes psikologjike dhe mirëqënie emocionale. Ata paraqesin një cilësi më të lartë dhe sasi më të madhe të rrjeteve ndërpersonale dhe mbështetjes sociale, ka pak të ngjarë të jenë përcarës, agresive apo të angazhohen në sjellje të dhunshme.

Aktualisht gjetja e metodave më të përshtatshme të matjes së IE është ende në fokus të polemikave të studiuesve (Austin, 2009; Furnham, 2003; Saklofske, 2003).

Sipas Lopes, Salovey dhe Straus (2003) marrëdhëniet në mes të IE janë përcaktuese mes marrëdhënieve të nxënësve. Studimi i tyre raportoi, se studentë të cilët paraqesin shkallë të lartë të emocioneve, të ashtushquajtura menaxhuese, shfaqnin dhe nivele të larta në lidhje me variablin e marrëdhënieve midis nxënësve.

Një hulumtim i kryer nga Johnson (2003), rreth inteligjencës emocionale të adoleshentëve dhe agresivitetit, përcaktoi se ekziston një korrelacion negativ mes inteligjencës emocionale dhe agresivitetit.

Menaxhimi i stresit dhe masat intrapersonale ishin parashikuese të agresiviteti fizik. Po gjithashtu nga ky studim rezultoi se nxënësit me IE më të lartë prirën të sillen në mënyra më të përshtatshme shoqërore. Ata sillen në një mënyrë jo-agresive në shkollë dhe si rezultat bëhen të njohur në krahasim me ata që sillen në mënyrë agresive.

Midis IE dhe sjelljeve problematike raportohet dhe në studimet e Mavroveli, (2007) ka arritur në përfundimin se adoleshentët që e perceptojnë veten si të qenit në gjendje për të rregulluar emocionet e tyre, kanë tendencë për të raportuar nivele të ulëta të sjelljeve agresive dhe atyre antisociale.

Sipas një studimi të Shahzad, Begum & Khan (2013) i cili shqyrtonte marrëdhënien mes inteligjencës emocionale dhe agresivitetit fizik, rezultoi se ka një korrelacion negativ midis tiparit të inteligjencës emocionale dhe agresivitetit fizik. Kampioni i studimit ishte i përbërë nga 140 adoleshentëve, të moshës nga 12 deri në 16 vjeç, 71 (50.7%) ishin meshkuj dhe 69 (49.3%) ishin femra, nxënës nga shkolla të ndryshme në Karaçi, Pakistan.

Pyetsori i përdorur është Trait Emotional Intelligence Questionnaire - Short Form (TEI Que -ASF; Petrides, Sangareau, Furnham & Frederickson, 2006), Aggression Questionnaire (Buss & Perry, 1992), rezultatet treguan se sa më i lartë është niveli i inteligjencës emocionale aq më i vogël është rreziku i agresivitetit fizik. Këto rezultate janë në përputhje me studimet e mëparshme të cilat vlerësojnë se shkathtësia emocionale ndërmjetëson marrëdhëniet në mes të përvojave traumatike dhe agresionit.

Liau dhe bashkëpunëtorët (2003) me studimin e tyre treguan se nxënësit e shkollave të mesme të cilët kanë nivel më të ulët të inteligjencës emocionale tregojnë nivele të larta të agresivitetit dhe sjelljeve agresive dhe janë më të përfshirë në sjellje delikente.

## **3.2 Adoleshenca dhe Agresiviteti**

### **3.2.1 Shfaqja e Agresivitetit tek adoleshentët.**

Sa herë flitet për adoleshencën ose kujtohet kjo periudhë e jetës, gjithësecili sjell në mendje një periudhë jetësore të ngarkuar jo vetëm me emocione, por dhe me konflikte (studim realizuar me studentët e masterit profesional në degën e psikologjisë klinike, Kruti, (2011). Dikush shprehet “tërmet”, dikush tjetër “jo unë”, “sa keq që kur isha adoleshent, nuk ishte kjo kohë që është sot”, “periudha më e bukur e jetës time dhe plot emocion”, “se kuptoja pse këlthisja dhe zihesha aq shumë”, “më dukej sikur askush nuk më kuptonte”.

Ndonëse adoleshenca perceptohet me të tilla komente nga të gjithë të rriturit ata shumë shpejt nuk druhen të thonë se sjelljet e tyre kanë qënë më pak agresive krahasuar kjo me atë të brezave të sotëm. Sa e vërtet është kjo ?

N.q.s. do t’i referohemi qënies njerëzore ajo zotëron agresivitet që në lindje, pse është më i shtuar agresiviteti në adoleshencë?

Studimet biologjike dhe ndryshimet e fuqishme hormonale të kësaj periudhe që pason dhe sjelljet në adult të individit, përsëri nuk do të ishin të mjaftueshme për të analizuar këtë dukuri sa shqetësuese për vetë individin, familjen dhe shoqëritë në ditët e sotme, duke qënë se shoqëria është tepër ndikuese në krijimin e personalitetit dhe zgjidhjen e konflikteve të problemeve në adoleshencë.

Pavarësisht kulturës së cilës i përket, tek adoleshenti në këtë moshë vërehet një prirje, dëshirë e shprehjes së ndjenjave me veten dhe kjo është më e shpeshtë në mbajtjen e një ditari apo shkrimeve në e-maile etj. Pyetsor i kryer me nxënës të shkollës së mesme,

Tiranë, shtator – maj (Kruti,I. 2008).

Në kulturën tonë kjo është vështirë të pranohet nga prindërit, të cilët përpiqen t'i kuptojnë fëmijët e tyre jo përmes dialogut, por leximit të këtyre shënimeve që shpesh shërbejnë si motiv i lindjes së konflikteve të ashpra.

Në një pyetje drejtuar 165 nx. nga të cilët 70 djem dhe 95 vajza të moshës 18 vjeç, ku kërkohet të shprehin një nga arsyet e fillimit të konfliktit me prindërit, 60 % e tyre janë përgjigjur se leximi i shënimeve personale, ditarit, e-maileve apo sms-ve, si dhe komentimi i tyre, kanë qënë një nga konfliktet bazë në këtë raport.

Adoleshentët e konsiderojnë këtë shkelje të privatësisë si një element të mungesës së besimit në marrëdhënien prind – fëmijë. Pyetsor i kryer me nxënës të shkollës së mesme profesionale, mars (Kruti, 2009) Tiranë.

### ***Pamje të dukurisë së agresivitetit për të dyja gjinitë (djem dhe vajza).***

Adoleshenca fillon tek vajzat një deri në dy vjet më herët se tek djemtë. Gjatë kësaj faze si djemtë dhe vajzat kanë interesa të njëjta, por vajzat në ndryshim nga faza e ashtuquajtur “pozitive”, përjetojnë para menarkës, një fazë negative, që zgjat disa muaj kohë në të cilën kanë një moskënaqësi të madhe, luhatje të humorit, gjendje depresive si dhe sjellje të çuditshme (Mutz & Scheer, 1997 cit. Schenk-Danzinger, 1988, fq.338).

Gjatë kësaj faze ato janë tepër inaktive dhe nuk arrijnë dot të mposhtin mosdëshirën, mosrehatinë, e cila qëndron përballë aktivitetit fizik.

Ka një konflikt të dukshëm midis asaj që “dua” dhe “mundem”. Nga njëra anë ato duan të përmbushin detyrimet shkollore apo aktivitetet fizike, por nga ana tjetër ato nuk arrijnë të

mposhtin mosdëshirën për këtë lloj aktiviteti fizik, sikundër vërehet një labilitet afektiv, i cili sjell një konflikt të dukshëm me prindrit dhe shokët.

Nga pikëpamja sociale, në këtë fazë, ka një konflikt mes varësisë nga familja, shkolla, grupi – bashkëmoshatarët dhe vërehet fenomeni i shkëputjes, që ato dëshirojnë të realizojnë.

Djemtë, tek të cilët kjo fazë shoqërohet më ndryshime të fuqishme të muskulaturës, gjë që shoqërohet edhe me aftësitë e arritjeve në aktivitete fizike. Fuqizimi fizik mund të shoqërohet me një agresivitet në rritje, i cili drejtohet shpesh kundrejt bashkëmoshatarëve ose kafshëve.

Sipas një studimi të kryer në Kentakin Verior mbi këtë problematikë (Shaikh, F., Viveki, R. G. & Halappanavar, A. B., 2014) raportohen vlera të rritura përsa i takon agresivitetit, ku në fokus të të studimit është rritja e niveleve të agresivitetit dhe dhunës në shkolla. Studimi hedh dritë në qartësimin e diferencave të agresivitetit në mesin e nxënësve të shkollave të mesme por dhe ndikimit të moshës dhe gjinisë në lidhje me agresivitetin.

Ky studim i kryer në një shkollë të mesme në zonë urbane që ka përfshirë 347 studentë (199 djem dhe 148 vajza, të moshës 13-16) është mbështetur mbi pyetsorin vetraportues Baron, 1977, i cili analizon format e agresivitetit të përdorura nga ana e adoleshentëve në lidhje me agresivitetin fizik (agresivitet fizik aktiv të drejtpërdrejt, të tërthortë, agresivitet fizik pasiv të drejtpërdrejtë dhe indirekt) / verbal (agresivitet verbal aktiv i drejtpërdrejtë, verbal aktiv i tërthortë, agresivitet verbal pasiv i drejtpërdrejt dhe indirekt).

Rezultatet kanë treguar se shumica e nxënësve (58.8%) rrjedhin nga familjet që nuk manifestojnë agresivitet, ndërsa 26.2% e nxënësve përjetonin apo janë pre e formave të

agresivitetit në familje, ku modeli për përdorimin e formave të agresivitetit ishin prindërit (42.3%) dhe aktorët TV / Kinema (39.0%). Në përgjithësi, 241 (69.5%) nxënës raportonin të kishin shfaqur në muajin e mëparshëm agresivitet fizik. Raportohet se agresiviti fizik aktiv, ose direkt dhe indirekte është më i zakonshëm te djemtë se sa te vajzat. 248 (71.5%) nxënës raportohet se kanë shfaqur agresivitet verbal në muajin e kaluar, ndërkohë rezulton se dhe agresiviteti fizik rritet ndjeshëm sipas moshës duke filluar me (56.9%) në moshën bazë të studimit pra 13-14 vjeç dhe rritet në (84.6%) në moshën 16 vjeç. Kjo mbështetet dhe me të dhënat nga studimi ynë mbi ndryshimet e ndikimin të nxitësve në lidhje me moshën nga 15-19 vjeç.

Në këtë periudhë djemtë e kanë të vështirë që të shprehin emocionet e tyre, sepse i riu mendon se nuk u shkon roli burror, të cilin ata po marrin. Përvojat më të kënaqshme që përgatisin ecurinë e tyre, kanë të bëjnë ose i shohin të lidhura me mjedisin.

Kjo konkretisht shihet e lidhur me zhurmat, aromat, efektin e dritës, shijet, të cilat mund t'i orientojnë dhe drejt jetës plot aventura apo prova guximi, që preferohen shumë prej djemve të kësaj moshe. Madje ata parapëlqejnë që këto aventura mos t'i ndjekin në mënyrë individuale, por së bashku me bashkëmoshatarë.

Sipas Heidemann (1979, 48), tek djemtë, kjo fazë mund të konsiderohen dhe si koha e të qenit i pagdhundur, i padurueshëm, kokëfortë, i mbyllur, i heshtur, fjalëpak, jobashkëpunues dhe jo i rregullt. Natyrisht pas këtyre sjelljeve, fshihet shpirti i një adoleshenti që përmes këtyre veprimeve kërkon të superojë ankthin dhe statusin e të qenit i pasigurt.

Për të dyja gjinitë, gjendja depressive që ata përjetojnë njihet si labilitet afektiv. Përveç mosdëshirës që shfaqin në këtë kohë, vihet re edhe një distancë emocionale që ata vendosin me personin më të afërt që kanë patur, madje vërehet dëshira për të qënë i vetëm, prandaj shpesh adoleshentët parapëlqejnë të qëndrojnë të veçuar.

Kjo periudhë kohore ndikon dukshëm veç të tjerash edhe në arritjet e tyre në mësim. Fëmija i dalluar dhe me dëshirë për të mësuar kthehet në të riun që urren mësimin, ai është i paefektshëm, i parregullt, jo i përqëndruar sikundër sjellja e tij është e luhatshme dhe pothuaj vazhdimisht në rrezik.

Tek vajzat 12 -14 vjeçare konstatohet një rënie e theksuar në arritjet shkollore, ndërsa kjo dukuri ndodh tek djemtë 14 – 15 vjeçarë. Për djemtë vërehet shpesh një mosangazhim në punë, ndërsa për vajzat duket se fillon e humbet dëshira për të mësuar. Këto të gjitha vijnë, si pasojë e ndryshimit të vlerave dhe interesave, e parë kjo në lidhje me “ mjedisin erotizues”. Përveç rënies në mësim, dëshirës për prishjen e rregullit dhe disiplinës, tek djemtë vihet re dhe dëshirë për braktisjen e shkollës.

Në literaturën bashkëkohore, mbi kryerjen e veprave penale, adoleshenti që braktiset ose përjashtohet nga bashkëmoshatarët rrezikon të bëhet lehtazi pjesë e bandave apo grupeve kriminale.

Në fëmijërinë e hershme agresiviteti shfaqet në formë verbale, ndërsa më pas merr formë luftarake. Kjo gjendje manifestohet pak a shumë në nivele të njëjta, si tek djemtë dhe vajzat, këto janë forma të hapura të agresivitetit, ndërsa më vonë ky i fundit paraqitet përgjithësisht i fshehur.

Është tepër e rëndësishme gjatë studimit që do të paraqesim të kuptohen ngjashmëritë dhe diferencat midis djemve dhe vajzave për natyrën e tyre të agresivitetit gjatë zhvillimit.

Për herë të parë vetëm në 1999, u hodh një hap i rëndësishëm duke trajtuar vajzat por dhe agresionin e tyre.

Dekada të shkuara nuk merrej në studim ky fenomen për vajzat, më në fund shkenctarët social, klinikistët, mësuesit dhe analistët i drejtuan studimet e tyre për këtë dukuri edhe tek adoleshentët.

Ideja e trajtimit të vajzave u hodh pikërisht në simpoziumin e vitit 1988 “Development of Childhood”, pasi as në simpoziumin e 1988 dhe as në botimet 1991, bota e vajzave nuk listohej, sikundër dhe agresiviteti i tyre, duke i përjashtuar ato. Për rrjedhojë dhe ndërhyrja ishte e panjohur.

Studimet disa vjeçare sollën në fokus rëndësinë e trajtimit efektiv për agresivitetin e vajzave. Agresiviteti është shpesh i ngjashëm, si tek djemtë, ashtu dhe tek vajzat dhe jo rallë çon në abuzim të hershëm seksual me të vetmin ndryshim që vajzat për shkak të shtatzanisë mundësojnë ardhjen në jetë të gjeneratave të reja, të fëmijëve me sjellje të dukshme të trashëguara agresive.

Fillimisht studimi i vajzave u përqëndrua në Amerikën e veriut.

Është e vështirë ta konsiderojmë të pavarur agresivitetin e vajzave nga ai i djemve, i cili njihet dhe ka qënë në fokus të shumë studimeve. Problemet e sjelljeve agresive dhe agresivitetit që në fëmijëri janë më prevalente tek djemtë se tek vajzat. Djemtë preferojnë të përfshihen në sjellje delikvente dhe aktivitete kriminale më tepër se vajzat. Ndërkohë që në



moshë adulte djemtë e shfaqin agresivitetin e sjelljeve të tyre kundrejt grave dhe fëmijve ose në sjellje të tjera dhune që janë tipike tek burrat dhe jo tek gratë.

Sipas prespektivës së zhvillimit, fokusimi në natyrën e agresivitetit të vajzave, shihet i lidhur me kompleksitetin e vështirësitë psiko-sociale që ky agresivitet ka, tendencë në rritje kjo tek ato që nesër do të jenë nënat e ardhshme.

Zhvillimi i agresivitetit përfshin disa faktorët nga të cilët mund të veçojmë:

- Ato individual, si: temperamenti apo vështirësitë akademike.
- Faktorët familjarë, si: abuzimi apo problemet e prindërve.
- Faktorët shoqërorë, si: izolimi social apo të jetuarit në një shoqëri konfliktuale.
- Faktorët marrëdhënore, si p.sh. Përfshirja në marrëdhënie me partner agresiv.

Problemet e agresivitetit të vajzave janë prezente dhe kontinuu (në vijueshmëri) duke filluar nga format normative të sjelljes, deri në ato ekstreme apo sulmet serioze.

Studimet kanë treguar që vajzat të cilat vazhdojnë të përdorin agresivitet fizik në fëmijërinë e dytë (gjë jo tipike,) paraqesin një risk të lartë për problemet të sjelljes në adoleshencë. Në këtë drejtim familja është një ndër faktorët kyç.

Zakonisht konfliktet në çift midis dy prindërve, kanë ndikim si tek vajzat dhe tek djemtë, por tek vajzat ndikon shumë më fuqishëm marrëdhënia midis vajzave agresive dhe nënave (Steinberg, 1988).

Sipas studimit të Husman dhe Silva (1984), rezulton se vajzat kanë tendencë për të treguar agresivitetin e tyre në një mënyrë më të pranueshme se sa djemtë. Vajzat, të cilat shprehin

agresivitet dhe kanë sjellje agresive, i zhvillojnë këto sjellje në shoqëri, kanë propabilitet më të madh që në moshë adulte të shfaqin negativitet. Kur kanë dhe miq që shfaqin të njëjtat sjellje, kjo mund të sjellë aleancë të një pushteti mbështetës ose mund të shërbejë si resurs pozitiv mbështetës.

Sipas Eron (1992) sjelljet agresive midis djemve dhe vajzave pavarësisht prirjeve biologjike apo gjenetike, shihen në mënyra të ndryshme, kjo ka të bëjë dhe me faktin se si vet ne përpiqemi të socializojmë djemtë dhe vajzat si dhe pritshmëritë që kemi për ta në shoqëritë tona, të cilat kontribuojnë në rëndësinë e incidencës diferenciale të agresivitetit. Edhe pse psikologët deklarojnë se burrat zakonisht janë më agresivë se gratë, rezultatet në lidhje me dallimet gjinore me format e agresivitetit janë të dyshimta (Guivernau dhe Duda, 2002).

Marrëdhëniet shoqërore të vajzave agresive janë shpesh ambivalente sikundër shërbejnë si kanale të pranimit të partnerëve meshkuj potencial, në kontrast kjo me vajzat që shfaqin agresivitet fizik apo agresivitet social të cilat mbartin risk më të lartë për tu arrestuar ose për të thyer ligjin në krahasim kjo me vajzat me nivel të ulët të shfaqjes së agresivitetit. Shoqëria pret që gruaja dhe njerëzit të pranojnë sjellje të ndryshme gjinore, ato janë krijuar dhe menduar si klishe. Burrat janë pranuar pothuaj në çdo kulturë që të jenë të fortë, të pavarur dhe atlet, gruaja pranohet të jenë e qetë dhe e bindur (Maxwell, 2004; Burton , 2007).

Agresivitetit fizik konsiderohet normë në fëmijërinë e hershme, por nuk mund të konsiderohet i tillë kur vazhdon në fëmijërinë e vonë dhe në adoleshencë. Është e rëndësishme të kuptohen ngjashmëritë dhe diferencat midis vajzave dhe djemve në natyrën

e tyre të agresivitetit gjatë zhvillimit, sikundër në varësi të kulturës që ato i përkasin. Duke u bazuar në disa studime, është evidente se zhvillimi i agresivitetit mbështetet nga marrëdhëniet sociale personale dhe ndërveprimi social (Delfos, 2004).

Shpesh agresiviteti dhe sjellja antisociale konsiderohen të njëjta, në fakt ka ndryshime midis tyre. Sipas studimeve disavjeçare të Blumstein, 1992 sjellja antisociale shfaqet me neglizhencë, ajo shkakton dëme në shoqëri dhe shoqërohet me agresivitet kundrejt të tjerëve. Kur dëgjojmë fjalën agresivitet fillimisht mendohet forca fizike, e cila mund të shoqërohet me shprehje verbale, aktivitet intensiv ndëshkues dhe të dhimbshëm në lidhjen konfliktuale midis dy personave sikundër shpreh dëshirën e dikujt që shpreson se duke përdorur forcën dhe mjete të ndryshme të tilla të mund të shkatërrojë reputacionin e të tjerëve.

Agresivitetit përkufizohet si një lloj stimuli që kalon nga njëri person tek tjetri, i cili synon t'i shkaktoj tjetrit dhembje, kur personi tjetër nuk e pranon.

Në aspektin psikologjik sjelljet problematike të fëmijve, studiuesi Thomas Achenbach (1993) i ndan në sipas probleme në sjellje dhe atyre emocionale :

- 1. Simptoma eksternalizuese (e jashtme),** e cila shfaqet në sjellje të pakontrolluara që shkaktojnë sjellje tipike për sindromat e brendshme.  
Këtu mund të përmenden si sjellje: a. impulsivitet b. hiperaktiviteti
- 2. Sindroma e internalizuese (e brendshme):**

Lidhet me problemet emocionale. Këtu mund të listojmë ankthin, depresionin, mossocializim etj.

Në psikiatri një pjesë e rasteve të referuara e sjelljeve agresive dhe ato antisociale trajtohen si çrregullime të personalitetit antisocial. Çdo individ klasifikohet sipas disa shkalleve dhe përmbushjes së disa kritereve. Psh. një individ që shfaq një nga simptomat e mëposhtme si: sjellje agresive, dëmtime të herë pas hershme, shkatërime të pronës së të tjerëve. Sjellje këto që janë në kundërshtim me rregullat dhe normat e një shoqërie, sikundër kur këto veprime kanë ashpërsi dhe intensitet të caktuar klasifikohen si një nga variantet e çrregullimit të personalitetit antisocial.

Në aspektin ligjor problemet e sjelljes përshkruhen, si sjellje antisociale, delikente dhe kriminale. Si antisociale sjellja konsiderohet në ato raste kur veprimi është në kundërshtim me ligjet e një shoqërie duke shkaktuar dhe viktime. Në këto raste personat ndalohen dhe çohen para drejtësisë (ku përgjithësisht lindin më vonë problemet e trajtimit të tyre në institucionet ku ata kryejnë dënimin).

Sjellja delikente, një nga arsyet e sjelljes antisociale delikente është ajo e abuzimit fizik nga prindërit. Nga studimet e fëmijëve amerikanë është vlerësuar se shumë pak prej tyre ishin dakort me rregullat e prindërve.

Fëmijët janë vëzhgues shumë të kujdesshëm, ata vëzhgojnë dhe përpiqen ti imitojnë sidomos ata që kanë afër, ata që qendrojnë rreth tyre dhe agresiviteti ndikohet fuqimisht nga sjelljet agresive apo agresiviteti që mund të shfaqin prindërit e tyre, kjo sipas

studimeve të ngjashme kryer nga Capaldi, Pears, Patterson, & Owen, 2003; Connell & Goodman, 2002; Huesmann, 1984).

Ndikimi i agresivitetit dhe sjelljeve agresive brenda famijes mund të jetë i gjatë dhe kryesisht i qëndrueshëm, kështu fëmijët rriten, tashmë adoleshentë sjelljet e tyre dhe besimi se ata janë të rritur dhe mund të sillen si të tillë, lidhet drejtpërsëdrejti me shkallën e dhunës prindërore në shtëpi, kur ata kanë qenë dëshmitarë kur ishin fëmijë (Hill & Nathan, 2008).

Studime afatgjata të kryera nga Eron, Huesmann, & Zelli, (1991); Patterson, DeBaryshe & Ramsey, (1989); McCord, (1983); Olweus, (1980, 1995) kanë identifikuar se ekziston një numër i lartë i adoleshentëve që shfaqin agresivitet, sjelljet e të cilëve kanë qenë të lidhur ngushtësisht me zhvillimin jetësor brenda familjes, ku është raportuar agresivitet i gjatë, disiplinë e rreptë, dështimi i monitorimit, refuzimi dhe indiferencë si dhe përdorimi i ashpër i dhunës fizike, studime këto

Sipas statistikës në ShBA, rezulton se 70% e personave të abuzuar shfaqnin sjellje delikvente, vetëm 10 % e personave të paabuzuar shfaqnin sjellje të tilla. Sjelljet delikvente shoqërohen me dëmtim të herëpashershëm, largime nga shtëpia, dëmtime në ambiente publike, vënie zjarri, vjedhje, braktisje të shkollës, përdorim të drogës dhe alkolit, akte vandaliste etj (Smetana, 2001).

Delikuenca përshkruhet, si sjellje e fëmijëve që hyjnë në konflikt me ligjin dhe për të cilin ata duhet të dënohen, ndërkohë që termi kriminalitet përdoret për shkelje të ligjit apo sjellje antisociale, por që i referohen më tepër moshës adulte.

Shfaqja e agresivitetit mbështetet nga marrëdhëniet sociale personale dhe ndërveprimi social. Çështje ende shumë e diskutuar ngelet nëse ky agresivitet është i lindur apo i mësuar?

Sjelljet antisociale janë shumë të përhapura tek adoleshentët, madje ato përbëjnë një nga fonemenet më shqetësuese të të gjithë shoqërive dhe kulturave, jo vetëm asaj shqiptare.

Në shoqërinë tonë për momentin konstatohet një rritje problematike e sjelljeve antisociale të adoleshentëve, gjë që është shqetësuese, prandaj kërkohet jo vetëm një vëmendje, por sidomos një zgjidhje adekuate nga familja dhe gjithë sistemi i edukimit.

Sjelljet antisociale janë studiuar më shumë se sjelljet agresive, sepse sjellja agresive është parë në kontekst të sjelljes antisociale, duke përfshirë këtu mashtrimet, apo sjellje tipike antisociale si: përdorim i substancave, delikuenca etj.

Thjesht mendohet se sjelljet antisociale dhe ato agresive janë komorbide me njëra tjetrën.

Sjellja antisociale është heterogjene e parë kjo në dy dimensione :

a. Kur kjo sjellje mbulohet me sjellje të tjera.

b. Sjellje destruktive, njeri prej tyre është agresioni që shpreh destruktivitet të lartë si dhe është opozicional me ligjin, sikundër dhuna që gjithashtu shpreh destruktivitet të lartë.

Sjellja antisociale manifestohet me forma të ndryshme të agresivitetit që mund të jetë:

joverbale përmes injormit ose izolimit të një personi ose verbale përmes vlerësimit të

drejtpërdrejt kundrejt një personi ose përdorimit të dhunës. Shpesh termi antisocial ose

asociale mund të përdoren si sinonime të njëra tjetrës, ndonëse nga psikologë të ndryshëm

preferohet termi antisocialë si antonim i fjalës prosociale, sepse kështu tingëllon më pak psikiatrike.

Ka tendenca që përgjithësisht sjelljet antisociale të trajtohen, si çrregullim i personalitetit antisocial, sjellje të cilat fillojnë në fëmijëri ose në adoleshencën e hershme dhe vazhdojnë në moshën adulte. Kur sjelljet antisociale vazhdojnë dhe në moshën 20 vjeçare, sidomos tek djemtë ato kanë tendencën të përfshihen në atë që quhet çrregullim i personalitetit antisocial, megjithë ripunimet që i janë bërë ICD - 10 si dhe DSM – IV në DSM - V, kjo moshë nuk ndryshoi (Moffitt, 1993).

Parimisht të gjithë biem dakort me përkufizimin se sjellja antisociale është çdo veprim që shkel rregullat sociale të një shoqërie apo të drejtat themelore të të tjerëve. Duke përfshirë këtu sjelljet me qëllim që të lëndojnë njëri apo dëmtime të pronës, sjellje të paligjshme kundërshtim i rregullave përgjithësisht të pranuar nga autoritetet, në rastin e adoleshentëve mungesat pa arsye në shkollë apo largime të herë pas herë nga mësimi.

N.q.s. tek fëmijët e vegjël shfaqet dukshëm nervozitet dhe impulsivitet, në një moshë më të rritur ata janë të prirur që këto sjellje të manifestohen me sjellje kriminale. Dhuna dhe delikuenca tek kjo moshë në 15 vitet e fundit është rritur ndjeshëm.

### ***Taksonomia e Moffitt mbi sjelljet Antisociale***

Sipas Moffitt (1993) dallohen dy lloj sjelljesh antisociale :

#### **a. Stabile**

#### **b. Episodike, këto tipikisht varen nga kushtet dhe zhvillimi i të riut.**

Përgjithësisht stili komunikues në familje ndikon shumë tek adoleshentët dhe sjelljet e tyre.

Situatat konfliktuale që krijohen me prindërit gjatë të cilave ata ndihen të dobët dhe të pa

mbështetur. Ky pozicion dhe perceptim tek adoleshentët ndikon direkt ose indirekt duke sjellë dhe reagime agresive.

**Për nga mënyrat e të sjellurit dallojmë:**

- a. Sjelljet opozicionale kur fëmijët kanë probleme të pranimi të autoriteteve, si prindër, edukator apo mësues, duke reaguar me inat ose agresivitet. Kjo lloj sjellje shfaqet fillimisht në moshën 3- 6 vjeçare e cila është dy ose tre herë më e shpeshtë në fëmijërinë e vonë. Ndërsa në adoleshencën e mesme vërehet tipikisht sjellja antisociale që shprehet me agresion, duke dashur të shkaktojnë dëme, kjo drejtuar personave ose objekteve. N.q.s. tek fëmijët e vegjël shfaqen dukshëm nervozitet dhe impulsivitet, në një moshë më të rritur kjo manifestohet me sjellje kriminale.
- b. Delikuenca përfshin adoleshentin nga mosha 10 -20 vjeç ajo shoqërohet me lënie apo braktisje të shkollës, konsum duhani, droge apo alkoli si dhe sjellje mashtruese.
- c. Sjellja kriminale është në shkelje të ligjit, këtu përfshihen vjedhjet, dëmtime trupore, dëmtime të objekteve dhe ambjenteve publike. Këto situata ndeshen në adoleshencën e vonë dhe në adulte. Përgjithësisht shfaqet me komorbiditet. Adoleshenti hyn në konflikt me ligjin dhe sipas tij ai duhet të dënohet. Termi kriminalitet përfshin sjelljet antisociale, por që i referohet moshës adulte. Gjithsesi delikuenca dhe kriminaliteti janë kategori të sjelljeve antisociale.



Adoleshentët, sjelljet e të cilëve në mënyrë të përsëritur thyejnë rregullat shoqërore, preferojnë të jenë sfidues kundrejt autoriteteve.

Këto sjellje janë tipike në moshë të hershme, por duhen mbajtur nën kontroll që mos të kemi çrregullime kronike të sjelljeve. Dukuri të kësaj natyre mund të jenë të dukshme dhe janë problematike shpesh për familjen, shkollën dhe shoqërinë, kur ju drejtohen vëllezërve, motrave, prindërve, shokëve dhe mësuesve, të cilat mund të shoqërohen jo rallë me abuzime verbale apo ngacmime. Këto sjellje mund të jenë dhe të fshehta.

78% e 11 vjeçarëve raportojnë sjellje delikuate minimale kundrejt shokëve, ndërsa 78% e 17 vjeçarëve raportojnë sjellje delikuate brenda grupit të shokëve (Moffit, 1993).

Në fëmijërinë e hershme shpesh ka mospërputhje, shfaqen tipare e të qënit frikacak, gënjejnë apo përgjithësisht veprojnë në fshehtësi, duke renditur këtu përdorimin e drogës, e alkolit dhe përfshihen në sjellje antisociale.

Fillimisht në Amerikë, më vonë në Europë, tashmë dhe në Shqipëri, studimet kanë treguar se vajzat janë më të prirura për të kryer sjellje antisociale në adoleshencë më tëpër sesa djemtë. N.q.s. do t'i referohemi studimit të kryer nga ISHP, tregon se mbi moshën 12 vjeç vajzat paraqiten në numër më të madh se djemtë, përse i takon konsumit të alkolit (studim i kryer në 2005).

Në vitin 2001 në një studim Kazadin raporton se nxënësit e vëzhguar në klasat e 12-ta përdornin alkol dhe drogë respektivisht 49.8% dhe 25.7%, ndërkohë që ata që raportnin vet se pinin ishin 31.3%, vetëm 4.9% raportnin se përdornin marjuhanë gjatë ditëve ose disa herë gjatë saj.

Sigurisht jo vetëm nga studiuesit, por dhe nga bisedat me edukatorët apo edukuesit pranohet se sjelljet antisociale lindin dhe formësohen në kontekstin e ndërveprimeve sociale shtrënguese brenda familjes, komunitetit dhe mjedisit edukativ. Natyrisht kjo ka ndikim nga temperamentit i fëmijës, nervozizmi, aftësitë njohëse apo ekspozimi ndaj dhunës.

### **3.2.2 Studime mbi agresivitetin e adoleshentëve**

Të gjitha shoqëritë njerëzore, kush më shumë e kush më pak, në varësi të zhvillimit të tyre historik, social- shoqëror, kanë njohur, si fenomenin e agresivitetit ashtu dhe sjelljeve antisociale. Shpesh shoqëritë ku është paranoar ky fenomen, si normë i kanë justifikuar sjellje të tilla me kulturën, apo për arsye fetare. Kështu në Indinë e Veriut një vllazëri kriminale nga 1550- 1850, mbytën më tepër se dy milionë njerëz, për t'i shërbyer sipas tyre perëndeshës së tyre (Myers, 1999).

Vitet 90' në SHBA, Europë dhe më specifikuisht në Britani e Gjermani, njihet si një periudhë e rritjes së frikshme të fenomenit të agresivitetit në përgjithësi, në shoqëritë përkatëse dhe sidomos në adoleshencë.

Në SHBA, në 1990, mendohej se ishte ulur shkalla e agresivitetit, ndërkohë që në këto vite numri i arrestimeve për dhunë i adoleshentëve, arrinte një milion në vit, shifër kjo pesëfish më e lartë se në 1960 ( Myers G.D , 1999).

Gjatë viteve 1968, 1981, 1995, Berkowitz, eksperimentoi me fëmijë dhe me studentët e Universitetit të Uiskonsinit, të parëve duke u dhënë një armë lodër për të luajtur, të dytëve duke ju vendosur pranë një armë zjarri. Rezultatet ishin pothuajse të njëjta, fëmijët më pas

manifestuan dëshirë të shtuar për të prishur lojën e fëmijve të tjerë, ndërsa studentët e inatosur dërgonin më shpesh shkarkesa të “viktimat”, duke provuar se armët krijojnë mendime të dhunshme (Myers, 1999).

Gjatë viteve dhe në kushte të ndryshme social kulturore, studimet empirike filluan të jenë shumë më specifike. Kështu në 2002, studimet e kryera në SHBA mbi agresivitetin fizik, verbal dhe atë indirekt të adoleshentëve, treguan se një në pesë fëmijë ngacmonte të tjerët, më shumë se një në tre nxënës të shkollave të mesme manifestonin sulm fizik. Afro 30-40% e meshkujve adoleshentë dhe 16-32% e femrave, kishin kryer vepra penale të dhunshme në moshën 17 vjeç (National Youth Violence Prevention Resource Center, 2002).

Sipas një analize të studimeve empirike në ShBA, në vitin 2008, në të cilën ishin përfshirë 73.498 adoleshentë që i referohej ndryshimeve gjinore, tregoi se diferenca e agresionit fizik tek djemtë ishte shumë më e fortë se tek vajzat dhe e kundërta ndodhte për agresivitetin verbal, ku vajza shfaqnin nivel 54% krahasuar me djemtë 46% , të njëjtën gjë dhe me po të njëjtat vlera vërteton dhe studimi më i fundit nga Universiteti i Kalifornisë në dhjetor të 2012 (Card, Sawalani, Stucky & Little, 2008; Juvonen, Wang & Espinoza, 2012) .

Studimet e mëtejshme empirike për adoleshentët amerikanë nga 15-18 vjeç në 2011, treguan se 32.8% e tyre shfaqnin agresivitet fizik jashtë shkolle, 40.7% e të cilëve ishin meshkuj dhe 24.4% femra, ndërkohë që në shkollë shfaqnin agresivitet fizik 12% e tyre nga të cilët 16% ishin meshkuj dhe 7.8% ishin femra ( National Center for Injury Prevention and Control. Division of Violence Prevention 2012).

Në Kanada gjithashtu ka patur studime të vazhdueshme për fenomenin e agresivitetit. Në një prej studimeve, tepër interesante, është ai i vitit 2007 mbi agresivitetin fizik dhe emocional në çiftet e adoleshentëve heteroseksualë, i cili tregoi se 20- 50% e këtyre çifteve ishin përfshirë në lidhje agresive. Rezultatet u mbështetën në raportimet si, të djemve ashtu dhe të vajzave, si të atyre që kanë qenë agresivë dhe po ashtu të atyre që kanë qenë viktima (Conolly & Josephson, 2007).

Por studime të tilla janë bërë dhe në Britani. Për periudhën 1985- 1995 rezultoi një rritje e krimeve të dhunshme në 84% në krahasim me dhjetëvjeçarët e kaluar (Myers, 1999). Gjatë viteve 2005- 2012 në bazë të të dhënave të vrasjeve të adoleshentëve në Britani, ato treguan se 40% e tyre ishin goditur me thikë dhe 6-7% e tyre ishin kryer me armë zjarri (London, 2005 to 2013 Mapping the Location and Victim Profile of Teenage Murders).

Në Gjermani, deri në vitet 90', kishte mungesë të studimeve empirike, ndonëse dhe më parë ky vend kishte përjetuar disa lëvizje të fuqishme shoqërore (përkatësisht lëvizjet e studentëve të 1950-1960, apo ato të 1970-1980) që kanë ndikuar në historinë e këtij kombi nuk kishin kryer studime empirike. Studimet e mirëfillta empirike u kryen në vitet 1990-1998 nga Instituti i Qendrës së Kërkimit Shkencor të Shkencave Sociale dhe Psikologjike pranë Universitetit të Nürenbergut, me adoleshentë të moshës 14- 21 vjeç, që treguan nivel të lartë të agresivitetit. Kjo bëri që qeveritë të ndërmerinin programe të shtrira në një periudhë kohore dy vjeçare për uljen e agresivitetit në shkolla. Nga studimi i kryer në 2000, pas përfundimit të programit, rezultoi se shkalla e agresivitetit tek këta adoleshentë ishte ulur në 15-30%.

Studimi i kryer nga Instituti i Studimeve Kriminale në bashkëpunim me disa universitete dhe qendra shkencore universitare në 2003, sikundër përsëri në bashkëpunim me Institutin e Qendrës së Kërkimit Shkencor të Shkencave Sociale dhe Psikologjike pranë Universitetit të Nürenbergut dhe Kiel, i kryer me adoleshentë të moshave shkollore nga 14- 18 vjeç, tregoi se 43.9% e tyre kishin ushtruar agresivitet fizik dhe verbal brenda shkollës. Ky rezultat u arrit sipas asaj që raportonin vet nxënësit, ndërkohë që 13% e tyre kishin qënë viktimë e vjedhjeve, ndërsa 8% ishin kërcënuar nga bashkëmoshatarët e tyre me thikë apo pistoletë. Ndërkohë që raportimi i mësuesve tregonte se agresiviteti jashtë shkolle ishte më i lartë se ato që deklaroheshin brenda saj. Kështu nga studimi rezultoi se 61.8% e adoleshentëve të këtyre shkollave ishin pjesë e grupeve të dhunshme jashtë shkollës, pjesa më e madhe ishin meshkuj, por nuk ishin të pakët dhe rastet e femrave të përfshirë në to (Lösel, & Bliesener, 2003).

Një studim i kryer së fundi nga dy profesor të Shkencave Sociale të Fakultetit të Psikologjisë mbi agresivitetin fizik dhe verbal të adoleshtëve në Spanjë, tregoi se agresiviteti fizik dhe ai verbal ishte më i lartë tek djemtë. Agresiviteti verbal rezultoi të ishte pothuaj se i njëjtë, me një diferencë të papërfillshme me atë të vajzave (Pena & Pacheco, 2012).

### **3.3 Faktorët që ndikojnë në rritjen e agresivitetit dhe të sjelljeve antisociale.**

Shkaqet e mundshme të agresivitetit sipas studiuesve janë të ndryshme, të cilat lëvizin në varësi të kulturës, por ato që mund të veçojmë për çdo shoqëri janë: fiziologjik- organikë, mjedisor ,social, kulturorë, familja, shkolla dhe personaliteti.

- Faktorët fiziologjik, ku një rol të rëndësishëm luajnë ata hormonal si estrogeni dhe testosteroni, prodhimi me shumicë i të cilëve gjatë pjekurisë seksuale në adoleshencë, nxit sjellje agresive, apo roli i neurotransmetuasit serotoninë që rrit gjithashtu agresivitetin.
- Faktorët organikë – këtu mund të përmendim gjendjet psikologjike tipike të luhatshme në adoleshencë, apo ndjeshmëritë si faktorë që dukshëm nxitin agresivitet.
- Faktorët mjedisor dhe social – sa mbështetës mund të jenë ata në zbutjen e agresivitetit ose në të kundërt në nxitjen e shprehjes së tij (Vasta & Haith, 2007).
- Faktorët kulturorë dhe historikë gjithashtu renditen në shkaktarë të agresivitetit.

Një numur i konsiderueshëm studiuesish në varësi të shkollave të cilave u përkasin apo teorisë që kanë përfaqësuar, përpiqen të jenë korrekt duke bërë një ndarje mes shkaqeve të agresivitetit që u përmendën më lartë dhe atyre faktorëve që ndikojnë në rritje e tij, si: ato shoqërore, media, mënyra si kalojnë kohën e lirë, familja, shkolla (Rutter, Giller & Hagell, 1998).

Kërkimet e fundit shkencore kanë tendencë t'i konsiderojnë sjelljet antisociale më shumë si probleme shëndetësore se sa si sjellje të mirëfillta kriminale.

E thënë ndryshe, kjo formë e dhunës duhet t'i atribuohet një irritimi biokimik, ose më saktë, prezencës së ulët në gjak të kortizolit (hormonit antistres). Një pohim i tillë vjen nga disa studiues të Universitetit të Cambridge në Londër.

Përballë një situatë stresuese, sekrecionet e kortizolit në gjak rriten dhe hormonet e ndihmojnë një person të kontrollojë emocionet, veçanërisht temperamentin dhe impulsin e dhunshëm, duke e bërë më të qetë.

Adoleshentët që janë më të prirur për t'u bërë të dhunshëm ndaj të tjerëve si në mënyrë verbale dhe në atë fizike, nuk e kanë këtë tip hormonal. Kjo shpjegon edhe dukurinë e sjelljeve agresive të të rinjve, që mund të jenë të lidhura në një farë mënyre me një çrregullim organik.

### **3.3.1 Predispozicioni biologjik/ gjenetikë.**

Faktorët gjenetikë mendohet se kontribuojnë ndjeshëm në zhvillimin e sjelljeve antisociale. Ato përfshijnë dhe pjesën ballore të trurit dhe mendohet se luajnë një rol në një predispozitë të trashëguar për sjellje antisociale. Rreziqet që vijnë nga faktorët neurobiologjik, shkaktohen p.sh. nga përdorimi i drogës dhe alkolit nga nënat gjatë shtatzanisë, komplikacionet, si pesha apo dëmtime të trurit gjatë lindjes.

### **3.3.2 Faktorët psikologjikë (temperamenti apo personaliteti).**

Mendohet se fëmija ndikohet që në bark të nënës nga sjelljet e saj agresive apo ato antisociale. Në formimin e personalitetit të tij, ndikojnë eksperiencat në fëmijëri.

Por studimet empirike kanë treguar se cilësi të caktuara të personalitetit që lidhen me sjelljet antisociale apo agresive janë: mungesa e empatisë, temperamentit i vështirë, impulsivitet, hiperaktiviteti (Baier, 2011) etj.

Një cilësi tjetër e personalitetit të rinjëve mund të jetë dhe deficitin në përpunimin e informacionit, që lidhet me zhvillimin e tij konjitiv. Adolehentët të tillë zakonisht i japin një domethënie të caktuar intonacionit të përdorur duke i dhënë konotacion negativ një shprehje edhe kur ajo nuk është thënë me qëllim negativ.

### **3.3.3 Faktorët familjarë**

Disa nga faktorët që ndikojnë në rritjen e shfaqjes së fenomeneve, si sjelljeve antisociale dhe agresive janë: Historia e sjelljeve antisociale dhe agresiviteti prindëror, alkolizimi i tyre dhe abuzimet me drogën, jeta kaotike dhe e paqëndrueshme në shtëpi (Moffitt, 1993). Ndikojnë gjithashtu mungesa e aftësive të mira prindërore, përdorimi i ndëshkimeve trupore, divorci, apo çrregullime psikiatrike të prindërve, sidomos te nënat si dhe problemet ekonomike të cilat rrjedhin për shkak të varfërisë dhe papunësisë (Kazdin, 2005).

### **3.3.4 Faktorët psiko-socialë.**

Faktorët psikosocialë ndikojnë në zhvillimin e agresivitetit dhe sjelljeve antisociale. Institucionet e caktuara, si familja, shkolla dhe shoqëria luajnë një rol kyç. Zakonisht tek adolehentët ka ndikim sidomos statusi social apo ekonomik i familjeve, mënyra e edukimit, dhuna fizike apo psikike e përdorur kundrejt tyre në familje, shkolla dhe media (Hartung, 2006). Shoqëria në varësi të kulturës luan rol në nxitjen e sjelljeve antisociale.



### **3.3.5 Grupi social dhe shkolla**

Burim agresiviteti dhe shtim i sjelljeve antisociale sjell edhe mbijetesa pas migracionit, emigracionit si dhe gjatë tij. Fëmijët e familjeve që kanë ndryshuar vendbanimin dhe janë shpërngulur nga një zonë në tjetrën. Fëmijë të tillë, janë shpesh objekt dhe subjekte të sjelljeve antisociale dhe agresivitetit. Ata lëvizin midis kulturave dhe shpesh sjellje të tilla i ndihmojnë për tu identifikuar (Knapp, 2009).

Studimet kanë treguar se p.sh. tek djemtë, shokët reciprokisht kanë nxitur ose përforcuar sjelljet antisociale (Baier & Pfeiffer, 2011). Shkollat janë vendet ku më së shumti nxitin dhe shtojnë agresivitetin dhe sjelljet antisociale. Sipas studimeve kjo dukuri është tipike në shkollat dhe klasat e mëdha, ku mundësitë e kontaktit midis mësuesve dhe nxënësve janë të pakta. Shpesh shkak i sjelljeve agresive të adoleshentëve janë vet mësuesit, të cilët përdorin notën si dënim apo përdorimi i disa etiketime jo të duhura.

### **3.3.6 Media**

Një nga faktorët e tjerë që ndikon në shtimin e sjelljeve antisociale dhe agresivitetit është media e cila është kryesisht ndikuese, kjo lidhet me prejardhjen e tyre familjare dhe kontekstin social në të cilin ata jetojnë, ambjenti social shërben si kusht paraprak për zhvillimin e këtyre sjellje (Oerter, 2004).

Adoleshentët ende të pandërgjegjshëm për rolin e tyre gjinor, apasionohen nga çfarë u ofron media si: lojrat kompjuterike, filmat, skicimet me burra muskuloz dhe veprime të fuqishme. Këto skena bëhen risk për jetën e tyre sociale kur ata i marrin këto role dhe në

jetë. Familjet duhet të kujdesen ti shmangin të rinjtë nga hapja kundrejt botës së pambrojtur mediatike, para të cilës ata ndodhen e ku është e pamundur që ata të eksperimentojnë pa pasoja (Böhnisch, 2012).

Ndikuese tek adoleshentët paraqitet dhuna dhe pushteti, që i bën persona të famshëm në jetë, ku si mjet për të arritur qëllimin ata përdorin sjelljet antisociale apo agresivitetin duke shërbyer si të vetmet zgjidhje të konflikteve apo problemeve me të cilat ato ndeshen në jetë. Studimet tregojnë se nga këto sjellje nuk preken vetëm djemtë, por dhe vajzat (Hartung, 2006).

Sipas Varbelow (2002) media e ka ndikimin e vet që në fëmijërinë ajo ndikon tek ata në disa drejtime si: efektivitet në zgjidhjen e problemeve, aspektin normativ, matshmëri dhe në aspektin e ndjeshmërisë.

Studimet tregojnë për ndikimin që media luan në jetën e të rinjve adoleshentë (Bierhoff, 2006). Referuar literaturës një nga arsytet e niveleve të larta të agresivitetit, sipas tyre janë ndjekja e video lojërave të dhunshme të cilat ndikojnë fillimisht në komponentin konjitiv dhe lidhjes që ekziston mes tij dhe formave të ndryshme që mund të rezultojnë më pas me agresivitet (Anderson & Bushman, 2002).

## KAPITULLI IV

### **Adoeshenca dhe agresiviteti në kontekstin Shqiptar**

#### *Vështrim i Përgjithshëm mbi Realitetin Shqiptar*

#### **4.1 Vështrim historik i kulturës së adoleshentëve në Shqipëri**

Jeta kulturore e të rinjve shqiptarë ka kaluar në disa faza zhvillimi, kjo në përputhje me evoluimin e shoqërisë tonë. Jeta e të rinjve, në varësi të zonës ku jetohej pavërsisht nëse ishte zonë rurale apo qytetare, zhvillohej në përputhje me atë çfarë ju kërkohet nga familja, pasi dhe edukimi mbështetej fort tek mundësitë që u ofronte familja. Funksionimi i shkollave në Shqipëri për arsye që lidhen fort me historinë e kombit tonë, daton vonë dhe për rrjedhojë jeta kulturore ishte tepër e kufizuar.

Të rinjtë përfshiheshin parakohe në jetën aktive që lidhej me zhvillimet sociale të vendit, edukimi ishte i tipit spartan, ata kanë qënë pjesëmarrës aktiv në të gjitha lëvizjet më të rëndësishme historike të vendit.

Gjatë viteve të komunizmit jeta kulturore ishte e fokusuar vetëm në aktivitetet e planifikuara, të rinjtë në shkollë përqëndroheshin kryesisht në aktivitete sportive, kulturore, muzikore. Të rinjtë duhet të ishin të denjë për ti shërbyer ideologjisë sunduese, mbi këto kritere bëhej dhe vlerësimi i tyre.

Të rinjtë duhet të ishin të aftë të përgatiteshin ushtarakisht dhe të ishin të denjë për shoqërinë komuniste. Jeta private ishte e privuar dhe e ndërvarur ndaj asaj kolektive.

Të rinjtë e viteve 90', ishin të parët që tentuan të ndryshonin jetën politike - kulturore.

Për herë të parë filluan të hapeshin diskotekat, ndonëse muzika që ato ndiqnin ishte me kaseta ose magnetofon, madje ato hapeshin në mëngjes dhe kishin fluks rreth orës 14:00. Të rinjtë filluan të kishin, si në botë këngëtarët e tyre të preferuar, por ishin disi të larguar nga aktivitetet e mëparshme.


Gjatë kësaj periudhe deri në ditët e sotme jeta kulturore e të rinjve ka ndryshuar shumë.

Ata njohin mirë muzikën, bëjnë pjesë në grupe dhe kërkojnë të afirmohen përmes pjesëmarrjes në edicione ku ata mund të zhvillojnë dhe përfaqësojnë denjësisht pasionet dhe dëshirat e tyre. Sot mund të gjejmë grupe Hip- Pop, Tekno, Pop, Rock etj

Të rinjtë i përkushtohen sipas mundësive, që u krijohen, aktiviteteve sportive, shkojnë në palestra të ndryshme, merren me not etj. por kjo gjithmonë me financimin e prindërve, pasi shkollat nuk ofrojnë mundësinë e zhvillimit të aktiviteteve të tilla.

#### 4.1.1 Dinamikat e faktorëve të riskut tek adoleshentët

**Grafiku 1:** Dinamikat e faktorëve të riskut tek adoleshentët



### ***Sjelljet agresive***

Katër prej nxitësve kryesor, individual, familja, shoqëria dhe shkolla, që ndikojnë agresivitetin si dhe sjelljet agresive, jo gjithmonë lidhen me dëshirën e brendshme të adoleshentëve për të kryer këto sjellje, shpesh ato mund të vijnë si rezultat i një mjedisi që nxit sjelljet agresive të tyre.

### ***Kuadri Ligjor në Vendin tonë***

Zbatimi i ligjit është një variabël tepër i rëndësishëm dhe specifikisht ka procedura ligjore që çojnë në reduktimin kryesisht të gjitha sjelljeve auditive të adoleshentëve, si përdorimi i llojeve të ndryshme të drogave, blerja apo shitja e tyre, por dënimet më të ashpra lidhen me dëmtimet fizike kundrejt këto të tjerëve apo dhe objekteve. Këto të fundit zakonisht në botë i detyrojnë adoleshentët për kryerjen e punëve sociale në dobi të shoqërisë, përveç dëmshpërblimit material të dëmit të kryer prej tyre.

Problem aktual është aplikimi i masave drastike në lidhje me dëmtimet fizike, ku adoleshentët ose përjashtohen nga shkolla, ose pasi vënë në rrezik jetën e të tjerëve, kryejnë dënimin me kriminelë të rritur.

Këto forma ligjore mund të sjellin efektin e kundërt edukativ për adoleshentët. Në vend të kemi reduktim të agresivitetit, mund të kemi agravim të përdorimit të këtyre formave. Kjo natyrisht në një kohë kur vet agresiviteti vjen dhe si një formë reagimi kundrejt figurave autoritare, si në familje, shkollë dhe shoqëri, që përfaqësohet nga: prindërit, mësuesit dhe prania e figurave autoritare që nuk mund të përjashtohet në mjediset e kryerjes së dëimit.

### *Normat social-shoqërore*

Normat i referohen asaj çfarë pranohet ose jo në shoqëri . Këto norma kanë të bëjnë pa dyshim me pritshmëritë sociale për të dyja gjinitë. Vet normat social- kulturor – shoqërore të një vendi janë ato që përcaktojnë atë kundrejt të cilës adoleshenti shihet si devijues.

Prania e psikologut në shkolla sugjerohet, si një institucion, që parimisht duhet të ndikojë në reduktim të sjelljeve antisociale dhe agresive dhe kjo jo vetëm brenda mjedisit shkollor. Në gjithë botën, kur ka tendencë të sjelljeve agresive, adoleshentët referohen tek psikologu dhe pikërisht me qëllimin e mos agravimit të këtyre sjelljeve tek adoleshentët në jetën e tyre të mëvonshme.

#### **4.1.2 Legjislacioni Shqiptar dhe Penalitetet kundrejt Adoloshentëve**

Referuar të drejtave të shtetit shqiptar ligji bazë i shtetit sikundër Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi i Procedurës Penale kanë të përcaktuara, si detyrimet dhe të drejtat, mbrojtjen dhe penalitetet për të rinjtë edhe të grupmoshës që përfshihen në këtë studim.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 54 pika 1. garanton për: Fëmijët dhe të rinjtë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti dhe po sipas këtij neni, pika 3: Çdo fëmijë ka të drejtë të mbrohet nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, veçanërisht për punën e fëmijëve nën moshën minimale, e cila mund të sjell dëmtim të shëndetit, moralit ose mund të rrezikojë jetën apo zhvillimin normal të tyre. Çdo shtetasi dhe kur i hiqet e drejta e lirisë nuk përcaktohet grupmosha.

Referuar po Kushtetutës së Shqipërisë, nenit 55 pika 1, përcakton se të gjithë shtetasit, gëzojnë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti, në mënyrë të barabartë, ndërsa sipas pikës 2. Të miturit gëzojnë të drejtat e poshtëshënuara në ligjin Shqiptar:

Kodi i Procedurës Civile 2012, ligji nr.8116, datë 29.3.1996 dhe i ndryshuar me ligjet nr.9953, datë 14.7.2008, nr.10 052, datë 29.12.2008; nr.8812, datë 17.5.2001; nr.8491, datë 27.5.1999; nr.8535, datë 18.10.1999; nr.8431, datë 14.12.1998 në nenin 44 thuhet se paditë kundër të miturve, të cilët ende nuk kanë mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, ose kundër të gjithë personave që u është hequr zotësia për të vepruar, përcaktohet pranë gjykatës së vendit ku banojnë, përfaqësuesi i tyre ligjor.

Po sipas këtij kodi, neni 173, për gjykimin me dyer të mbyllura (neni 47, ndryshuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001) thuhet se nuk lejohet qëndrimi i personave të mitur, të cilët janë nën 16 vjeç, në seancë gjyqësore me dyer të mbyllura, përveç rasteve kur ata thirren nga gjykata.

Gjykata jo gjithmonë lejon pjesëmarrjen e organeve të medias, apo publik gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor: pika ç përcakton se: kjo ndodh kur është në interes të të miturve, ose mbrojtja e jetës private të pjesëmarrësve apo palëve në gjyq.

Po sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës Së Shqipërisë, Tetor 2011, ligji nr.7905, datë 21.3.1995 (i përditësuar) dhe në mbështetje të ligjit nr.7491, të nenit 16, datë 29.4.1991 dhe nenit aktual 103 mbi ndalimin e publikimit të aktit, sipas pikës nr. 4. përcakton se: ndalohet publikimi i gjeneraliteteve dhe i fotografive të individëve të pandehur dhe dëshmitarë të mitur, qofshin këta të akuzuar ose të dëmtuar për vepra penale. Gjykata mund të lejojë publikimin vetëm kur është në interesat e të miturit, ose kur individi i mituri ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç.

Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, Tetor 2011, Ligj Nr.7905, datë 21.3.1995 (i përditësuar). Në mbështetje të të cilit neni nr. 16 i ligjit 7491, datë 29.4.1991, mbi arrestimin në flagranë të kryerjes së një krimi apo kundravajtjeje penale neni 340 përcakton në rastet e gjykimit me dyer të mbyllura pikat si më poshtë ku: 1. Gjykata vendos që shqyrtimi gjyqësor, ose disa seanca të tij të zhvillohen me dyer të mbyllura kjo sipas pikës: a. kur publiciteti mund të dëmtojë moralin shoqëror të individit/ëve ose mund të sjellë përhapjen e të dhënave që duhet të mbahen sekret, si dhe pika ç. kur gjykohet e nevojshme në pyetjen e individëve të mitur.

Ndërkohë që në shumë raste merret psikolog në vlerësimin mendor të adoleshentëve, sepse sipas nenit 235 garantohet ndalimi i pyetjes së tyre si dëshmitar : Nuk mund të pyeten si dëshmitarë si dhe të mund bëjnë dëshmi të rregullt: - personat që nuk janë të aftë të kuptojnë si duhet faktet, për shkak të të metave fizike ose psikike, të cilat kanë rëndësi për çështjen, këtu përfshihen dhe individët e miturit nën moshën katërmëdhjetë vjeç.

Përrjashtim përbëjnë rastet kur thëniet e tyre janë të domosdoshme për zgjidhjen e çështjes. Në këto raste këta persona vendosin me vullnet të plotë nëse do të dëshmojnë si dhe nuk mund të dënohen në rast refuzimi për të bërë dëshmi. Kjo e drejtë përacaktohet me ligj sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës Së Shqipërisë, Tetor 2011, Ligj Nr.7905, datë 21.3.1995 (i përditësuar).

Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 për dispozitat kryesore kushtetuese ku neni 35, sipas pikës një, të këtij ligji përcakton ndihmën që i jepet individit të pandehur të mitur. Sipas tij individit të pandehur, të mitur, i sigurohet ndihmë juridike dhe psikologjike në të gjitha shkallët e procedimit, duke siguruar madje dhe praninë e prindit,



ose të personave të tjerë të kërkuar nga i mituri, por këta gjithnjë pasi të jenë pranuar nga autoriteti procedues.

Në vijueshmëri në lidhje me të miturit neni 42 i po këtij ligji përcakton se dhe verifikimi i të pandehurit të mitur bëhet si më poshtë:

1. Organi procedues mbledh të dhënat të të pandehurit të mitur për kushtet e jetesës personale, familjare dhe ato shoqërore, me qëllim që të njihet me mirë me përgjegjshmërinë dhe shkallën e përgjegjësisë. Kjo i jep mundësi organit procedues të vlerësojë rëndësinë shoqërore të fakteve si dhe në caktimin e masave të përshtatshme penale.

2. Organi procedues merr informacione nga individët që kanë patur marrëdhënie me të miturin si dhe dëgjon mendimin e ekspertëve.

Në fakt në rastet e kriterëve të caktimit të masave të sigurimit personal ky kod përcakton në nenin 229, pika 3 se: Kur i pandehuri është i mitur gjykata mban parasysht kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative konkrete.

Në fakt sipas nenit 230 të po këtij kodi për Kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg, pika 4 përcakton se: Të miturit nuk mund të arrestohen kur akuzohen për kundërvajtje penale. Kjo në fakt bie në kundërshtim me nene të po këtij kodi dhe për më shumë me Kodin Penal që do të trajtojmë më poshtë.

Mbështetur në Kodin Penal për arrestimin në flagrancë dhe ndalimin, neni 251 nuk përcakton asnjë klauzolë, që të përjashtojë të miturit apo adoleshentët në veçanti.

Në pikën një të këtij ligji shprehet qartazi se: Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kryejnë detyrimisht arrestimin e cilit do individë, që kapet në flagrancë për një krim me

dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë. Ligji cakton një dënimin me burgim jo më të ulët se pesë vjet.

Sipas Kodit të Procedurës Civile dhe Penale sikundër Kodit Penal të rinjtë që kryejn veprat e mëposhtme, lidhen drejtpërsëdrejti me llojet e agresionit si dhe marrin masat dhe dënimet e përcaktuara.

Kështu në përputhje me Kodin e Procedurës Civile 2012, ligji nr.8116, datë 29.3.1996 dhe të ndryshuar me ligjet nr.9953, datë 14.7.2008, nr.10 052; datë 29.12.2008, nr.8812; datë 17.5.2001; nr.8491, datë 27.5.1999; nr.8535, datë 18.10.1999; nr.8431, datë 14.12.1998, neni shtatë përcakton se: Fakt quhet çdo sjellje e individit, ngjarje shoqërore apo fenomen natyror, të cilit ligji i ngarkon një pasojë juridike.

Ndërkohë sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr.7895, datë 27.1.1995, në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, date 29.4.1991, Kreu II mbi Përgjegjësinë Penale, neni 12, moshë për përgjegjësi penale përkufizohet si më poshtë:

Individi, i cili në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, mban përgjegjësi penale. Individi, që kryen një kundërvajtje penale, kur ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç ka përgjegjësi penale.

Kjo moshë është tipike për eksperimentimet me lëndët e ndaluar që sjellin shpesh turbullime psikike ose neuropsikike, është pikërisht neni 17, që përcakton papërgjegjshmërinë për shkak të gjendjes mendore në këtë kod, i cili specifikon qartazi problemet e mundshme mbi gjendjen mendore dhe psikike të individit ku përcaktohet se: Personi që në kohën e kryerjes së veprës vuante nga një shqetësim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka mundur të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se po kryen vepër penale nuk ka

përgjegjësi penale. Këto rrethana mbahen parasysh nga gjykata në caktimin e masës dhe llojit të dënimit.

Përgjegjësia penale ndryshon në vende të ndryshme.

Bazuar në të dhënave “Manual trajnimi për profesionistët që punojnë me fëmijët në sistemin e vuajtjes së dënimit”, Sota, M.; Sufaj, F. & Gjoka, R. (2012). Save the Children, Infobotues, Tiranë, fq. 13, ofrohen të dhënat e mëposhtme, ku paraqitet mosha e përgjegjesisë penale në vendet e BE, e cila është si vijon:

**Tabela 1:** Mosha e përgjegjesisë penale në vendet e BE

Austria 14	Belgjika 16*/**18	Britania e Madhe 10
Bullgaria 14	Danimarka 15	Estonia 14
Finlanda 15	Franca 10***/13	Gjermania 14
Greqia 8***/13	Holanda 12	Hungaria 14
Irlanda 12	Italia 14 Qipro 7	Lituania 14**/16
Letonia 14	Luksemburgu 10	Malta 9
Polonia 13	Portugalia 12****/16	Rep. Çeke 15
Rumania 14**/16	Slovakia 14/15	Slllovenia 14**/16
Spanja 14	Suedia 15	
<i>(shënim për shenjat: *vetëm për shkelje trafiku, **për krime serioze, ***vetëm masa edukative, ****mbrojtje e veçantë e fëmijëve)</i>		

Burime: Marrë nga “Manual trajnimi për profesionistët që punojnë me fëmijët në sistemin e vuajtjes së dënimit” (2012).

Po sipas Kodit Penal në Republikën e Shqipërisë, Kreu II mbi Veprat Penale Kundër Personit, përkatësisht për Krimet Kundër Jetës në seksioni e parë përfshihen Krimet Kundër Jetës të kryera këto me dashje, nenit 76 mbi vrasjen me dashje shprehet se:

Vrasja e kryer me dashje dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Ndërsa sipas nenit 78 mbi Vrasjen me paramendim përcaktohet se një vrasje e kryer me paramendim, dënohet me burgim duke filluar nga pesëmbëdhjetë deri në njëzetë e pesë vjet dhe kur ka rrethana rënduese dënimi mund të shkojë deri në burgim të përjetshëm.

Neni 84 mbi kanosjen përcakton se: Kanosja serioze për vrasje, ose plagosja e rëndë që bëhet kundrejt një individi, dënohet me burgim deri në një vit ose me gjobë pasi përbën kundërvajtje penale.

Ndërsa neni 89 mbi plagosjen e lehtë me dashje shprehet se: Plagosja e kryer me dashje, e cila shkakton paaftësi të përkohshme në punë për më tepër se nëntë ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Sipas nenit 90 mbi dëmtimet me dashje shprehet se: Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, dënohen me gjobë, pasi përbëjnë kundërvajtje penale.

Sipas Kodit Penal, Seksioni VII mbi Vepra Penale Kundër Lirisë Së Personit nenit 119 mbi Fyerjen përcaktohet se: Fyerja e qëllimshme ndaj individit përbën kundërvajtje penale, kjo vepër dënohet me gjobë ose me masën e burgimit deri në gjashtë muaj. E njëjta vepër, kur kryhet në disa vende të botës njëkohësisht, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit pasi përbën kundërvajtje penale.

Në mbështetje të nenit 120 mbi shpifjen përcaktohet se: Përhapja e qëllimshme e thënieve, si dhe e çdo informacioni tjetër, i cili dihet se është i rremë e që cenojnë drejtpësdrejtji nderin apo dinjitetin e individit, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim deri

në një vit ose me gjobë. Në rastet kur kjo vepër është kryer njëkohësisht në disa vende të botës, përbën gjithashtu kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim deri në dy vjet ose me gjobë. Adoleshentët preken lehtëzi nga këto penalite, prandaj kjo duhet të vlerësohet nga institucionet edukative.

Neni 139 mbi vjedhjen me dhunë përcakton se vjedhja e pasurisë e shoqëruar me përdorim dhune dënohet nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim.

Ndërsa neni 140 mbi vjedhjen me armë shprehet se vjedhja e pasurisë e shoqëruar me përdorimin e armëve dënohet nga dhjetë deri në njëzet vjet burgim.

Nenit 141 i po këtij kodi mbi vjedhjen me pasojë vdekjen përcakton se kur vjedhja e pasurisë është shoqëruar me akte dhune, të cilat për pasajë kanë shkaktuar vdekjen e personit, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet e pesë vjet, ose me burgim të përjetshëm.

Neni 151 mbi shkatërrimin e pronës me zjarr përcakton se: Shkatërrimi apo dëmtimi i pronës me zjarr, e kryer me dashje dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet. Kur vepra penale ka shkaktuar pasoja të rënda materiale, dënohet me burgim deri në dhjetë vjet. Kur vepra penale ka shkaktuar pasoja të rënda për jetën dhe shëndetin e njerëzve, personi përgjegjës dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 279 mbi prodhimin dhe mbajtjen pa leje të armëve të ftohta përcaktohet se: Mbajtja, blerja apo prodhimi i shitjes së armëve të ftohta si: thika, bajoneta, shpata apo mjete të tjera të përgatitura, pa leje të organeve kompetente, të destinuara posaçërisht për sulm kundër personave ose për vetëmbrojtje, përbëjnë vepër penale, prandaj ato dënohen me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Neni 282 që përcakton shkeljet e rregullave mbi lëndët djegëse, plasëse si dhe radioaktive përcakton se shkelja e rregullave të përcaktuara që nga mbajtja, prodhimi, përdorimi, ruajtja dhe transportimi i lënëve djegëse apo radioaktive, shitjen e lëndëve plasëse, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohet deri në dy vjet burgim ose gjobë.

Kur nga vepra penale është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit të njerëzve deri në humbjen e jetës, ose kanë ardhur pasoja të rënda materiale i pandehuri dënohet me gjobë ose me burgim deri në dhjetë vjet.

Kodi i Procedurës Civile, neni 286 mbi Nxitjen për përdorimin e drogës thuhet se: Nxitja e të tjerëve për përdorimin e drogës narkotike apo substancave psikotike si dhe injektimi i tyre pa pëlqimin e të dëmtuarit, dënohet nga pesë deri në dhjetë vjet me burgim.

Kur nxitja për përdorimin e tyre apo injektimi i detyruar bëhet ndaj të miturve, kjo në institucionet penale, shkollore, sportive apo të çdo veprimtarie tjetër shoqërore, dënohet nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim.

Gjithashtu, ligji Nr. 7975 i datës 21 korrik 1995 dhe i amenduar në vitet 2006 si dhe 2004 përcakton rregullat për prodhimin, ruajtjen, importin, kontrollin, eksportin dhe tregtimin e lëndëve narkotike dhe psikotrope. Por këto substanca mund të gjenden dhe përdoren prej tyre duke shkaktuar probleme apo shqetësime të ndryshme që lidhen me shëndetin dhe jetën e tyre sociale.

Sipas dispozitat kryesore kushtetuese të Kodit të Procedurës Penale, Tetor 2011, Ligji Nr.7905, datë 21.3.1995 (i përditësuar), mbështetur dhe në ligjin nr.7491 neni 16, datë 29.4.1991 përcaktohen kufizimet për këtë grupmoshë. Kështu sipas po këtij ligji, mbi mbrojtësin e caktuar, neni 49, pika dy shprehet, se kur i pandehuri është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç, ose me aftësi të kufizuara fizike apo psikike, të cilat sjellin

pamundësinë për të realizuar vet të drejtën e mbrojtjes, detyrimisht duhet të sigurohet ndihma nga një mbrojtës.

Sikundër sipas nenit 140 mbi njoftimin e të pandehurit të lirë, pika 3 përcakton se: Kopja e njoftimit për paraqitjen e të pandehurit nuk mund t'i dorëzohet, një të mituri nën moshën katërbëdhjetë vjeç apo një personi me paafësi të dukshme intelektuale.

Ndërsa sipas nenit 361 mbi pyetjen e dëshmitarëve, ndryshuar me ligjin nr.9276, datë 16.9.2004, ku është shtuar pika shtatë, përcaktohet se: Pyetja e dëshmitarëve bëhet duke filluar me prokurorin, mbrojtësin apo përfaqësuesin që ka kërkuar pyetjen e individit dshmitar. Procesi vazhdon më tej me pyetjen sipas radhës të palëve.

Pika 5 shprehet se dëshmitarët individë të mitur mund të merren në pyetje mbi kërkesat dhe kundërshtimet e palëve nga vet kryetari. Kryetari gjatë marrjes në pyetje mund të ndihmohet nga një specialist i fushës së edukimit të fëmijëve si dhe nga ndonjë familjar i të miturit.

Në rastet kur çmohet se pyetja e drejtpërdrejtë e individit të mituri nuk dëmton gjendjen e tij psikologjike, kryetari ka të drejtë të urdhërojë që pyetja e të miturit të vazhdojë sipas dispozitave të paragrafëve 1 dhe 2. por urdhri mund të revokohet gjatë pyetjes së të pandehurit.

Ndërkohë që sipas Kodit të Procedurës Penale, nenit 81 mbi kufijtë e bashkimit në rastin kur të miturit kanë kryer veprave penale specifikohet se: 1. Kur disa nga procedimet e lidhura ndërmjet tyre janë kompetencë e gjykatës së zakonshme. Proçedimet e tjera i takojnë gjykatës që merret me shqyrtimin e çështjeve me individë të mitur, e cila konsiderohet përgjegjëse për të gjitha llojet e procedimeve, përveç rasteve kur gjykata çmon se ato vepra duhen veçuar.

2. Kur i individi i pandehur në kohën e gjykimit është në moshë madhore, por një ose disa nga veprat i ka kryer kur ka qenë i mitur, gjykata që shqyrton çështjet me të mitur merr në kompetencë gjithë gjykimin.

***Dënimet dhe shërbimet që ofrohen brenda institucioneve sipas kodit penal të***

***Republikës së Shqipërisë:***

Sipas Ligjit Nr. 7895, 1995 mbi Përgjegjësinë Penale nenit 31 mbi: Dënimi me burgim të përjetshëm përcakton se: Kryerja e një krimi të rëndë nga i pandehuri me vendim të gjykatës dënohet me burgim të përjetshëm.

Ndaj personave që në kohën e kryerjes së krimit nuk kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç nuk u jepet dënim me burgim të përjetshëm.

Sipas nenit 33 mbi mënyrën e vuajtjes së dënimit me burgim të përjetshëm dhe me burgim përcakton se: kryerja e vuajtjes së dënimit, për individët që gjykata ka vendosur burgim të përjetshëm dhe dënim me burgim kryhet në institucione të caktuara, posaçërisht për këtë qëllim.

Rregullat, të drejtat dhe detyrat e të dënuarve mbi mënyrën e vuajtjes së dënimit caktohen me ligj. Të miturit dënimin me burgim e kryejnë në vende të veçanta nga të rriturit.

Neni 46 mbi masat mjekësore dhe edukuese përcakton se: Masat mjekësore mund të jepen nga gjykata ndaj personave të cilësuar si të papërgjegjshëm, të cilët kanë kryer veprë penale, ndërsa masat edukuese mund të jepen ndaj të miturve që nuk marrin dënim me gjobë apo burgim, ose që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale.

Masat mjekësore mund të jenë:

- Mjekimi i detyruar ambulator



- Mjekimi i detyruar në një nga institucionet mjeksore

Masat edukuese mund të jenë:

1. Vendosja e individit të miturit në një institucion edukimi. Në çdo kohë, kur nuk ekzistojnë më rrethanat për të cilat është dhënë dënimi, vendimi gjyqësor për masat mjekësore dhe edukuese është i revokueshëm. Në të gjitha rastet e tjera gjykata, kryesisht, është e detyruar që pas kalimit të një viti nga dita e dhënies së vendimit, të marrë në rishqyrtim vendimin e saj. Kodi i Procedurës Penale parashikohen gjithashtu rregullat për revokimin e vendimit gjyqësor, i cili përmban si masën mjekësore dhe atë edukuese.

Sipas nenit 51 mbi Dënimin me burgim për të miturit: Për të miturit, të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kanë mbushur ende moshën 18 vjeç, dënimi me burg nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikon ligji për veprën penale të kryer. Neni 59 mbi pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim përcakton se: Në varësi të rrezikshmërisë së pakët të paraqet personi, si dhe rrethanave të kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burgim deri në pesë vjet. Gjkata gjithashtu ka mundësi të kërkojë që individ i dënuar të vihet në provë, duke bërë të mundur pezullimin e ekzekutimit të dënimit, po kjo me kusht që gjatë kohës së provës, individ të mos kryejë vepër tjetër penale, po aq të rëndë, apo edhe më të rëndë se ajo e mëparshme.

Afati i provës zgjat nga tetëmbëdhjetë muaj deri në pesë vjet.

Neni 60 përcakton qartazi këto masa të cilat mund të jenë të përshtatshme për të rinjtë kështu: Masat ndaj të dënuarit të vënë në provë, i dënuari i vënë në provë, mund të detyrohet nga gjykata që të plotësojë një apo më tepër prej masave të mëposhtme duke përjashtuar pikën 2:

1. Të marrë një arsim apo formim profesional ose të ushtrojë një veprimtari profesionale
3. Të punojë për të riparuar dëmin civil që ka shkaktuar.
4. Ndalohet të drejtojë çdo lloj automjeti.
5. Të mos ushtrojë atë veprimtari qoftë kjo dhe profesionale kur vepra penale që ai ka kryer ka lidhje pikërisht me këtë veprimtari.
6. Të mos frekuentojë vende të caktuara.
7. Nuk duhet të frekuentojë bare apo lokale që shërbejnë pije alkoolike.
8. Të mos largohet nga banesa e tij në orare të caktuara.
9. Të mos shoqërohet kryesisht me individë të dënuar apo me individët bashkëpunëtorë në kryerjen e veprës penale.
10. Nuk lejohet të mbajë armë.
11. Duhet ti nënshtrohet masave mjekësore si kundër alkoolit dhe narkotikëve.

Duke u mbështetur në kodin penal Ligji numër 9518, datë 18.4.2006 neni 4, i cili ndalon shitjen apo ofrimin e pijeve alkoolike falas të miturve apo konsumin e tyre në vendet publike po nga të miturit, gjë e cila ndikon drejtpërdrejt në kryerjen e veprimeve agresive ose nxit përdorimin e tyre.

Është i njohur fakti se adoleshentët janë tepër të ekspozuar ndaj alkoolit dhe arrijnë të gjejnë mënyra për të siguruar dhe përdorur pije alkoolike.

Parandalimi i substancave psikoaktive në Shqipëri gjithashtu janë burim i nxitjes së agresivitetit, i cili kryhet në disa nivele.

Ministria e Shëndetësisë, ajo e Kulturës, e Arsimit dhe Sporteve si dhe Ministria e Mirëqënies Sociale si dhe organizata ndërkombëtare si: UNICEF, UNFPA, UNODC, OBSH, veprojnë përmes organeve të tyre në shkolla.

Në kurrikulat shkollore është vendosur kryerja e lëndëve të caktuara në shkollat e mesme si: qytetari, e cila ofron informacione teorike dhe praktike mbi edukim për drogat dhe alkoolin, madje dhe për penalitetet që prekin një adoleshent në rastin e kryerjes së veprimtarive, të cilat dënohen si, shpjeguar më sipër, si nga Kodi i Procedurës Civile si dhe Kodi Penal.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës që nga viti 2006, ka ndërmarrë nismën e pajisjes së shkollave nëntëvjeçare dhe të mesme me psikologë, ku synohet midis të tjerash kapja dhe trajtimi i hershme i problemeve të lidhura me sjelljet auditive, agresivitetin dhe sjelljet antisociale, duke u përpjekur të japin mbështetjen e duhur në çdo rast. Këta profesionistë janë për fat të keq të punësuar vetëm në shkollat e zonave urbane, por pak ose aspak në zonat rurale etj.

Fal kontributit të disa vendeve të huaja ka patur inisiativa për sensibilizimin e adoleshentëve në vendin tonë, kështu në vitin 2006 nga UNICEF u botua manuali mbi ndërmjetësimin e konflikteve në grupmoshat shkollore. Ky manual mundësoi trajnimin e mësuesve dhe psikologëve të shkollave nga specialistë. Po në këtë kuadër në vitin 2008 filloi nisma “Të jetosh shëndetshëm” që u përqendrua në disa qytete kryesore të vendit, duke synuar rritjen e ndërgjegjësimit të adoleshentët për një jetë pa alkool, duhan apo drogë. Nisma u shoqërua dhe me një fushatë sensibilizimi për të rinjtë mbi përdorimin e drogave dhe substancave ilegale, nga e cila në total përfituan, rreth 1500 nxënës, mësues, psikologë dhe prindër.

Qendra për Arsim Demokratik ( maj 2012 – qershor 2013) (CDE), së bashku me bashkëpunëtorët e saj aplikoi projektin mbi agresivitetin dhe menaxhimi i tij në ambientet shkollore si një nga instrumentet për krijimin e një mjedisi edukues për nxënësit dhe të

rinjtë sa më të sigurt. Ky projekt u inicua dhe u mbështat financiarisht nga Agjensia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

Zona e shtrirjes së Projektit përfshiu qytetin e Durrësit në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Rajonale të Durrësit. Ky bashkëpunim u shtri dhe me Drejtorinë Arsimore Rajonale të Tiranës, qark për realizimin e këtij projekti në zonat periferike, zonat urbane dhe ato rurale të Tiranë. Ndërkohë rezultatet e projektit u shpërndanë si në nivel rajonal dhe kombëtar.

Nga zbatimi i këtij projekti referuar zonës së shtrirjes së tij, pati një numër të konsiderueshëm të atyre që përfituan, qofshin këta përfitues direkt apo indirekt, duke arritur në një numër rreth 27 000 nxënës, mësues e drejtues të shkollave.

Në këtë numër nuk përfshihen natyrisht përfituesit si pasojë e shpërndarjes së materialeve e produkteve të projektit në nivel kombëtar.

Qëllimi i projektit përfshinte ndërgjegjësimin e nxënësve, prindërve dhe mësuesve të shkollave për të bërë të mundur jo vetëm përpilimin dhe përcaktimin e objektivave të studimit, por dhe zbatimin e programeve, strategjive dhe veprimtarive, që i sigurojnë çdo nxënësi një mjedis të sigurt shkollimi. Duke synuar gjithashtu ti bëjë adoleshentët e kësaj grupmoshe të aftë të mund të menaxhojnë agresivitetin e tyre në mënyrë të tillë që të krijojnë hapësira të një shoqërie konstruktive, duke mundësuar tek ata edukimin me vlera qytetare.

### **4.1.3 Të dhëna statistikore mbi kriminalitetin e adoleshentëve në Shqipëri.**

Në kontekstin shqiptar përfshirja e fëmijëve, adoleshentëve dhe të rinjve në përgjithësi, në aktivitete kriminale, veçanërisht në vitet e fundit, është një realitet shqetësues, i cili meriton një vëmendje të veçantë nga të gjitha institucionet përgjegjëse. Statistikat e ofruara nga institucionet qendrore dhe lokale, të specializuara në këtë fushë, tregojnë se kurba e kriminalitetit të të rinjve dhe të miturve mbetet pothuajse konstante. Analiza e thellë e të dhënave statistikore shërben jo vetëm për të përcaktuar përmasat e manifestimit të kriminalitetit në periudhën e adoleshencës, por mbi të gjitha për të identifikuar faktorët, shkaqet dhe nxitësit, të cilët qëndrojnë prapa këtyre të dhënave. Statistikat dhe treguesit që marrim prej tyre, paraqesin mjaft interes, pasi japin informacion matematik mbi ekzistencën e fenomenit, por një detyrë e rëndësishme e cila kërkon zgjidhje, mbetet evidentimi i nxitësve, shkaqeve dhe mikromjediseve familjare dhe shkollore që e “favorizojnë” dukurinë e kriminalitetit në moshën e adoleshencës.

Duke filluar nga 1997 numri i të dënuarve të rinj është rritur ndjeshëm. Vërehet se afro 90 për qind e tyre që kanë marrë masën e dënimit janë akuzuar për kryerjen e veprave penale. Gjatë vitit 2005 nga 289 individë të dënuar që janë në moshë të re, 258 janë dënuar për kryerjen e veprave penale, ndërsa 31 për kundravajtje.

Po të krahasohen shifrat e 2005 me ato të 2004 (31 në 2005 dhe 7 në 2004), dënimet e të miturve dhe të rinjve për kundravajtje kanë pësuar rritje.

Krimi kundër pronës ose vjedhjet përlllogariten si veprat më të shpeshta penale të kryera nga të miturit dhe të rinjtë.

Gjatë vitit 2005 shënohen 25 të mitur të ndaluar për 100.000 individë të kësaj moshe.

Në vitin 2004 numërohen 32 të mitur për 100.000 individë në këtë moshë.

Sipas të dhënave të siguruara nga Ministria e Brendshme gjatë vitit 2002 rezultojnë gjithsej 274 krime të kryer nga individë të mitur, në vitin 2003 numërohen 308 krime të kryer prej kësaj grupmoshe, në 2004 ky numër është më i lartë, gjithsej 320 krime kryer nga të mitur dhe në 2005 janë regjistruar 289 krime të kryera prej tyre.

Veprat penale të të miturve në Tiranë kanë këtë kurbë: për vitin 2002, rezultojnë 56 raste të miturish nga 744 të evidentuara në tërësi, 36 raste të miturish, nga 1505 në total për vitin 2003, 77 raste nga 1529 në vitin 2004 dhe 104 nga 1442 në vitin 2005.

Paraqitur në përqindje në Tiranë situata paraqitet: Për vitin 2002, veprat penale të të miturve përbëjnë 7.5%, për 2003 veprat penale të të miturve përbëjnë afërsisht 2.4 %, për 2004 përbëjnë afërsisht 5 % dhe për vitin 2005 veprat penale të të miturve përbëjnë rreth 7% të rasteve.

Vlora, një nga qendrat me numër më të lartë të veprave penale, rezulton me këtë situatë të veprave penale kryer nga të miturit: Për vitin 2002, nga 323 vepra penale 16 janë kryer nga të mitur, afërsisht 5%, për vitin 2003, nga 263 vepra penale 3 janë kryer nga të mitur, afërsisht 1.1%, për vitin 2004 nga 307 vepra penale të kryera gjithsej 13 prej tyre rezultojnë se janë kryer nga të mitur, afërsisht 4.2%, për vitin 2005 nga 341 vepra penale 5 janë kryer nga të mitur, afërsisht 1.5%

Elbasani, një nga qendrat me një numër të konsiderueshëm popullsie, situata e kryerjes së veprave penale nga të miturit rezulton të jetë si më poshtë: Viti 2002 nga 208 vepra penale të kryera gjithsej, 13 janë vepra penale të kryer nga të mitur, afërsisht 6%, për vitin 2003 nga 310 vepra penale, 17 janë kryer nga të mitur, afërsisht 5.5%, në vitin 2004 nga 279

vepra penale të kryera gjithsej, 29 prej tyre janë kryer nga të mitur, afërsisht 10.4 %, për vitin 2005 nga 252 vepra penale, 6 janë kryer nga të mitur, pra afërsisht 2.4%.

Berati ka patur më shumë vepra penale të kryera nga të miturit, veçanërisht në një periudhë kohore kjo është e lidhur dhe me trafikun e qënieve njerëzore, transportimin dhe shpërndarjen e drogës, si dhe krime kundër personit si: veprime të mbetura në tentativë, plagosje apo vrasje. Shifrat e mëposhtme tregojnë këtë situatë:

Viti 2002 nga 157 raste të kryerjes së veprave penale , 5 janë kryer nga individë të mitur, afërsisht 3%, në vitin 2003 nga 141 raste gjithsej, 18 prej tyre janë kryer nga individët e mitur, rreth 12.7%, për vitin 2004 nga 246 raste, 19 janë kryer nga të mitur, afërsisht 8%, gjendja në vitin 2005 rezulton me 209 raste të kryerjes penale, ku 12 janë vepra të kryera nga të miturit, ose afërsisht 5.7 %.

Nga krahasimi i shpejtë i shifrave rezulton se kryerja e veprave penale në moshat e reja përbëjnë 6.25 % të rasteve për vitin 2002 (nga 4370 të krimeve të kryera në total, 274 prej tyre janë raste të veprave penale të kryera nga të miturve).

Veprat penale të të miturve dhe të rinjve shënojnë 4.2 % të rasteve në përgjithësi, në 2003 (nga 6628, 308 janë raste të të miturve), në 2004 shifra mbetet afërsisht e barabartë me atë të vitit 2003 . Në total nga 6379 raste të kryerjes së veprave penale, ku 320 janë raste të veprave penale të kryera nga të miturit, pra rreth 5% (*shih tabelën A në seksionin Shtojcë*).

Veprat penale të të miturve për vitin 2005, përbëjnë afërsisht 4.4% të veprave penale të shënuara në total. Për vitin 2004 nga 313 vepra penale, të miturit kanë kryer 94 vjedhje, pra afërsisht 30% dhe po kaq, 97 raste ose 30 % vjedhje në bashkëpunim dhe më shumë se njëherë.

Për vitin 2005 nga 258 vepra penale të kryera në total, 61 individët të miturit kanë kryer vjedhje, ose afërsisht 23% e veprave penale, ndërsa 122 vjedhje janë kryer në bashkëpunim dhe kjo në më shumë se njëherë duke përbërë afërsisht 50% të veprave penale.

Të dhënat e vitit 2005 tërheqin vëmendjen për faktin se individët e mitur shfaqen me një shifër cilësuese e përfshirë në krimin e organizuar.

Nëse në 2004 ata kryenin 30 % të veprave në bashkëpunim, në 2005 kjo shifër arrin në 50%.

Të miturit dhe të rinjtë sipas të dhënave të Ministrisë së Drejtësisë, rezultojnë se janë përfshirë edhe në veprën penale të transportit apo shpërndarjes së lëndëve narkotike.


Ajo që tërheq vëmendjen në kryerjen e kësaj vepëre penale, është rritja e ndjeshme e numrit të miturve të përfshirë në to.

Kështu për vitin 2005 të miturit kanë kryer 4.2 % të veprave penale.

Të dhënat e raportuara nga Hoxha, M. (2008), Vjetari statistikor 2007, Botuar nga Ministria e Drejtësisë. Zyra e Statistikës dhe Bibliografisë si dhe Drejtoria e Informatizimit të të Dhënave . Viti i gjashtë i botimit. fq.83, identifikon numrin i të dënuarve të mitur është si më poshtë:



**Grafik 2.** Të dënuar të mitur për vepra penale në Shqipëri (2002-2005)



Burimi: Marrë nga “Vjetari statistikor 2007, Ministria e Drejtësisë”

Sipas Haxhiymeri, E. ”(2007), CRCA dhe kontributin e UNICEF “Kriminaliteti i të miturve në Shqipëri. Analizë e shkaqeve dhe faktorëve të kriminalitetit tek të miturit në Shqipëri”, Tiranë. fq.18. Visi Design, raporton se numri i kundravajtjeve penale të të miturve janë paraqitur në tabela nr.2.

**Tabela 2.** Kundravajtje penale dhe të dënuarit të mitur 2004-2005

<b>Neni</b>	<b>Figura e veprës penale</b>	<b>Të dënuar të mitur(2004)</b>	<b>Të dënuar të mitur(2005)</b>
<b>84</b>	Kanosja	2	2
<b>89</b>	Plagosja e lehtë me dashje	-	2
<b>90</b>	Dëmtime të tjera me dashje	-	2
<b>112</b>	Dhunim i banesës	-	1
<b>205</b>	Prerja e paligjshme e pyjeve	2	1
<b>239</b>	Fyerje e kryer për shkak të detyrës	-	2
<b>274</b>	Prishje e qetësisë publike	-	1
<b>275</b>	Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike	-	1
<b>277</b>	Vetëgjyqësia	1	2
<b>291</b>	Drejtim i automjetit në gjendje të dehur apo pa leje drejtimi	1	4
<b>287/1</b>	Kalim i paligjshëm i kufirit	-	13
<b>306/1</b>	Dhënia e dëshmisë së rreme	1	-
<b>Totali</b>		7	31

*Burimi: Marrë nga “Kriminaliteti i të miturve në Shqipëri” CRCA & UNICEF, 2007*

Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2006, 10.4 % të veprave penale janë kryer nga të miturit. Shprehur ndryshe në shifra nga 124 autorë të veprave penale, 13 prej tyre janë të moshës nga 14 deri më 18 vjeç. Të dhëna këto që raportohen po nga njëjti studim i

Haxhiymeri, E. (2007) mbi kriminalitetin e të miturve në Shqipëri. UNICEF dhe CRCA, fq.11, Visi Design, Tiranë.

**Tabela 3.** Autorë të veprave penale kundër personit gjatë 6 mujorit të parë të 2006

<b>Figura e veprës penale</b>	<b>14 - 18 vjeç</b>
<b>Vrasje</b>	5
<b>Vrasje në tentativë</b>	17
<b>Plagosje e rëndë me dashje</b>	10
<b>Marrëdhënie sek/homoseksuale</b>	1
<b>Marrëdhënie seksuale me dhunë</b>	1
<b>Vepra të turpshme</b>	2
<b>Vepra penale të tjera kundër personit</b>	135
<b>Armëmbajtje pa leje</b>	11
<b>Totali</b>	182

*Burimi: Marrë nga “Kriminaliteti i të miturve në Shqipëri” CRCA & UNICEF, 2007*

Të dhënat statistikore Golloshaj, O & Paluca, N, (2011) mbi kriminalitetin e të miturit që rezultojnë nga Vjetari Statistikor 2010, botim i Ministrisë së Drejtësisë. Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë në bashkëpunim kjo me Zyrën e Statistikës dhe Bibliografisë. Viti i nëntë i botimit, fq. 81-82, Tiranë, pasqyron një rritje të theksuar të

kriminalitetit të të rinjve, krahasuar kjo me të dhënat e viteve 2003, 2004, 2005, 2006, 2007, 2008 dhe 2009.

Të dënuar të mitur gjatë vitit 2010 janë 656, nga të cilët 594 të dënuar për krime dhe 62 të dënuar për kundërvajtje penale. Nga kjo kategori të dënuarish, në vitin 2003 ishin 308 (259 për krime, 49 për kundërvajtje), në vitin 2004 ishin 320 (313 për krime, 7 për kundërvajtje), në vitin 2005 ishin 289 (258 për krime dhe 31 për kundërvajtje), në vitin 2006 ishin 268 (238 për krime dhe 30 për kundërvajtje penale), në vitin 2007, 211 (198 për krime, 13 për kundërvajtje penale), në vitin 2008 ishin 407 (356 për krime, 51 për kundërvajtje) dhe në vitin 2009 411 (362 për krime, 49 për kundërvajtje).

**Tabela 4.** Të dënuar të mitur nga viti 2004-2010 sipas Vjetarit të Ministrisë së Drejtësisë

<b>Të dënuar të mitur</b>	<b>2004</b>	<b>2005</b>	<b>2006</b>	<b>2007</b>	<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>
<b>Për Krime</b>	313	258	238	198	356	362	594
<b>Për Kundërvajtje</b>	7	31	30	13	51	49	62
<b>Total</b>	320	289	268	211	407	411	656

*Burimi: Marrë nga "Vjetarët e Ministrisë së Drejtësisë 2004-2010",*

Veçori dalluese është se edhe për vitin 2010, 91% e të dënuarve të mitur janë për krime.

E parë nga ana tabelare mund të thuhet se në vitin 2010, në krahasim me vitin 2009, numri i të dënuarve për krime ka pësuar një rritje prej 32 të dënuarish.


Duke pasur parasysh raportin e numrit total të të dënuarve të mitur (656 të dënuar) me numrin e të dënuarve të mitur për krime (594 të dënuar) për vitin 2010. Në krahasim këto me raportin e numrit total të dënuarve të mitur (411 të dënuar) me numrin e të dënuarve të

mitur për krime (362 të dënuar) në vitin 2009, rezulton se numri i të dënuarve për krime është rritur nga 88% në vitin 2009 në 91% në vitin 2010 .

Përsa i përket kundërvajtjeve penale krahasuar po me këtë vit, numri i të dënuarve është gjithashtu në rritje.

Duke i analizuar të dënuarit në shkallë vendi (7854), të dënuarit e mitur përbëjnë vetëm 8% e tyre.

**Grafiku 3.** Të dhëna mbi krimet e të miturve nga 2004- 2010



Burimi: Marrë nga "Vjetarit të Ministrisë së Drejtësisë 2004-2010 ,,

Po sipas këtij vjetari rezulton se nga 594 të mitur të dënuar në 2010, 5 janë pa arsim, 589 janë me arsim, nga të cilët 26 sipas ligjit shqiptar janë dënuar me gjobë, 539, janë dënuar deri në 2 vjet, 22 prej tyre janë dënuar nga 2-5 vjet, 4 kanë marrë dënimin nga 5-10 vjet dhe vetëm 1 prej tyre është dënuar me 10-25 vjet heqje lirie.

Po sipas Vjetarit të Ministrisë së Drejtësisë nga 62 kundërvajtjet penale të gjithë janë me arsim, 45 sipas ligjit shqiptar janë dënuar me gjobë, 17 janë dënuar deri në 2 vjet, asnjë prej tyre nuk është dënuar nga 2-5 vjet, nga 5-10 vjet apo me 10-25 vjet heqje lirie.


Në shkolla vërehet jo më pak problematike gjendja e adoleshenteve femra, nga ku rezulton që masat që u jepen atyre janë më të zbutura, edhe në rastet kur ato paraqesnin të njëjtën sjellje si dhe djemtë. p.sh. në raste të rrahjeve, fenomene jo të pakta këto brenda mjediseve të shkollës, vajzave, sipas shkallëve të dispozitave normative u jepet masa deri në tre ditë përjashtim nga shkolla dhe jo përjashtim përfundimtar siç ndodhte për djemtë.

Masat ndaj vajzave mund të duken se janë më të lehta, por në fakt nuk është kështu, pasi sjelljet e tyre nuk janë të përsëritura si ato të djemëve. Vajzat përpiqen që brenda mjedisit të shkollave të jenë më korekte në zbatimin e rregulloreve.

Në shoqërinë tonë prindrit janë më tepër shtrëngues dhe imponues ndaj vajzave, se ndaj djemve, madje sa herë që ato shfaqin problematikë brenda mjedisit shkollor vet prindrit bashkëpunojnë më shumë me shkollën për zgjidhjen e konflikteve, shprehen si drejtuesit ashtu dhe mësuesit e këtyre shkollave.

Kjo problematikë konstatohet dhe nga të dhënat që paraqet Vjetari Statistikor 2010 (fq. 85-86), ku nga të gjithë të dënuarit 336 prej tyre janë femra që janë dënuar për krime, ndërsa 213 femra për kundravajtje penale. Numri i të dënuarave femra, krahasuar me të dënuarit në përgjithësi është 549 të dënuara, ose 7% e numrit të përgjithshëm të të dënuarve.

**Grafiku 4.** Të dënuar femra nga viti 2004-2010 sipas Vjetarit Statistikor të Ministrisë së Drejtësisë



Burimi: Marrë nga “Vjetarit të Ministrisë së Drejtësisë 2004-2010 „

Referuar Janku, T. & Hoxha, E.(2014) sipas Vjetarit Statistikor 2013 të botuar nga Ministria e Drejtësisë. Sektori i Statistikave dhe Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë, viti i dymbëdhjetë i botimit, fq.85-89, Tiranë, për kriminalitetin e të miturit, në vitet 2010, 2011 dhe në 2012, pasqyrohet një rritje e theksuar e fenomenit. Viti 2013 reflekton një ulje të të dënuarve të mitur.

Të dënuar të mitur gjatë vitit 2013 janë 680, nga të cilët 589 të dënuar për krime dhe 91 të dënuar për kundërvajtje penale. Nga kjo kategori të dënuarish, si paraqitet dhe më sipër në vitin 2010, ishin 656 (594 për krime, 62 për kundërvajtje), në vitin 2011 ishin 683 (610 për krime, 73 për kundërvajtje), në vitin 2012 ishin 883 (826 për krime, 57 për kundërvajtje penale).

Veçori dalluese është se për vitin 2013, 87% e të dënuarve të mitur janë për krime.

Përsa i përket kundërvajtjeve penale numri i të dënuarve është në rritje. Duke u krahasuar me të dënuarit në shkallë vendi (8,577), të dënuarit e mitur janë 8% e tyre.

Të dhënat që na ofrohen nga ky vjetar del se nga 589 të mitur të dënuar për krime në 2013, 9 janë pa arsim, 580 janë me arsim, nga të cilët 33 sipas ligjit shqiptar janë dënuar me gjobë, 525 janë dënuar deri në 2 vjet, 25 prej tyre janë dënuar nga 2-5 vjet, 6 kanë marrë dënimin nga 5-10 vjet dhe asnjë prej tyre nuk është dënuar me 10-25 vjet heqje lirie.

Po sipas Vjetarit të Ministrisë së Drejtësisë në 2013, nga 91 kundërvajtjet penale 89 janë me arsim, 31 sipas ligjit shqiptar janë dënuar me gjobë 60 janë dënuar deri në 2 vjet, asnjë prej tyre nuk është dënuar nga 2-5 vjet, nga 5-10 vjet apo me 10-25 vjet heqje lirie.

Numri i të dënuarave femra, krahasuar me të dënuarit në përgjithësi, është në shifra të ulëta, me 335 të dënuara ose 4% e numrit të përgjithshëm të të dënuarave.


Krahasuar me të dënuarat femra të vitit 2012, kemi një zbritje të numrit të të dënuarave nga kjo kategori shoqërore me 28 të dënuara më pak, 166 të dënuara më pak se në vitin 2011, me 214 të dënuara më pak se në vitin 2010, me 180 të dënuara më pak se në vitin 2009, me 222 të dënuara më pak se në vitin 2008 dhe me 120 të dënuara më pak se në vitin 2007.

Po të analizojmë 335 femrat e dënuara gjatë vitit 2013, vërejmë se për krime janë dënuar 206 dhe për kundërvajtje penale 129, pra 61% e të dënuarave janë për krime dhe 39% për kundërvajtje penale.

Në krahasim me vitin 2012 numri i femrave që kanë kryer krime është ulur paksa (nga 62% të dënuara për krime në vitin 2012, në 61% të dënuara për krime në vitin 2013).



**Grafiku 4.1.** Të dënuarat femra nga viti 2010-2013 paraqiten si vijon:



*Burimi: Marrë nga "Vjetarit të Ministrisë së Drejtësisë 2010-2014",*

Një problem i mprehtë i cili meriton vëmendje të vecantë, është ekzistenca e dukurisë së dhunës kundër fëmijëve në vendin tonë. Dhuna verehet se ushtrohet në familje, në shkollë dhe në mjedise sociale, kjo e vlerësuar në aspektin psikologjik dhe fizik. Format e dhunës ndaj fëmijëve në mjediset ku ata rriten, shfaqen në përmasa të ndryshme, por ajo si dukuri shqetësuese është prezente dhe ushtrohet nga prindërit, mësuesit, si dhe nga fëmijët më të rritur. Dhuna fizike dhe psikologjike është një ndër dukuritë më të shemtuara që pavarësisht se ku dhe nga kush ushtrohet, luan një rolë negativ e frenues në formimin e adoleshentëve. Ajo le gjurmë të thella, në psikikën, por dhe në cilësitë emocionale dhe volitive të fëmijëve. Dhuna ushtrohet ndaj djemëve dhe vajzave, natyrisht në raporte dhe përmasa të ndryshme. Aplikimi i dhunës psikologjike dhe sidomos asaj fizike, ndikojnë në manifestimin e dukurive të agresivitetit nga adoleshentët në përgjithësi, por sidomos nga të dhunuarit në vecanti, të cilët janë dhe kontigjentet më potencialë të aplikimit të saj. Për asnjë arsye nuk justifikohet përdorimi i dhunës dhe ndëshkimit të fëmijëve, pasi pasojat e tyre janë të

pariparueshme. Kërkohej një front i përbashkët edukues e parandalues, si dhe angazhim serioz i të gjitha institucioneve përgjegjëse, por dhe mbarë opinionit shoqëror, për eliminimin e dhunës ndaj fëmijëve.

Për të patur një tablo më të gjerë të gjendjes së sotme në vendin tonë, na vjen në ndihmë dhe një studim i kryer nga Tamo, A. & Karaj, Th.(2006) mbi dhunën kundër fëmijëve në Shqipëri, UNICEF dhe Qendra e Studimeve Humane, Tiranë, me pjesëmarrjen e 1500 të intervistuar mësues, prindër dhe fëmijë nga 6 deri në 18 vjeç.

Ky studim është kryer në 10 qytete kryesore si: Berat, Dibër, Fier, Korçë, Gjirokastrë, Mirditë, Vlorë, Tiranë, Shkodër dhe Tepelenë dhe ku u përfshin 1500 individë: prindër, mësues dhe nxënës nga klasa e parë deri në klasën e dymbëdhjetë.

Si shpërndarje moshore ky studim përfshin grupmoshat nga 6-18 vjeç e duke identifikuar disa gjetje interesante, që shpjegojnë mbi dy nga arsyet e nxitjes së agresivitetit në shtëpi si: atë të dhunës fizike dhe psikologjike.

Në përputhje po me gjetjet e të njëjtit studim, Tamo, & Karaj,( 2006) mbi dhunën kundrejt Fëmijëve në Shqipëri, Mediaprint, fq. 26, 30,31, Tiranë, ofrohen të dhënat e mëposhtme në lidhje me frekuencën dhe intensitetin e formave të dhunës fizike dhe asaj psikologjike.

Rezultatet e po këtij studimi tregojnë se ndonë të intervistuarit njohin mirë pasojat negative që shkakton për fëmijën dhuna fizike dhe psikologjike, shumica dërrmuese e tyre, pranojnë se si dhuna fizike dhe psikologjike ka edhe efekte pozitive në edukimin e fëmijës, prandaj ajo duhet përdorur, por në forma të lehta për të rinjtë adoleshentë dhe jo mbi të vegjëlit.

Por nevoja e përdorimit të dhunës është brendësuar edhe nga vetë fëmijët, qoftë kjo fizike apo psikologjike, një në dy prej të pyeturve, përkatësisht në shtëpi, si dhe një në rreth tre prej tyre, në shkollë kanë pranuar se mbi ta ushtrohet dhunë, në rastet kur ajo konsiderohet se është e nevojshme.

Format e dhunës fizike kundër fëmijëve të ushtruara si në shtëpi dhe në shkollë, gjithmonë sipas vet- raportimit nga ana e tyre, identifikohen vlerat e mëposhtme si: shkulja e flokëve, që identifikohet nga 41% - 29.7%, shkulja e veshëve varion nga 60.10% - 38.5% , goditja me shpullë në kokë nga 49.20% - 35.6%.

Format e goditjes variojnë si më poshtë, ku: goditja me objekt në trup varion nga 27%- 38.2%, goditja me shpullë në trup nga 52.60% - 34.3%, goditja me shqelm vlerësohet nga 26.80%-25.8%, goditja me objekt në vithe nga 26%-13.6%, goditja me grusht në trup reflektohet nga 20.50%-19.6% dhe goditja me grusht në kokë nga 7.60% - 10%.

Tërheqja dhe shtytja me forcë varion nga 34.60% - 39.1%, kafshimi 19.10% - 12.8%, shtrëngimi për fyti nga 12.20% - 9.6%, dhe pickimi nga 55.70% - 36.9%.

Dhuna fizike në shtëpi si dhe në shkollë janë nga format më të shpeshta të dhunës ato me goditje ku përkatësisht: një në dy fëmijë rezulton se goditen në familje, si në kokë ashtu dhe në trup, gjithashtu një në tre prej tyre raportojnë se dhunohen edhe në shkollë.

Nga ana e fëmijëve të dhënat identifikojnë se ata përjetojnë akte të dhunës fizike në shtëpi më shumë sesa në shkollë.

**Tabela 5.** Frekuenca e formave të dhunës fizike në shtëpi, në shkollë dhe në institucionet e përkujdesjes.

<b>Nr.</b>		<b>Shtëpi</b>	<b>Shkollë</b>	<b>Institucion përkujdesi</b>
<b>1</b>	Shkulje veshësh	60.10%	38.5%	62.2%
<b>2</b>	Pickim	55.70%	36.9%	58.8%
<b>3</b>	Goditje me shpullë në pjesë të trupit	52.60%	34.3%	66.7%
<b>4</b>	Goditje me shpullë në kokë	49.20%	35.6%	68.4%
<b>5</b>	Shkulje flokësh	41%	29.7%	52.6%
<b>6</b>	Tërheqje dhe shtytje me forcë	34.60%	39.1%	68.4%
<b>7</b>	Goditje me objekt në trup, por jo në vithe	27%	38.2%	68.4%
<b>8</b>	Goditje me shkelm	26.80%	25.8%	78.9%
<b>9</b>	Goditje me objekt në vithe	26%	13.6%	44.4%
<b>10</b>	Goditje me grusht në pjesë të tjera të trupit	20.50%	19.6%	66.7%
<b>11</b>	Kafshim	19.10%	12.8%	22.2%
<b>12</b>	Shtrengim për fyti	12.20%	9.6%	35.2%
<b>13</b>	Goditje me grusht në kokë	7.60%	10%	25%

*Burimi: Marrë nga “Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri”, 2006 UNICEF*

Tabelat e mëposhtme sjellin të dhëna mbi frekuencën dhe intensitetin e formave të dhunës psikologjike si, në shtëpi dhe në shkollë. Këto të dhëna i referohen gjithnjë vitit 2006, vit në të cilin është kryer studimi.

Fëmijët raportojnë se disa nga format më të përhapura të dhunës psikologjike që përdoret në shtëpi janë: kërcënim me fjalë (39%), kërcënim me dëbim (14%), kërcënim me braktisje (6%), kërcënim me përdorim objektësh (18%), mbajtja e mërisë (39.5%), të bërtiturat (95.3%), përdorimi i nofkave dhe i epiteteve fyese (35.8%) si dhe mallkimi.

Në shkollë format më të përhapura të dhunës psikologjike janë të ndryshme si: kërcënimi me thirrjen e prindit, i cili raportohet deri në 33%, kërcënimi me fjalë shfaqet në vlerën 31%, kërcënimi me zëmb identifikohet rreth 23%, kërcënimi me denoncim varion rreth 19%, kërcënimi me rrahje ka masën 17%, kërcënimi me objekte shfaqet në vlerën 11%, kërcënimi me notë në 11%, kërcënimi me përjashtim nga shkolla shfaqet rreth 10%.

Të bërtiturit raportohet deri në 74.9%, nofkat dhe epitetet keqëse shfaqet me masën 24% dhe mëria 22.5%.

Kjo do të thotë me fjalë të tjera se 2/3 e fëmijëve u bërtitet nga prindërit në shtëpi dhe një e treta e mësuesve i kërcënon ata në shkollë.

**Tabela 5.1.** Frekuenca e disa formave të dhunës psikologjike në shtëpi dhe në shkollë (2006)

<b>Nr.</b>	<b>Disa forma të dhunës psikologjike</b>	<b>Në shtëpi</b>	<b>Në shkollë</b>
<b>1</b>	Kërcënimi me fjalë	39%	31%
<b>2</b>	Kërcënimi me objekt	18%	11%
<b>3</b>	Kërcënimi me notë të keqe	NA	11%
<b>4</b>	Kërcënimi me zbim	14%	23%
<b>5</b>	Kërcënimi me braktisje	6%	NA
<b>6</b>	Kërcënimi me raportim	NA	19%
<b>7</b>	Kërcënimi me thirrjen e prindit	NA	33%
<b>8</b>	Kërcënimi me rrahje	NA	17%
<b>9</b>	Kërcënimi me përjashtim nga shkolla	NA	10%
<b>10</b>	Të bërtiturit	95.30%	74.90%
<b>11</b>	Nofkat dhe epitetet fyese	35.80%	24%
<b>12</b>	Mërimbajtja	39.50%	22.50%

NA- Nuk aplikohet

*Burimi: Marrë nga “ Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri ., 2006 UNICEF*

**Tabela 5.2.** Intensiteti i disa formave të dhunës psikologjike në shtëpi dhe në shkollë

Disa forma të dhunës psikologjike	Në shtëpi			Në shkollë		
	Rradhë	Herë pas here	Shpesh	Rradhë	Herë pas here	Shpesh
<b>1. Të bërtiturit</b>	18.40%	13.80%	63.20%	28.80%	14.50%	31.60%
<b>2. Mërimbajtja</b>	19.30%	7.50%	12.70%	16.20%	6.60%	9.70%
<b>3. Kërcënimi me fjalë</b>	16.90%	6.10%	16%	13.30%	7%	10.30%
<b>4. Nofkat me epitetet fyese</b>	19.90%	4.70%	11.10%	13.40%	4.20%	6.30%
<b>5. Kërcënimi me objekt</b>	9.90%	4.50%	3.30%	4.50%	2.90%	3.40%
<b>6. Kërcënimi me zhim</b>	9.90%	3.10%	1.40%	19.10%	6.40%	4.10%

*Burimi: Marrë nga “ Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri ., 2006 UNICEF*

Gjetjet e këtij studimi tregojnë se format e rënda të dhunës fizike përdoren mbi të dyja gjinitë. Ato përdoren më shumë mbi djemtë, sesa te vajzat, si në familje ashtu edhe në shkollë.

Të dhënat që paraqiten në tabelat e mëposhtme i referohen vetëm asaj që raportojnë të miturit në 1 vit, përkatësisht 2006, vit që është kryer studimi mbi shpeshësinë e përdorimit të formave të ndëshkimit fizik të ushtruar jo vetëm në familje, por dhe në shkollë.

Po nga ky studim del se prindërit janë më të prirur se mësuesit të mbajnë mëri, si një formë e dhunës psikologjike mbi fëmijët.

Prindërit, gjithashtu rezulton se janë më të prirur se mësuesit, të përdorin nofka dhe epitete të tjera denigruese.

Ndërkohë që nga ky studim del se mësuesit krahasuar me prindërit janë më të prirur se ata t'i dëbojnë nxënësit nga shkolla duke e përdorur këtë si formë e ndëshkimit psikologjik.

Nga studimi del se brenda shtëpisë ushtruesi më i shpeshtë i dhunës si fizike dhe asaj psikologjike është nëna, ndërsa babai cilësohet si ushtruesi më i ashpër. Konstatohet se nëna ushtron më shumë dhunë kur fëmijët janë më të vegjël, ndërsa babai rezulton të jetë ushtruesi më i madh i dhunës sidomos te fëmijët e rritur. Vërehet se të rriturit meshkuj (gjyshi/ babai) përdorin më shumë dhunë fizike mbi pjesën tjetër të gjinisë mashkullore në familje (fëmijët djem), ndërsa femërat e rritura (si: motrat më të rritura/ nënat/ gjyshet ) përdorin më shumë dhunën mbi pjesën tjetër të gjinisë femërore (fëmijët vajza).

Një fakt tjetër interesant që cilësohet në këtë studim është se përdorues të dhunës fizike mbi fëmijët janë edhe vet fëmijët e tjerë.

Kështu në shkollë dhuna që nxënësit ushtrojnë mbi njëri tjetrin është më e madhe se dhuna që ushtrohet mbi ta nga mësuesit/ mësueset, drejtuesit apo persona të tjerë.

Po ta shprehim sipas peshës së rëndesës së saj këto të dhëna: 48% ushtrojnë dhunë ndaj njëri tjetri, 19% nga mësuesit, 17.3% nga mësuesit dhe 15.3% nga njerëzit e tjerë brenda mjedisit të shkollës dhe 0.80% nga drejtuesit e shkollave.

Brenda stafit mësimor, ushtruesit më të shpeshtë të dhunës fizike dhe psikologjike janë mësueset.

Po sipas këtij studimi në 12 muajt e fundit të vitit 2006, në Shqipëri 1 në 2 fëmijë është goditur me shpullë në kokë në familje, 1 në 13 fëmijë është goditur me grusht në pjesën e kokës, 1 në 5 prej tyre që kanë qenë pjesë e studimit që raportojnë se janë qëlluar me grusht në trup, 1 në 4 me shkelm, 1 në 4 prej tyre është qëlluar me objekt në trup, 1 në 3 fëmijë



është tërhequr apo shtyrë apo përplasur me forcë dhe një në 12 fëmijë raportojnë se janë shtrënguar prej fyti etj.

**Tabela 5.3.** Forma të rënda të dhunës fizike të ushtruar në shtëpi në 12 muajt e fundit. (Të dhënat janë në %)

Nr.	Format e dhunës	Djem	Vajza
1	Goditje me shpullë në pjesën e kokës	56.5	42.5
2	Goditje me grusht në pjesën e kokës	10.5	5.3
3	Goditje me grusht në pjesë të trupit	25.4	16.3
4	Goditje me shkelm	30.6	23.2
5	Shtrengim për fyti	11.4	13.2
6	Goditje me objekt, jo në vithe, por në pjesë të tjera të trupit	27.8	26.3
7	Kafshim	22.1	16.5
8	Tërhequr ose përplasur (shtyrë) me forcë	32.8	35.8

*Burimi: Marrë nga “ Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri ,, 2006 UNICEF*

**Tabela 5.4 .** Format e rënda të ndëshkimit fizik në familje dhe shpeshësia e përdorimit të tyre gjatë 12 muajve të fundit sipas raportimit të nxënësve. (Të dhënat në %)

<b>Nr.</b>	<b>Format e dhunës</b>	<b>Asnjëherë</b>	<b>1 herë</b>	<b>2 herë</b>	<b>3 herë</b>	<b>Më shumë se katër herë</b>
<b>1</b>	Goditje me shpullë në pjesën e kokës	50.8	24	9.9	5.2	10.1
<b>2</b>	Goditje me grusht në pjesën e kokës	92.4	5.9	.9	.5	.2
<b>3</b>	Goditje me grusht në pjesë të trupit	79.5	10.4	5.2	1.9	3.1
<b>4</b>	Goditje me shkelm	73.2	14.6	6.4	3.1	2.8
<b>5</b>	Shtrengim për fyti	87.8	9.2	2.1	.2	.7
<b>6</b>	Goditje me objekt, jo në vithe, por në pjesë të tjera të trupit	73	15.7	5.4	3.1	2.8
<b>7</b>	Kafshim	80.9	12.5	2.4	1.7	2.6
<b>8</b>	Tërhequr ose përplasur (shtyrë ) me forcë	65.6	18.8	6.6	2.4	6.6

*Burimi: Marrë nga “ Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri ,, 2006 UNICEF*

Format e dhunës edhe në shkollë raportohen në përqindje relativisht të ngjashme si në shtëpi, një në tre fëmijë raporton se është qëlluar me shpullë në kokë, një në katër fëmijë me shkelm, një në dhjetë fëmijë është qëlluar me grusht në kokë, një në pesë fëmijë me grusht në trup, një në dhjetë fëmijë është shtrenguar prej fyti, një në tre fëmijë ka raportuar se është goditur me objekte të ndryshme në trup dhe gjithashtu rezultojnë se është tërhequr apo shtyrë me forcë.

Të dhënat paraqiten në vijueshmëri tabela 5.5/ 5.6.

**Tabela 5.5.** Forma të rënda të dhunës fizike të ushtruar në shkollë në 12 muajt e fundit.

(Të dhënat janë në %)

<b>Nr.</b>	<b>Format e dhunës</b>	<b>Djem</b>	<b>Vajza</b>
<b>1</b>	Goditje me shpullë në pjesë n e kokës	48.2	24.9
<b>2</b>	Goditje me grusht në pjesën e në kokës	15.8	5.2
<b>3</b>	Goditje me grusht në pjesë të trupit	30.1	10.5
<b>4</b>	Goditje me shkelm	36.9	15.8
<b>5</b>	Shtrengim për fyti	13.8	6.1
<b>6</b>	Goditje me objekt, jo në vithe, por në pjesë të tjera të truotit	44	33.5
<b>7</b>	Kafshim	16.7	8.8
<b>8</b>	Tërhequr ose përplasur (shtyrë ) me forcë	43.2	35.2

*Burimi: Marrë nga “ Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri ,, 2006 UNICEF*

**Tabela 5.6.** Shpeshtësia e përdorimit të formave të rënda të ndëshkimit fizik në shkollë

gjatë 12 muajve të fundit sipas raportimit të nxënësve. (Të dhënat në %)

<b>Nr.</b>	<b>Format e dhunës</b>	<b>Asnjëherë</b>	<b>1 herë</b>	<b>2 herë</b>	<b>3 herë</b>	<b>Më shumë se katër herë</b>
<b>1</b>	Goditje me shpullë në pjesën e kokës	64.4	18.8	5.8	3.5	7.6
<b>2</b>	Goditje me grusht në pjesën e kokës	90	6.5	.9	.2	2.3
<b>3</b>	Goditje me grusht në pjesë të trupit	80.4	9.3	2.8	2.6	4.9
<b>4</b>	Goditje me shkelm	74.2	13.3	5.3	4.0	3.3
<b>5</b>	Shtrengim për fyti	90.4	6.1	2.6	.5	.5
<b>6</b>	Goditje me objekt, jo në vithe, por në pjesë të tjera të trupit	61.8	20.7	6	3	8.5
<b>7</b>	Kafshim	87.2	7	3	1.2	1.6
<b>8</b>	Tërhequr ose përplasur (shtyrë ) me forcë	60.9	18.8	7.2	3.7	9.5


*Burimi: Marrë nga “ Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri ,, 2006 UNICEF*

Meqënëse shkollat konsiderohen përgjithësisht si mjedise të sigurta, kjo dhe për shkak të mungesës së të dhënave në shkallë republike nuk vihet në diskutim ky perceptim.

Studimi i ka kushtuar rëndësi dallimit midis sigurisë reale dhe perceptimit të sigurisë. Në këtë studim koncepti i përdorur është: siguri reale, me të cilën konsiderohet masa reale e rrezikut/jorrezikut në shkollë, ndërsa me perceptim të sigurisë është vlerësimi i perceptimit personal për shkallën e sigurisë në shkollë.

Duke u mbështetur në këtë studim konstatohet se kemi këta tregues për sigurinë e nxënësve: një e katërta e tyre në shkollë ndihen, shumë të sigurt, ndërsa dy të pestat ndihen vetëm, të sigurt. Afërsisht një e treta e nxënësve raportojnë se ndihen, shumë të pasigurt, si dhe të pasigurt. Të shprehur në vlera, nivelet e sigurisë si: shumë të sigurt si dhe të sigurt, nga studimi rezultojnë se variojnë në vlerën 65.6% e nxënësve. Afro 34.4% e tyre ndjehen sipas shkallëve përkatëse, të pasigurt, e shumë të pasigurt.

**Grafiku 5.** Niveli i sigurisë në shkollë i perceptuar nga nxënësit



Burimi: Marrë nga “ Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri ., 2006 UNICEF

Siguria e nxënësit në shkollë është parë e lidhur me katër aspekte kryesore si : përfshirja e tyre në zënka e sherre, prezenca e armëve që plagosin ose vrasin në mjediset e shkollës, kërcënimet me lloje të tilla armësh si dhe plagosjen me to.

Të dhënat e raportuara janë: 40. 9% e nxënësve janë përfshirë në zënka, 40. 5% e tyre pohojnë se kanë parë thika e armë në mjediset shkolllore, 6. 7% e pjesëmarrësve në studim janë kërcënuar me këto armë, ndërsa 5. 2% e tyre kanë pësuar plagosje prej tyre.

**Tabela 6.** Niveli i sigurisë së raportuar nga ana e nxënësve

<b>Nr.</b>	<b>Niveli i raportuar</b>	<b>Përfshirja në zënka</b>	<b>Prezencë armësh</b>	<b>Kërcënime me armë</b>	<b>Plagosje me armë</b>
<b>1</b>	Asnjëherë	59.1	59.5	93.3	94.8
<b>2</b>	Një herë	24.8	22.7	4.4	3.8
<b>3</b>	Dy herë	7.9	9.5	0.9	0.7
<b>4</b>	Tre herë	3	2.8	0.2	0.5
<b>5</b>	Më shumë se katër herë	5.1	5.6	1.2	0.2

*Burimi: Marrë nga “ Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri , 2006 UNICEF*

Por këto nuk janë të dhënat e vetme që marrim përsa i takon formave të dhunës apo të përmendura më sipër, të cilat na çojnë indirekt drejt nxënësve të kësaj dhune. Të dhënat e studimit të mësipërm na jep dy indikator të rëndësishëm të dhunës që janë familja dhe shkolla, ku kundrejt nxënësit ushtrohet sistematikisht dhunë.

Të dhëna që shërbejnë si nxitje janë dhe ato që kanë të bëjnë mbi format e dhunës kundrejt të dyja gjinive, përkatësisht femra dhe meshkuj.

Mbi dhunën që ushtrohet kundrejt femrave në vendin tonë na vijnë të dhëna nga studimi Hazizaj, A., Coku, B., Cenko, E., Haxhiymeri, E., (2013). “Case-based surveillance study on violence against children in Albania”, CRCA, BECAN, Albania, Tirana B.E.C.A.N i zbatuar nga CRCA Shqipëri (2013), Shqipëria është bërë pjesë e këtij studimi si pjesë e një

studimi të madh të zhvilluara në Europë dhe në Ballkan ka përfshirë një kampion afërsisht 30.000 fëmijë dhe prindër.

Ky studim epidemiologjik ka përfshirë nëntë vende të Ballkanit si: Greqi, Bullgari, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Serbi, Shqipëri, Ish Republika Jugosllave, Maqedoni, Turqi dhe Rumani. Në lidhje me vendin tonë ky studim raporton se: sipas ndarjes gjinore, vajzat raportojnë dhunë psikologjike më të lartë sesa djemtë.

Në lidhje me dhunën fizike të dhënat nuk paraqesin ndryshime thelbësor të viktimizimit midis djemve dhe vajzave, ato variojnë me një prevalencë rreth 61% e vajzave dhe 58% e djemve. Ky studim raporton një incidencë relativisht të lartë nga 49% tek vajzat, 48% tek djemtë.

Në lidhje me ndjesinë e neglizhencës raportohen nivele më të larta tek vajzat sesa tek djemtë. Tek vajzat raportohet në masën 31% ndërkohë që tek djemtë raportohet një vlerë 20%. Incidenca varion nga 27% tek vajzat në 16% tek djemtë.

Pjesë e këtij studimi janë dhe të dhënat e raportuara pranë ALO 116 ndër vite, të dhëna këto që lidhen me dhunën ndaj fëmijëve të gjinisë femërore, ku vajzat vet- raportojnë historitë e tyre të dhunës dhe se si ato trajtohen ndryshe nga djemtë e familjes. Studimi reflekton perceptimet e vajzave sipas të cilave ato detyrohen të kryejë punë shtëpie, të rrisin vëllezërit ose motrat më të vegjël.


Jo rrallë herë vajzat ndërpresin studimet për shkak të përkatësisë gjinore të tyre. Prindërit e tyre shprehin frikën që kanë, se mos ato jo vetëm mund të ngacmohen nga djemtë, por shpesh të bëhen dhe viktima në jo pak raste dhe të trafikimit të tyre. Kjo është arsyeja pse

prindërit i detyrojnë vajzat e tyre të fejohen dhe të martohen që në moshë shumë të re. Pjesa e nënshtrimit vijon edhe në familjet ku ato martohen.

Marrëdhëniet vëllazërore gjithashtu shfaqen si një tjetër element që tregon se individët meshkujt brenda familjes marrin më tepër të drejta kundrejt vajzave, madje ata abuzojnë fizikisht mbi motrat, duke treguar se janë djem dhe se fjala e tyre ka më tepër rëndësi, se pozicioni dhe fjala e vajzave. Këto fenomeneve janë prezente jo vetëm në zonat rurale, por dhe në zonat urbane.

Gjatë 2010 statistikat paraqesin një përqindje të lartë abuzimi fizik , ai emocional, seksual si dhe neglizhimi.

**Grafiku 6:** Format e abuzimit me femrat gjatë 2010



*Burimi: Marrë nga "Case-based surveillance study on violence against children in Albania", 2013. CRCA & BECAN*



Fëmijë, të cilët kanë qenë pre e një niveli të tillë dhune sjell dëmtim të një zhvillimi normal emocional, fizik dhe psikologjik të tyre. Abuzimi seksual, sipas këtij studimi është një tjetër shqetësim i madh, ku vajzat ende fëmijë shfrytëzohen nga të rritur të njohur ose të panjohur.


Po sipas këtij studimi vërejmë se në llojet më të përhapura të dhunës te adoleshentet vajza gjatë vitit 2011, të zënë vend problemet me partnerin që përbëjnë 35% të rasteve, problemet me miqtë 19%, ndërsa marrëdhënia prind-fëmijë 19 %.

Vajzat gjatë 2011, raportojnë më tepër për shqetësime që kanë të bëjnë me aspektin emocional të marrëdhënieve intime.

Llojet më të përhapura të dhunës së ushtruar tek fëmijët vajza, gjatë vitit 2012, ngelen marrëdhënia me të tjerët, me partnerin, me prindërit, që janë ndër problemet me shpesh të raportuara pranë ALO 116.

Duket qartë se një ndër sfidat më të mëdha jo vetëm të çdo individi, por edhe të shoqërisë sone është krijimi normal i raporteve sociale me të tjerët. Linja Kombëtare e Ndhmës për Fëmijët si dhe Albanian National Child Helpline në raportin e tyre tematik mbi dhunën tek fëmijët vajza organizuar nga UNICEF, CRCA “Ditët e Aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore”, Nëntor 2013, Tiranë, raporton format e mëposhtme të abuzimit.

**Grafiku 7:** Format e abuzimit me vajzat(6-18) raportuar gjatë 2011, 2012 pranë ALO 116



Burimi: Marrë nga “Case-based surveillance study on violence against children in Albania”, 2013. CRCA & BECAN

Studimi i kryer në 2014 nga UNICEF, Një pasqyrë e statistikave të dhunës kundër vajzave adoleshente, raportohen të dhëna shqetësuese, sipas të cilave në mbarë botën në vitin 2012, dhuna ka marrë jetën e rreth 54.000 vajzat adoleshente të moshës 10 deri 19 vjeç. Duke e bërë atë shkakun e dytë kryesor të vdekjeve, pas sëmundjeve infektive dhe parazitare.

Nivelet më të larta të vdekjes së dhunshme në mesin e vajzave adoleshente janë gjetur në Azinë Jugore, ku pothuajse 30.000 vajza në vitin 2012 kanë vdekur si pasojë e dhunës.

Kjo përkthehet në një normë të vdekjes së 19 për 100,000 - rreth dy herë normën globale.

Rreziku që ka një vajzë të vdes si rezultat i dhunës rritet nga fëmijëria e hershme deri në fund të adoleshencës .

Të dhënat nga viti 2012 tregojnë se rreth 11.000 vajza të moshës 10 - 14 vjeç, vdesin nga një formë e dhunës, duke shfaqur një normë vdekshmërie 4 për 100.000 adoleshente. Në

mesin e vajzave adoleshente të moshës 15 deri 19, numri i të vdekurve nga dhuna është edhe më e lartë, me pothuajse 44.000 viktima, ose 15 për 100,000.

Të dhënat tregojnë se forma më e zakonshme e dhunës fizike që fëmijët dhe adoleshentët përjetojnë ndodh në kontekstin e disiplinës – zakonisht në shtëpitë e tyre ose nga kujdestarët e tyre. Në mesin e vajzave më të reja adoleshente të moshës 10 deri në 14, gati dy nga tre i nënshtrohen ndëshkimit trupor.

Vajzat adoleshente që vazhdojnë të përjetojnë ndëshkimin fizik nga prindërit në adoleshencën e vonë dhe në të njëjtën kohë nga partnerët intimë bëhen të prirur për kryerjen e agresionit fizik. Në mesin e vajzave të moshës 15 deri 19 vjeç në mbarë botën, pothuajse një e katërta (rreth 70 milion) ka thënë se ato ishin viktima të ndonjë forme të dhunës fizike që nga mosha 15 vjeç.

Përqindja e vajzave adoleshente që raportojnë se kanë përjetuar ndonjë formë të dhunës fizike që nga mosha 15 vjeç ndryshon shumë nga vendet me të ardhura të ulta, nga ato mesatare.

Dhuna e ushtruar nga partneri përfshin çdo abuzim fizik, seksual ose emocional të ushtruar nga partneri, kjo në kontekstin e martesës, bashkëjetesë apo ndonjë bashkim tjetër formal apo informal. Dhuna drejtuar ndaj vajzave dhe grave nga partneri intim është forma më e zakonshme e dhunës me bazë gjinore.

Në shoqëritë që sanksionojnë dominancën mashkullore ndaj femrave, dhuna midis partnerëve intim mund të perceptohet, si një komponent i zakonshëm i dinamikës

ndërpersonale mes gjinive, veçanërisht në kontekstin e martesës apo lidhjeve të tjera formale.

Globalisht, gati një në tre vajza adoleshente të moshës 15 deri 19 (84 milionë), kanë qenë viktima të dhunës emocionale, fizike apo seksuale të kryer nga burrat apo partnerët e tyre në një fazë në jetën e tyre. Të dhëna të krahasueshme nga 42 vende me standart të ulët dhe të mesëm të jetesës, tregojnë se shkalla e prevalencës për dhunën nga partneri ndaj vajzave adoleshente, janë veçanërisht të larta në Saharanë Afrikane mbi 60%. Ndërsa në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Bashkësinë e Shteteve të Pavarura (Komonuethlit) ajo bie në 28 për qind.

Afër gjysma e të gjitha vajzave të moshës 15 deri 19 në gjithë botën (rreth 126 milionë), mendojnë se një bashkëshort apo partner ndonjëherë është i justifikuar të godas apo rrah gruan e tij, në rrethana të caktuara - në qoftë se gruaja nuk i jep argumenta burrit të saj, shkon diku pa i thënë atij, neglizhon fëmijët, refuzon të ketë marrëdhënie seksuale me të ose për shkak të përgatitjes së ushqimit.

Diferencat mes vajzave të shkolluara dhe atyre të pashkolluara është e lartë, por ky hendek është më i theksuar në Lindjen e Mesme dhe në Afrikën e Veriut, ku 67 për qind e vajzave pa arsim mendoj se një burri nganjëherë është i justifikuar në rrahjen e gruas e tij, në krahasim me 35 për qind e atyre me nivele të larta të arsimit, që nuk e justifikojnë në asnjë mënyrë një veprim të tillë.

Fenomenet shoqëruese të adoleshencës, si agresiviteti dhe sjelljet antisociale kanë filluar të jenë në fokus gjithnjë e më shumë në shoqërinë shqiptare dhe në gazetat e përditshme apo mediat e ndryshme.

Po ti referohemi medias së shkruar apo vizive, vërejmë se janë pikërisht sjelljet ekstreme ato që të shkaktuara nga këto grupmosha kanë tronditur thellë opinionin publik, duke filluar nga plagosje të njëri-tjetrit, armëmbajtje dhe përdorim të tyre, duke shkaktuar tragjedi familjare të ndryshme.

Kjo ka bërë që në fokus të gjithë shoqërisë të serviren problemet e adoleshentëve dhe gjendja e tyre brenda një realiteti, si një shoqëri në tranzicion, por mënyra standarte e trajtimit ngelet tepër teorike, duke mos patur deri më sot asnjë platformë kombëtare për parandalimin apo minimizimin e këtyre fenomenve.

## KAPITULLI V

### METODOLOGJIA

#### Tipi i studimit

Kjo temë vjen si produkt i analizës së këndvështrimeve teorike dhe praktike, duke projektuar në mënyrë sa më racionale raportet midis pikëpamjeve teorike dhe të dhënave reale.

Metoda e përdorur në studim është ajo sasiore, e realizuar përmes pyetsorëve vetëraportues në një kampion përfaqësues të popullatës në gjithë vendin.

#### 5.1 Hipoteza dhe Pyetjet Kërkimore

**P. 1-** Cilat janë format e shfaqjes së agresivitetit dhe nxitësit përkatës dhe a ekziston një lidhje domethënëse mes tyre?

**H.1** – Ekziston nje lidhje statistikore e rëndësishme mes formave të agresivitetit dhe llojeve të nxitësve të tij tek adoleshentët.

**P.2-** A ekzistojnë dallime gjinore mes formave të agresivitetit dhe llojeve të nxitësve të tij tek adoleshentët?

**H.2-** Ekzistojnë dallime gjinore mes formave të agresivitetit dhe llojeve të nxitësve të tij tek adoleshentët.

## 5.2 Procedura dhe Pjesëmarrësit

Jo vetëm për efekt studimi, por për të njohur më thellë adoleshentët dhe problemet e tyre, u interesuam pranë institucioneve të ndryshme, me qëllim mos përqendrimin vetëm tek të dhënat statistikore që publikon Ministria e Arsimit, pasi atje numri i nxënësve që janë përjashtuar nga shkolla për akte të dhunshme ose thyerje të rënda të rregulloreve, nuk specifikohen, por paraqiten thjesht, si të larguar.

Për të analizuar fenomenin e agresivitetit dhe sjelljeve antisociale është dashur të fokusohemi edhe në të dhënat specifike pranë drejtorive të shkollave.

Në disa prej shkollave të mesme të qyteteve të rëndësishme, si në Tiranë, vërehet që nxënës meshkuj humbin vitin shkollor për disa arsye si më mëposht, të listuara këto sipas shkallës së veprimit: largimet nga orët e mësimit, dhunës kundrejt bashkëmoshatarëve ose objekteve shkollore, si dhe konsumit të alkolit apo shpërndarjes së lëndëve narkotike brenda mjediseve shkollore.

Krejt ndryshe ndodh në zona më pak të zhvilluara, ku numri i nxënësve që humbasin vitin shkollor për këto arsye është më i vogël dhe aspak në masë të konsiderueshme në zona e thella rurale, ku arsyet e largimit nga shkolla janë kryesisht rastet kur adoleshenti lëvizin drejt një qëndre tjetër banimi.

Në fokus të studimit janë adoleshentët femra e meshkuj duke u përqendruar në disa nga variablat kryesor të shfaqjes së agresivitetit të tyre.

Për të matur agresivitetin tek djemtë dhe vajzat ky studim u realizua me nxënës nga 12 qarqet e vendit. Studimi nuk u përqendrua vetëm me të rinj të qyteteve gjithnjë e më shumë në lëvizje, por dhe me ata në zona urbane dhe rurale.

***Kryerja e anketimit u realizua në fazat e mëposhtme:***

**Hyrja:** ku çdo nxënësi iu bë e qartë thelbi i zhvillimit të këtij anketimi.

**Sqarimi:** ku behej e qartë se çfarë do të shënohet në ID, mos harrimi i plotësimit të qarkut, moshës apo gjinisë si dhe ndarjet dhe alternativat prej të cilave duhet të përzgjidhnin.

**Zhvillimi:** secili nxënës plotëson alternativat.

**Mbledhja e të dhënave:** hedhja e të dhënave dhe në përfundim vlerësimi i tyre.

Anketimi nuk është aplikuar me identifikim të emrit personal. Çdo nxënës që pranoi të kryente këtë anketim kishte të drejtën të pyeste për çdo pyetje apo paqartësi. Nxënësit u testuan duke filluar nga nëntori 2014 deri në shkurt të 2015.

Për të arritur në kampionin e përlllogaritur prej 816 adoleshentë është dashur të kontaktohej me më shumë adoleshentë, përkatësisht 901, pasi gjatë procedurës 39 femra dhe 46 meshkuj të moshës 15 vjeçare, që ndiqnin klasën e 10-të, nuk pranuan të merrnin pjesë, sepse e kishin kryer atë një vit më parë.

Nga të 816 nxënësit që kanë plotësuar pyetsorin në 12 qarqe të vendit, vetëm disa prej tyre nuk e kanë kryer testimin deri në fund.

### **5.2.1 Përlllogaritja e numrit të nxënësve që morën pjesë në studim**

Për të përlllogaritur numrin e nxënësve janë shfrytëzuar të dhënat e mëposhtme sipas INSTAT (2014). Shqipëria në Shifra. Botime INSTAT, Tiranë, fq. 6, 14.



**Tabela 7:** Popullsia e përgjithshme(MF), femra(F), meshkuj(M) sipas qarqeve në Shqipëri

Qarku	1/1/2014		
	MF	M	F
<b>Berat</b>	145,097	73,502	71,595
<b>Dibër</b>	138,321	70,919	67,402
<b>Durrës</b>	275,205	139,399	135,806
<b>Elbasan</b>	302,827	153,272	149,555
<b>Fier</b>	317,799	161,736	156,063
<b>Gjirokastrë</b>	73,556	37,470	36,086
<b>Korçë</b>	226,066	114,906	111,160
<b>Kukës</b>	86,472	43,870	42,602
<b>Lezhë</b>	138,214	69,631	68,583
<b>Shkodër</b>	221,235	110,461	110,774
<b>Tiranë</b>	788,330	392,273	396,057
<b>Vlorë</b>	182,825	92,524	90,301
<b>Gjithsej / Total</b>	<b>2,895,947</b>	<b>1,459,963</b>	<b>1,435,984</b>

*Burimi: Marrë nga INSTAT “Shqipëria në Shifra, 2014”*

Më poshtë paraqitet numri i nxënësve të regjistruar në shkollat e mesme, të dhëna po sipas INSTAT.

**Tabela 7.1.** Numri i femrave dhe meshkujve të grupmoshës 15-19 vjeç

Grupmosha	2014		
	MF	M	F
<b>15-19</b>	254005	129528	124476

*Burimi: Marrë nga INSTAT “Shqipëria në Shifra, 2014”*

**Tabela 7.2.** Nxënës të regjistruar në shkollat e mesme në Shqipëri

Viti Shkollor	Nxënës gjithsej	E Mesme e Përgjithshme			E Mesme Profesionale		
		Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej Total	Meshkuj	Femra
		Total	Male	Female	Total	Male	Female
<b>2013 - 14</b>	151937	124619	61163	63456	27318	21473	5845

*Burimi: Marrë nga INSTAT "Shqipëria në Shifra, 2014"*

**Supozimet bazë gjatë përcaktimit të numrit të nxënësve :**

1. Numri i nxënësve të zgjedhur për çdo qark bëhet në bazë të përqindjes së popullsisë që qarku zë në Republikën e Shqipërisë.
2. Gabimi kufi  $\Delta$  është marrë sa 25%,  $\Delta = 0.25$  e numrit total të popullsisë së kësaj grupmoshe.
3. Raporti i popullsisë meshkuj, femrat është 49.6% me 50.4%. Në shifra kaq te përafërta, ndikimi është i papërfillshem, sepse është më i vogël se 5%,  $\Delta = 0.5$ .

Grupmosha 15 – 19 vjeç në raport me popullsinë:  $256553/2895947 = 0.088 \sim 0.09$

Raporti i numrit të nxënësve regjistruar në shkollat e mesme, me totalin e kësaj grupmoshe :

$$151937/256553 = 59.2\%$$

Mbi supozimet e mësipërme llogaritet gabimi kufi : (në total grupmoshe dhe për shkollat e mesme)

$$\Delta = 0.25 * 256553 = 64138.25$$

$$\Delta = 0.25 * 151937 = 37984.25$$

Me formulën e përcaktimit të vëllimit të zgjedhjes rastesore:  $n = \frac{Np(1-p)}{\frac{\Delta}{4N} + p(1-p)}$

$$n = 2895947 * 0.088 * 0.912 / (64138.25^2 / 4 * 2895947) + 0.01 = 815.5 \sim 816$$

persona në grupmoshën 15 – 19 vjeç.


Referuar përqindjes së popullsisë nëpër rrethe, numri i të testuarve do të jetë:

**Tabela 8.** Numri i nxënësve që marrin pjesë në studim sipas zonave

Qarku	Total / qark	Urbane	Rurale
<b>Berat</b>	41	22	19
<b>Dibër</b>	39	21	18
<b>Durrës</b>	78	41	37
<b>Elbasan</b>	85	45	40
<b>Fier</b>	90	48	42
<b>Gjirokastrë</b>	21	11	10
<b>Korçë</b>	64	34	30
<b>Kukës</b>	24	13	11
<b>Lezhë</b>	39	21	18
<b>Shkodër</b>	62	33	29
<b>Tiranë</b>	222	118	104
<b>Vlorë</b>	51	27	24
<b>Gjithsej / Total</b>	816	434	382

Ndërkohë më poshtë paraqitet grafiku që përmban përqindjet sipas numrit të nxënësve pjesëmarrës për çdo qark.

**Grafiku 8.** Përqindja e numrit të nxënësve sipas numrit të nxënësve pjesëmarrës për çdo qark.



Adoleshentët e përfshirë në studim i përkasin grupmoshës 15-19 vjeç në bazë të statistikave të ofruara nga INSTAT.

Adoleshentët që morën pjesë në studim ndjekin studimet në arsimin e mesëm të lartë, përkatësisht në shkollat e mesme të përgjithshme, profesionale dhe të orientuara.

Nxënësit i takojnë klasave të 10- 12/13.

U testuan 816 adoleshentë në të 12 qarqet e Shqipërisë, si në zonat urbane dhe ato rurale:

Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë, nga të cilët 427 femra, përkatësisht 52.32% koduar në testim me vlerën 0, dhe 389 meshkuj, 47.67% koduar në testim me vlerën 1.


Nga pjesëmarrësit 201 nxënës janë meshkuj të zonave urbane, pra 52.67% dhe 181 nxënës të zonave rurale duke përbërë 46.52% të atyre që kanë marrë pjesë në testim.

**Tabela 9.** Të dhëna mbi numrin e pjesëmarrësve sipas moshave

Qarqe	15 vjeç	16 vjeç	17 vjeç	18 vjeç	19 vjeç	Total	Përqindja
<b>Urbane</b>	88	106	98	78	64	434	53.18
<b>Femra</b>	47	65	47	41	26	226	52.07
<b>Meshkuj</b>	41	41	51	37	38	208	47.92
<b>Rurale</b>	78	76	82	77	69	382	46.81
<b>Femra</b>	37	44	40	43	37	201	52.61
<b>Meshkuj</b>	41	32	42	34	32	182	47.64

Në studim u përfshinë 160 nxënës të moshës 15vjeç, rreth 19,6 % të të testuarave, të koduar me numrin 1, 195 nxënës i përkasin moshës 16 vjeç, pra 23,8%, të koduar me numrin 2, 179 nxënës i takojnë moshës 17 vjeçare 21, 93% të të testuarave, të koduar me numrin 3, 148 nxënës i përkasin moshës 18 vjeç, duke përbërë 18,1% të të anketuarve, të koduar me numrin 4, si dhe 134 nxënës të moshës 19 vjeç që i përkasin respektivisht 16.4% të të anketuarve, të koduar me numrin 5.

**Grafiku 9:** Përqindjet e nxënësve pjesëmarrës në studim sipas moshave



Pesha e çdo qarku është në raporte proporcionale me përqindjen e popullsisë së këtyre qarqeve kundrejt popullsisë totale. Po sipas të dhënave të INSTAT më poshtë do të gjeni tabelën e popullsisë në qarqet e Shqipërisë.

*Shënim:* Ndarja e popullsisë në ate rurale dhe urbane, është bërë duke llogaritur përqindjen e popullsisë urbane mbi ate rurale për grupmoshën 15 – 19 vjeç mbi të cilin do kryhet studimi dhe ky raport është plotësuar edhe me përqindjet përkatëse për çdo qark mbi numrin total të popullsisë.

### 5.3 Instrumenti i përdorur

Në dilemën e përzgjedhjes së testit midis BDH “Buss, Durkee, (1957); i ripunuar nga “Buss & Perry dhe i ripunuar përsëri nga Buss & Warren (2000), i përdorur në mbi 245 vende me popullsi dhe kultura të ndryshme dhe ARES zgjedha të përdor ARES (The Anger Regulation and Expression Scale).

BDH ashtu si dhe ARES përmban 75 pyetje. Të dy përdoren dhe me variante më të shkurtër në përdorim, por BDH i mungojnë nxitësit.

ARES është një pyetsor i vitit 2011 dhe i validituar në disa vende si SHBA dhe Kanada. Në gjuhën shqipe, pyetsori vetraportues ARES është përkthyer dhe përgatitur nga Agetina Smajlaj dhe Gladiola Musabelliu, të cilat kanë kaluar me sukses dy fazat e para dhe presin fazën përmbyllëse të validimit nga MHS të këtij pyetsori dhe për popullsinë shqiptare.

Pyetsori i përzgjedhur dhe përdorur është ARES, 2011 (Raymond DiGiuseppe & Raymond Chip Tafrate). Mostra normative e këtij pyetsori ka përfshirë 800 vetraportime nga moshë 10- 17 vjeç, në proporcion kjo me moshën, gjininë apo dhe etninë në SHBA dhe Kanada.

ARES mund të gjendet në dy format online dhe duke përdorur Software përkatës.

Natyrisht që pyetësi mund të realizohet edhe pasi të jetë bërë printimi (website: [www.mhs.com/](http://www.mhs.com/) ARES, USA, canada.

Ky pyetsor mat shkallët totale të inatit dhe ato në grup, me shkallët dhe nënshkallët përkatëse si: inatin e internalizuar, atë të ekstrenalizuar dhe nxitësit përkatës. Totali T-score i të cilës është 71( 90% CL = 68-74).

Duke qenë se fokus i studimit tonë është agresiviteti dhe nxitësit, është marrë në studim

inati i ekstrenalizuar me nënshkallët e tij agresiviteti i shfaqur me total 79 (90 % CL = 73-85) me dy nënshkallët e tij : agresiviteti verbal me total 80 (90 % CL = 74-86) dhe ai fizik me total 73 (90 % CL = 65-81), agresiviteti i fshehur me total 72 (90 % CL = 64 - 79) , hakmarrja me total 68 (90 % CL = 62 - 74), përmbysja me total 73 (90 % CL = 67 - 79) me dy nënshkallët e saj, përkatësisht agresivitetin marrëdhënor me total 78 (90 % CL = 72 - 84) dhe atë pasiv me total 67 (90 % CL = 59- 75) dhe bulling me total 76 (90 % CL = 69 – 83). Referuar lidhjeve korrelacionale sipas ARES pikëzimi total është r. 64 - .70, ndërsa ato të inatit të ekstrenalizuar, që është dhe fokusi ynë .62- .70.

### **5.3.1 Variabla të Pavarur**

#### **Ditëlindja/ Mosha**

Përkufizimi operacional: Mosha e pjesëmarrësit e paraqitur në vjeç, nga lindja deri në momentin e intervistimit.

Shkalla e matjes: Numerike (mosha ekzakte e dhënë, në vjeç si p.sh. dt. 30.08.2000, 14 vjeç, 15, 16,... vjeç etj).

#### **Klasa**

Përkufizim operacional: klasa të cilën nxënësi ndjek nga 10- 12/13

#### **Gjinia**

Përkufizimi operacional: Seksi biologjik i subjektit të regjistruar sipas ID përkatëse.

Shkalla e matjes: Nominal (mashkull/ femër)

#### **Aktualisht ndjek shkollën**

Përkufizimi operacional: Fakti që subjekti ndjek shkollën në momentin e studimit objekt i mëparshëm i studimit.



### **Arsimi që ndjek aktualisht**

Përkufizimi operacional: Profili i shkollës, që pjesëmarrësi adoleshent frekuenton aktualisht. Vlera e shkallës së matjes: Nominale (arsimi i mesëm i lartë i përgjithshëm, profesional ose orientuar).

### **Qarku**

Përkufizim operacional: Zona e Shqipërisë, mbështetur në evidentimin e qarqeve të ndryshme të cilat janë përfshirë në këtë studim.

Vlera e shkallës së matjes: Nominale (Zonë Urbane ose Zonë Rurale).

### ***Nxitësit dhe kohëzgjatja e episodit***

Adoleshenti cilëson nxitësit sipas shkallës që ata shkaktojnë tek secili prej tyre, sikundër ata mund të përshkruajnë sa është kohëzgjatja e një episodi zemërimi. Variablat e ndryshëm brenda kësaj shkalle janë: qëllimi (nxitësit e një episodi), do të merret në konsideratë pasi është qëllimi i studimit, zgjatja e problemit (i rëndësishëm për ndjekjen klinike të pacientit) dhe zgjatja e episodit.

Ky lloj variabli do të konsiderohet i pavarur sipas shkallës së ndikimit në lidhje me të gjitha format e agresivitetit, të shfaqur (agresiviteti fizik dhe verbal), agresivitetit të fshehur, përmbysjen (me nënshkallët përkatëse: agresiviteti marrdhënor dhe pasiv), hakmarrja dhe bulling, që janë pjesë e këtij studimi.

### 5.3.2 Variablat e Varur

Pyetsori synon matjen e zemërimit të internalizuar dhe ekstrenalizuar dhe nxitësit.

Për arsye të qëllimit tonë të studimit është përdoret një pjesë e këtij instrumenti, përkatësisht zemërimi i ekstrenalizuar, aspektet psikologjike të të cilit janë format e agresivitetit si: **agresiviteti i shfaqur**, me dy nënshkallët e tij *agresiviteti fizik dhe verbal*, **agresiviteti i fshehur**, **përmbysja** me dy nënshkallët përkatëse, *agresivitetin marrëdhënor* dhe atë *pasiv*, **hakmarrja** si dhe **bulling**, që së bashku me **nxitësit** janë dhe variablat e varur.

Pyetsori, i cili përmban 75 pyetje, ku nuk ka përgjigje të saktë apo të gabuar, është i ndarë në seksionet e mëposhtme, brenda të cilëve janë marrë në konsideratë vetëm pyetjet që lidhen e me qëllimin e studimit:

Nga pyetja 1 deri tek 23 alternativat e përgjigjeve janë: *Pothuajse asnjëherë, asnjëherë, ndonjëherë, shpeshherë si dhe gjithmonë*, të cilat janë shprehur apo vlerësuar përkatësisht me numrat 1 deri në 5.

Nga pyetja 1 deri tek pyetja 57 pyetjet synojnë të matin si zemërimin internal dhe atë ekstrenal, duke qenë se ky i fundit është fokus i studimit tonë janë marrë parasysh vetë të dhënat që lidhen me **format e agresivitetit** si: **agresiviteti i shfaqur**, me dy nënshkallët *agresiviteti verbal dhe fizik*, **agresiviteti i fshehur**, **përmbysja** me dy nënshkallët e saj, *agresivitetin marrëdhënor* dhe atë *pasiv*, si dhe **hakmarrja** dhe **bulling**.

Nga pyetja 58 deri në 61 alternativat e përgjigjeve variojnë nga, *pothuajse asgjë, vetëm një gjë, disa gjëra, shumë gjëra*, si dhe *alternativa, pothuajse çdo ditë*. Alternativat janë koduar

dhe paraqitur në programin SPSS me vlerat nga 1 deri në 5. Ky grup pyetjesh kërkohet të identifikojë nxitësit e agresivitetit.

Nga pyetja 62 deri në 65 alternativat e përgjigjeve variojnë nga: *asnjëherë, një herë në jetën time, pak herë në jetën time, disa herë në jetën time, shumë herë në jetën time*. Alternativat hidhen gjithashtu në programin e të dhënave, duke qenë të kodifikuara përkatësisht me numrat nga 1 deri në 5. Ky grup pyetjesh kërkohet të identifikojë agresivitetin e fshehur.

Nga pyetja 66 deri në pyetjen 72 alternativat e përgjigjeve janë : *një javë ose më pak, ose aspak/ një muaj ose më pak, afërsisht 3 muaj, afërsisht 6 muaj, një vit ose më shumë*, alternativat e mësipërme janë koduar në vlera nga 1 deri në 5. Këto pyetje synojnë në identifikim dhe vlerësimin e kohëzgjatjes së problemit.

Nga pyetja 73 deri në pyetjen 75 alternativat e përgjigjeve variojnë nga: *vetëm pak minuta, pak orë, gjithë ditën, disa ditë, afërsisht një javë, afërsisht 2 ose 3 javë, një muaj ose më shumë*, të cilat janë koduar me vlerë nga 1 deri në 7 dhe synojnë të identifikojnë dhe vlerësojnë kohëzgjatjen e një episodi.

Duke filluar me agresivitetin e shfaqur si formë e shprehjes së zemërimit ekstrenal mund të themi se kur individi adoleshent ka zemërim e shpreh atë me agresivitet, i cili mund të jetë: i shfaqur me dy nënshkallët e tij: agresivitet fizik drejtuar objekteve dhe personave, qoftë edhe kundrejt dyerve dhe murreve, mund të shtyjnë, shajnë ose godasin të tjerët. Ata mund ta shprehin zemërimin e tyre dhe me agresivitet fizik duke dëmtuar pronën apo gjithçka, çfarë i përket personave me të cilët kanë inat ose gjejnë mënyra për të dëmtuar këta persona. Persona të tillë mund të shprehin zemërimin e tyre edhe me agresivitet verbal,

duke menduar se i japin sqarim problemeve duke bërë titur, por nuk mungojnë dhe komentet deri në sarkazëm, sepse mendojnë se kanë të drejtë.

Variablat e ndryshëm që janë përfshirë si pjesë e këtij studimi janë: agresiviteti i shfaqur, që përfshin agresivitetin fizik dhe verbal.

Disa nga pohimet që përfshihen këtu janë.

**28.** Inatosesh dhe u thua fjalë të hidhura njerëzve.

**35.** Inatosesh dhe bën gjëra të tilla si përplas dyert apo ecën me hapa të rëndë nëpër shtëpi .

**36.** Inatosesh aq shumë sa që u bërtet ose ulërin njerëzve.

**38.** Inatosesh aq shumë sapë godet objekte, si murre dhe tavolina.

Një formë tjetër e shprehjes së zemërimit të ekstrenalizuar është agresiviteti i fshehur, ku individët përfshihen në arritjen e qëllimeve të fshehta, ku ata përpiqen në çdo kohë të gjejnë rrugë dhe mënyra për të dëmtuar individët ose pronën e tyre.

**62.** Unë kam thyer gjëra në fshehtësi, në shtëpi apo në shkollë, sepse isha i/e inatosur.

**64.** Kur kam qenë i/e inatosur me dikë, unë jam përpjekur të gjej mënyra për të bërë që ai individ të dështojë pa e ditur ai apo ajo që isha unë shkaktari.

Një formë tjetër e shprehjes së zemërimit të ekstrenalizuar është hakmarrja, ku individët përpiqen në çdo kohë të gjejnë rrugë dhe harxhojnë energji për të dëmtuar të tjerët.

Individët adoleshent shpesh nuk ngurojnë të jenë hakmarrës, ata marrin hak.

**21.** Kur jam i/e inatosur me dikë, dua të marr hak ndaj atij personi.

**22.** Nëse dikush më inatos, unë bëj çdo gjë që duhet bërë për t' u hakmarrë ndaj atij personi.

Përmbysja është një tjetër shkallë ku përfshihen si nënshkallë agresiviteti marrëdhënor (të folurit keq ose duke fabrikuar histori të qëllimshme për ti bërë keq personave me të cilët kanë inat) dhe agresiviteti pasiv (që shprehet përmes injorimit të personave me të cilin kanë inat) si dhe bulling (dëshira për kontroll, intimidim për dominim) si dhe impulsiviteti (moskontroll i impulseve, që nuk janë të vërteta, por vetëm perceptimi i tyre).

Disa nga pohimet që përfshijnë këto variabla:

**46.** Inatosesh aq shumë me dikë saqë përpiqesh ta mbash atë individ jashtë rrethit tënd shoqëror.

**50.** Inatosesh aq shumë me dikë saqë fillon e tregon histori apo gënjeshtër për atë individ.

**51.** Inatosesh aq shumë me dikë saqë mundohesh ti ndalosh të tjerët të shoqërohen me atë individ.

**56.** Unë ushtroj presion psikologjik apo fizik ndaj të tjerëve që ti detyrojnë ata të bëjnë çfarë dua unë.

### ***Nxitësit dhe kohëzgjatja e episodit***

Adoleshenti cilëson nxitësit sipas shkallës që ata shkaktojnë tek secili prej tyre, sikundër ata mund të përshkruajnë sa është kohëzgjatja e një episodi zemërimi apo agresiviteti.

Variablat e ndryshëm brenda kësaj shkalle janë: qëllimi (nxitësit e një episodi), zgjatja e problemit dhe zgjatja e episodit, i cili interferon në marrëdhëniet ndërpersonale të individit adoleshent. Ky lloj variabli do të konsiderohet i varur sipas shkallës së ndikimit në lidhje me ndikimet gjinore (femra, meshkuj), vendbanimin dhe moshën.

Disa nga pohimet sipas variablave janë:

#### **Sa gjëra nxisin inatin tënd ....?**

**58.** Në shtëpi.

**59.** Në shkollë.

**60.** Me shokët/shoqet/miq të.

**61.** Në përgjithësi.

#### **Zgjatja e problemit**

**66.** *Inati im ka qënë problem për mua...*

**67.** Unë kam patur probleme inati ndaj fëmijëve të tjerë për.

**70.** Njerëzit në shkollë do të thoshin se unë kam patur problem inati për...

#### **Zgjatja e episodit**

**73.** Kur inatosem në shtëpi, inati im zakonisht zgjat për...

**74.** Kur zemërohem me shokët e mi, unë rri i/e zemëruar për...

**75.** Kur inatosem në shkollë, inati im zakonisht zgjat për...

## KAPITULLI VI

### ANALIZA DHE REZULTATE

#### 6.1 Analizë statistikore

Analiza statistikore e të dhënave është kryer plotësisht me programin statistikor SPSS (eng. Statistical Package for Social Sciences), versioni 20. Për të përshkruar, vlerësuar dhe interpretuar të dhënat e disponueshme në këtë studim janë përdorur lidhjet midis variablave të ndryshme duke përdorur korrelacionin në përputhje me llojin e variablave si dhe analizën në bazë të tabelave T.

Përsa i takon variableve numerike janë raportuar madhësitë e mesatares aritmetike dhe shmangia standarde. Ndërsa përsa i takon ndryshorëve kategorikë, janë raportuar numra absolutë shoqëruar nga përqindjet respektive.

Variablat numerike marrin vlerë kur flasim për vlerën mesatare të tyre. Vlera e mesatares merr kuptim në krahasimin e variablave midis grupeve në studim.

Për vlerësimin dhe krahasimin e vlerave numerike mesatare mes dy grupeve u përdor analiza testi “t” për  $p < 0.05$ .

Rezultatet janë raportuar kur vlerat përkatëse domethënëse statistikore kanë qenë më të vogla se 5%.

Për paraqitjen e të dhënave janë përdorur tabelat, për paraqitjen apo vizualizim të dhënave kategorike janë përdorur bar-diagramet.

## **6.2 Të dhëna të përgjithshme lidhur me studimin**

Në mënyrë të përmbledhur, ky studim ka përfshirë 816 nxënës të moshës nga 15-19 vjeç. 434 nxënës i përkasin vendbanimit zonë urbane, koduar me 0 dhe 382 zonë rurale, koduar me vlerën 1.

Në studim kanë marrë pjesë më tepër adoleshente femra se meshkuj përkatësisht 427 femra 52.32% dhe 389 meshkuj 47.67%. Prej tyre 226 janë adoleshente femra, të cilat jetojnë në zonat urbane e që përbëjnë përkatësisht 52% të femrave dhe 201 adoleshente femra, të cilat jetojnë në zonat rurale, që përbejnë dhe 48% e femrave që marrin pjesë në plotësimin e pyetsorit. Ndërsa 208 janë adoleshentë meshkuj, të cilët jetojnë në zonat urbane e që përbëjnë 47.92% dhe 182 janë adoleshentë meshkuj, që jetojnë në zonat rurale, duke përbërë 47.64% të tyre.

## **6.3 Statistikë Deskriptive**

Statistika deskriptive raporton mbi frekuencën e vlerave që adoleshentët pjesëmarrës shfaqin për secilën nga format e agresivitetit në total. Në tabelën 10 në rastet kur numri i nxënësve rezulton jo 816 po 815 duke reflektuar mos plotësimin e njërit nga elementët nga ana e nxënësve.

Vlera të cilës i referohemi shprehet në këtë statistikë me “mean”= “mesatare”, gjithashtu paraqiten vlerat minimale dhe maksimale që mund të marrin format e agresivitetit në statistikën deskriptive, si dhe deviacioni standart.



**Tabela 10:** Statistikë deskriptive mbi format e agresivitetit

<b>Statistikë deskriptive</b>					
	N	Minimum	Maximum	Mesatare	Deviacioni standart
Agresiviteti i shfaqur	816	1,00	4,49	2,0107	,73343
Hakmarrja	816	1,00	4,83	1,9792	,77326
Përmbysja (Ag. marrëdhënor) (Ag. Pasiv)	816	1,00	4,67	2,1714	,65487
Bulling	815	1,00	5,00	2,0000	,93060
Agresiviteti i fshehur	816	1,00	5,00	1,9976	,83158
Vlera të vlefshme (Listenweise)	815				

Agresiviteti i shfaqur paraqitet për kategoritë nga 1 deri në 5 me 2.02, tek agresiviteti i fshehur raportohet 1.9. Bulling, përmbysja rezultojnë me vlera pothuajse të njëjta përkatësisht 2.00 dhe 2.17 për kategoritë 1 deri në 5, pra praktikisht nuk na paraqiten me vlera domethënëse.

**Tabela 10.1** Statistikë deskriptive për agresivitetin fizik dhe atë verbal

<b>Statistikë Deskriptive</b>					
	Nr.	Minimum	Maksimum	mean -mesatare	Deviacioni Standart
Ag. Fizik	816	1,00	4,78	1,9567	,73360
Ag. Verbal	815	1,00	5,00	2,0624	,84048
Nr. Valid	815				

Sipas tabelës dhe nënshkallët e agresivitetit të shfaqur si, agresiviteti ai fizik dhe ai verbal, paraqiten pothuajse me vlera të njëjta përkatësisht me: 1,95, 2,06 për kategoritë nga 1 deri në 5.

**Tabela 10.2:** Frekuenca e formave të agresivitetit sipas kategorive nga 1-5

	Vlefshmëria		Mungesa		Në Total	
	N	Përqindje	N	Përqindje	N	Përqindje
Agresivitet K.1	281	34,4%	535	65,6%	816	100,0%
Agresivitet K.2	231	28,3%	585	71,7%	816	100,0%
Agresivitet K.3	138	16,9%	678	83,1%	816	100,0%
Agresivitet K.4	25	3,1%	791	96,9%	816	100,0%
Agresivitet K.5	12	1,5%	804	98,5%	816	100,0%

Në tabelë paraqiten vlerat e shprehjes së agresivitetit dhe përqindjet sipas përgjigjeve të dhëna ajo që bie në sy janë vlerat 3- 5 që zënë në total 21.5 % të vetraportimeve, ku 16.9% e tyre kanë zgjedhur alternativën 3, përkatësisht përgjigjen *ndonjëherë ose afërsisht njëherë në javë*.

Vetëm 3.1 % e tyre kanë përzgjedhur alternativën 4, përkatësisht shpeshherë dhe afërsisht disa herë në javë, ndërsa vlera 5 përbën vetëm 1.5 % të përgjigjeve të përzgjedhur, përkatësisht *gjithmonë si dhe pothuajse çdo ditë*.

Nëse do ti referohemi vlerave më të detajuara sipas formave të agresivitetit, në tabelën e mëposhtme rezulton se: tek agresiviteti i fshehur nxënësit kanë përzgjedhur alternativën 3 duke përbërë 22.8% të përgjigjeve, ndërsa tek bulling kemi dhe vlerën më të lartë të përzgjedhjes së vlerës 3, përkatësisht 40, 4 % e nxënësve.

**Tabela10.3.** Frekuenca e shfaqjes së formave të agresivitetit për kategorinë 3

Kategoria 3	Përgjigjet		Përqindjet e rasteve
	Nr	Përqindje	
Agresivitet i shfaqur	2	1,2%	1,4%
Agresivitet i fshehur	39	22,8%	28,3%
Hakmarrja	36	21,1%	26,1%
Përmbysja (Agresiviteti marrëdhënor) (Agresiviteti pasiv)	25	14,6%	18,1%
Bulling	69	40,4%	50,0%
Në Total	171	100,0%	123,9%

Në lidhje me dy nënshkallët e agresivitetit të shfaqur, përkatësisht me agresivitetin fizik dhe atë verbal po për kategorinë 3 nxënësit kanë zgjedhur vlerën më të lartë tek agresiviteti verbal 73% e tyre kanë zgjedhur agresivitetin verbal kundrejt 27% që kanë zgjedhur agresivitetin fizik gjithmonë në lidhje me kategorinë 3

**Tabela 10.4** Frekuenca e shfaqjes agresivitetit fizik dhe verbal për kategorinë 3

Kategoria 3	Përgjigjet		Përqindja e rasteve
	N	Përqindjet	
Agresiviteti Fizik	17	27,0%	27,4%
Agresiviteti Verbal	46	73,0%	74,2%
Në Total	63	100,0%	101,6%

Përsa i takon kategorisë 4, përkatësisht *shpeshherë* dhe *afërsisht disa herë në javë* në tabelën e mëposhtme konstatohet se: përsëri nxënësit kanë zgjedhur tek agresiviteti i fshehur

dhe bulling vlerën më të lartë përkatësisht agresiviteti i fshehur: 22.8% dhe bulling 40.4% dhe përqindja më e ulët e përzgjedhur për kategorinë 4 rezulton te agresiviteti i shfaqur.

**Tabela 10.5.** Frekuenca e shfaqjes së formave të agresivitetit për kategorinë 4

Kategoria 4	Përgjigjet		Përqindjet e rasteve
	Nr	Përqindja	
Agresiviteti i shfaqur	1	3,6%	4,0%
Agresivitet i fshehur	8	28,6%	32,0%
Hakmarrja	3	10,7%	12,0%
Përmbysja (Agresiviteti marrëdhënor) (Agresiviteti pasiv)	3	10,7%	12,0%
Bulling	13	46,4%	52,0%
Në Total	28	100,0%	112,0%

Ajo që bie në sy tek kategoria 4 përkatësisht për aletrnativën *shpeshherë* dhe *afërsisht disa herë në javë* agresiviteti verbal parqitet me vlerë më të lartë se ai fizik. Agresiviteti verbal zë 55.6% të përgjigjeve, ndërsa agresiviteti fizik 44.4 % të përgjigjeve të zgjedhura për kategorinë 4.

**Tabela 10.6.** Frekuenca e shfaqjes së agresivitetit fizik dhe verbal për kategorinë 4

Kategoria 4	Përgjigjet		Përqindjet e rasteve
	N	Përqindja	
Agresiviteti Fizik	4	44,4%	50,0%
Agresiviteti Verbal	5	55,6%	62,5%
Në Total	9	100,0%	112,5%

Përsa i takon kategorisë 5, përkatësisht *gjithmonë* dhe *pothuajse çdo ditë* në tabelën e mëposhtme konstatohet se: nxënësit kanë zgjedhur këtë vlerë vetëm tek agresiviteti i fshehur dhe bulling, përkatësisht agresiviteti i fshehur: 38.5% dhe bulling 61.5%.

**Tabela 10.7.** Frekuenca e shfaqjes së formave të agresivitetit për kategorinë 5

Kategoria 5	Përgjigjet		Përqindjet e rasteve
	N	Përqindjet	
Agresivitet i fshehur	5	38,5%	41,7%
Bulling	8	61,5%	66,7%
Në Total	13	100,0%	108,3%

Të njëjtën gjë pak a shumë vërejmë dhe tek agresiviteti fizik dhe ai verbal ku për kategorinë e përzgjedhur 5 përkatësisht *gjithmonë* dhe *pothuajse çdo ditë*, ku kemi një numër të papërfillshëm, ku vetëm një nxënës ka përzgjedhur këtë kategori dhe asnjë nuk ka përzgjedhur këtë kategori për agresivitetin fizik.

**Tabela 10.8.** Frekuenca e shfaqjes së agresivitetit fizik dhe verbal për kategorinë 5

Kategoria 5	Përgjigjet		Përqindjet e rasteve
	N	Përqindja	
Agresiviteti Verbal	1	100,0%	100,0%
Në Total	1	100,0%	100,0%

## 6.4 Lidhjet korrelative mes variablave

Në tabelën e mëposhtme paraqiten vlerat sesi format e agresivitetit krijojnë lidhje me njëra tjetrën dhe më pas lidhja që këto forma krijojnë me nxitësit.

**Tabela 11.** Lidhjet korrelacionale mes formave të ndryshme të agresivitetit

		Ag. i shfaqur	Ag. i fshehur	Hakmarrja	Përmbysja	Bulling
Ag. i shfaqur	Korrelation nach Pearson	1	,673**	,732**	,694**	,706**
	Signifikanz (2-seitig)		,000	,000	,000	,000
	N	816	816	816	816	815
Ag. i fshehur	Korrelation nach Pearson	,673**	1	,654**	,608**	,558**
	Signifikanz (2-seitig)	,000		,000	,000	,000
	N	816	816	816	816	815
Hakmarrja	Korrelation nach Pearson	,732**	,654**	1	,646**	,511**
	Signifikanz (2-seitig)	,000	,000		,000	,000
	N	816	816	816	816	815
Përmbysja	Korrelation nach Pearson	,694**	,608**	,646**	1	,553**
	Signifikanz (2-seitig)	,000	,000	,000		,000
	N	816	816	816	816	815
Bulling	Korrelation nach Pearson	,706**	,558**	,511**	,553**	1
	Signifikanz (2-seitig)	,000	,000	,000	,000	
	N	815	815	815	815	815

\*\* . Korrelacioni është sinjifikant në shkallën  $p < 0,01$  .

### Agresiviteti i shfaqur

Në tabelë paraqiten lidhjet korrelative që ekzistojnë midis agresivitetit të shfaqur dhe formave të tjera të tij, duke na treguar lidhjet e mëposhme statistikore

Midis agresivitetit të shfaqur dhe formave të tjera të agresivitetit vërehet një lidhje

sinjifikante. Agresiviteti i fshehur kundrejt agresivitetit të shfaqur raportohet me një vlerë

$r(816) = .67$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$  dhe me përmbysjen (me dy nën shkallët e saj

agresivitetin marrëdhënor dhe pasiv) me vlerë  $r(816) = .69$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$  duke

raportuar lidhje sinjifikante lineare. Drejtimi i këtyre lidhjeve është pozitiv duke rezultuar se kanë tendencën të rriten së bashku me fuqi të fortë  $30 \leq |r| < 62$ . Agresiviteti i shfaqur lidhjen korrelacionale sinjifikative më të fortë e krijon me bulling përkatësisht me vlerë  $r(816) = .70$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$  dhe hakmarrjen përkatësisht me vlerë  $r(816) = .73$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$ . Drejtimi i të dyjave është linear pozitiv.

**Tabela 11.1.** Lidhja korrelacionale mes agresivitetit të shfaqur dhe nxitësve

	Në Shtëpi	Në Shkollë	Me Shokët/ Shoqet	Në Përgjithësi
Korrelacion Pearson	,373**	,252**	,319**	,205**
Ag. I Shfaqur Sinjifikant (2-seitig)	,000	,000	,000	,000
N	814	814	814	816

\*\* . Korrelacioni është sinjifikant në shkallën  $p < 0,01$  .

Nga lidhjet korrelacionale mes nxitësve dhe agresivitetit të shfaqur raportohet se ekzistojnë lidhje sinjifikative mes tyre. Agresiviteti i shfaqur dhe nxitësi , *në përgjithësi*, raportohet përkatësisht me një madhësi vlere të shprehur me  $r(816) = .20$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$ , ndërsa midis nxitësit, *në shkollë* dhe agresivitetit të shfaqur raportohet me një vlerë për  $r(816) = .25$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$ . Me të dy nxitësit krijohen lidhje të dobëta korrelacionale  $|r| \leq 30$ , me drejtim pozitiv.

Nxitësi, *me shokët*, përkundrejt agresivitetit të shfaqur raportohet me një vlerë  $r(816) = .31$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$ , ndërsa vlera më e lartë që identifikohet si dhe vlera më e rëndësishme rezulton në lidhjen mes nxitësit, *në shtëpi* dhe agresivitetit të shfaqur, rezulton me një vlerë për  $r(816) = .37$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$ . Të dyja këto lidhje janë lineare, me drejtim pozitiv, me magnitudë të moderuar  $30 \leq |r| < 62$ .

Vlera sinjifikative korrelacionale raportohen në studim dhe mes dy nënshkallëve të agresivitetit të shfaqur përkatësisht agresivitetit fizik dhe atij verbal mes formave të tjera.

**Tabela 11.2.** Lidhja korrelacionale mes agresivitetit fizik dhe verbal kundrejt formave të tjera të agresivitetit.

		Ag. I fshehur	Hakmarrja	Përmbysja	Bulling
Ag.fizik	Korrelacion Pearson	,669**	,756**	,672**	,649**
	Sinjifikant (2-seitig)	,000	,000	,000	,000
	N	816	816	816	815
Ag.Verbal	Korrelacion Pearson	,591**	,617**	,622**	,663**
	Sinjifikant (2-seitig)	,000	,000	,000	,000
	N	815	815	815	815

\*\* . Lidhja korrelacionale është sinjifikante në shkallën  $p < 0.01$

### **Agresiviteti fizik**

Të dhënat e paraqitura në tabelën e lidhjes korrelative që ekziston midis agresivitetit fizik dhe formave të tjera të tij, tregojnë lidhjet sinjifikative të mëposhme statistikore lineare të forta, me drejtim pozitiv  $|r| > 0.62$ .

Midis agresivitetit fizik dhe shkallëve të tjera të agresivitetit vërehen lidhje sinjifikative korrelacionale, ku me bulling shfaqet me një vlerë  $r(816) = .64$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$ , ndërkohë që agresiviteti i fshehur kundrejt agresivitetit fizik, paraqitet me vlerë  $r(816) = .66$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$ . Lidhja me përmbysjes dhe agresivitetit fizik shfaqet përkatësisht me vlerë  $r(816) = .67$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$ , ndërsa hakmarrja raportohet me vlerë  $r(816) = .75$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$ .



**Tabela 11.3.** Lidhja korrelacionale mes agresivitetit fizik dhe nxitësve

		Në shtëpi	Në shkollë	Me shokët/ shoqet	Në përgjithësi
Ag. Fizik	Pearson Korrelacion	,346**	,200**	,299**	,181**
	Sig. (2-tailed)	,000	,000	,000	,000
	N	814	814	814	816

\*\* . Lidhja korrelacionale është sinjifikante në shkallën  $p < 0.01$ .

Mes nxitësve dhe agresivitetit fizik raportohet se ekziston një lidhje korrelacionale sinjifikative, me drejtim pozitiv po me fuqi të dobët si me nxitësin , në përgjithësi, përkatësisht me vlerë të shprehur me  $r(816) = .18$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$  dhe me nxitësin, në shkollë që shfaqet me një vlerë për  $r(814) = .20$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$ , ku  $30 \leq |r|$ .

Nxitësi, me shokët, përkundrajt agresivitetit fizik raportohet një vlerë  $r(814) = .30$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$ , ndërsa me nxitësin, në shtëpi dhe agresivitetin fizik, rezulton me një vlerë për  $r(814) = .34$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$ . Të dyja këto lidhje korrelacionale sinjifikative janë me drejtim pozitiv dhe me fuqi të moderuar  $30 \leq |r| < 62$

### **Agresiviteti verbal**

Të dhënat e paraqitura në tabelën e lidhjes korrelative që ekzistojnë midis agresivitetit verbal dhe formave të tjera të agresivitetit, pjesë të këtij studimi shfaqen me vlerat e mëposhtme.

Agresivitetit verbal krijon me format e tjera të agresivitetit lidhje sinjifikative lineare me drejtim pozitiv, ku vetëm me agresivitetin e fshehur raportohet me magnitudë të moderuar  $r(815) = .59$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$  ku  $30 \leq |r| > 62$ , ndërsa lidhjet e tjera janë me magnitudë të fortë  $|r| > 62$ .

Midis agresivitetit verbal dhe formave të tjera të agresivitetit raportohen lidhjet korrelative sinjifikative të mëposhtme , me përmbysjes dhe hakmarrjen, agresiviteti verbal rezulton përkatësisht me një vlerë  $r = .62$  për  $p < 0.01$ , ndërsa me magnitudën më të fortë identifikohet mes bulling dhe agresivitetit verbal, e shprehur kjo përkatësisht në vlerën  $r = .66$  për  $p < 0.01$  për  $30 \leq |r| > 62$ .

**Tabela 11.4.** Lidhja korrelacionale mes agresivitetit verbal dhe nxitësve

		Në shtëpi	Në shkollë	Me shokët/ shoqet	Në përgjithësi
Verbal	Pearson Korrelacion	,349**	,265**	,294**	,198**
	Sig. (2-tailed)	,000	,000	,000	,000
	N	814	814	814	815

\*\* . Lidhja korrelacionale është sinjifikante në shkallën  $p < 0.01$ .

Nga lidhja korrelacionale mes nxitësve dhe agresivitetit verbal, nga të dhënat rezulton se, agresiviteti verbal krijon lidhje sinjifikative korrelacionale , ku me nxitësin, *në përgjithësi*, shfaqet me një vlerë të shprehur  $r(815) = .20$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$ , *Me shokët*, raportohet me një vlerë  $r(814) = .29$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$ , ndërsa me nxitësin, *në shkollë*, agresiviteti verbal shfaqet me një vlerë për  $r(815) = .27$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$ . Të treja këto lidhje korrelacionale raportohen me fuqi të dobët  $30 \leq |r|$ .

Lidhja sinifikative korrelacionale që krijohet me nxitësin, *në familje*, me drejtim pozitiv shprehhet me fuqi të moderuar në të dhënat e studimit përkatësisht me një vlerë  $r(814) = .35$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$  ku  $30 \leq |r| > 62$ .

## Agresiviteti i fshehur

Të dhënat e paraqitura në tabelën nr.11, e lidhjeve korrelative që ekziston midis formave të agresivitetit, kjo dhe mes agresivitetit të fshehur dhe formave të tjera të tij, që janë pjesë e këtij studimi, tregojnë lidhjet e mëposhtme statistikore.

Midis agresivitetit të fshehur dhe bulling krijohet lidhje sinjifikative korrelacionale, me drejtim pozitiv po me magnitudë të moderuar me një vlerë  $r(814) = .56, p = .00$  për  $p < 0.01$  dhe lidhja sinjifikative korrelacionale mes përmbysjes dhe agresivitetit të fshehur shfaqet me vlerë të moderuar  $r(814) = .61, p = .00$  për  $p < 0.01$  ku  $30 \leq |r| > 62$

Lidhja sinjifikative korrelacionale që hakmarrja krijon me agresivitetin e fshehur është me drejtim pozitiv dhe me fuqi  $r(814) = .65, p = .00$  për  $p < 0.01$  ku  $|r| > 62$ .

**Tabela 11.5.** Lidhja korrelacionale mes agresivitetit të fshehur dhe nxitësve

		Në shtëpi	Në shkollë	Me shokët/shoqet	Në përgjithësi
Ag. i	Pearson Korrelacion	,259**	,179**	,273**	,194**
Fshehur	Sig. (2-tailed)	,000	,000	,000	,000
	N	814	814	814	816

\*\* . Lidhja korrelacionale është sinjifikante në shkallën  $p < 0.01$ .

Nga lidhja korrelacionale mes nxitësve dhe agresivitetit të fshehur, nga të dhënat raportohet se adoleshentët nxiten, *në shkollë*, kundrejt tij me një vlerë të shprehur me  $r(814) = .18, p = .00$  për  $p < 0.01$ . Agresiviteti i fshehur në lidhje me nxitësin, *në përgjithësi*, shprehet me një vlerë  $r(814) = .19, p = .00$  për  $p < 0.01$ . Përsa i takon nxitësit, *në shtëpi*, kundrejt agresivitetit të fshehur ai paraqitet me një vlerë  $r(814) = .25, p = .00$  për  $p < 0.01$ . Agresiviteti i fshehur shfaqet me nxitësin, *me shokët*, raportohet përkatësisht

me një vlerë  $r(814) = .27, p = .00$  për  $p < 0.01$ . Agresiviteti i fshehur krijon lidhje sinjifikative korrelacionale me të gjithë nxitësit, me drejtim pozitiv po me fuqi të dobët për  $30 \leq |r|$ .

### Hakmarrja

Të dhënat e paraqitura në tabelën nr.11 të lidhjes korrelative që ekziston midis formave të agresivitetit dhe hakmarrjes, të dhënat tregojnë një lidhje statistikisht sinjifikative lineare mes hakmarrjes dhe formave të tjera të agresivitetit, përkatësisht me drejtim pozitiv.

Lidhja korrelacionale sinjifikative midis bulling dhe hakmarrjes përkatësisht me një vlerë  $r(814) = .51, p = .00$  për  $p < 0.01$  është me magnitudë të moderuar ku  $30 \leq |r|$ .

Përmbysja dhe agresiviteti i fshehur midis hakmarrjes raportohen me lidhje korrelacionale sinjifikative lineare me fuqi të fortë përkatësisht  $r(814) = .65, p = .00$  për  $p < 0.01$  ku  $|r| > 62$ .

**Tabela 11.6.** Lidhja korrelacionale mes hakmarrjes dhe nxitësve

	Në shtëpi	Në shkollë	Me shokët/ shoqet	Në përgjithësi
Hakmarrja Pearson Korrelacion	,239**	,189**	,236**	,158**
Sig. (2-tailed)	,000	,000	,000	,000
N	814	814	814	816

\*\* Lidhja korrelacionale është sinjifikante në shkallën  $p < 0.01$

Përsa i takon lidhjes korrelacionale mes nxitësve dhe hakmarrjes të dhënat tregojnë se: ndërmjet hakmarrjes dhe nxitësve krijohen lidhje sinjifikative lineare korrelacionale me drejtim pozitiv po me fuqi të dobët.

Me nxitësin në përgjithësi dhe hakmarrjes shprehet përkatësisht me një vlerë  $r(816) = .16$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$ .

Të dhënat tregojnë se hakmarrja në lidhje me nxitësin, në shkollë, paraqitet në një vlerë  $r(814) = .19$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$ , ndërsa me nxitësit, në familje dhe me shokët, rezultojnë me vlerë të barabartë kundrejt hakmarrjes për  $r(816) = .24$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$ , ku  $30 \leq |r|$ .

### Përmbysja

Të dhënat e paraqitura në tabelë e lidhjes korrelative që ekziston midis formave të agresivitetit dhe përmbysjes, përkatësisht me nënshkallët e saj, agresivitetin marrëdhënor dhe pasiv, tregojnë lidhjet e mëposhtme statistikore.

Me të gjitha format e tjera të agresivitetit krijon lidhje sinjifikative statistikore lineare korrelacionale me drejtim pozitiv me fuqi të fortë. Vetëm mes bulling dhe përmbysjes, kjo lidhje raportohet me një fuqi të moderuar me vlerë përkatësisht me  $r(815) = .55$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$  ku  $30 \leq |r| > 62$ .

**Tabela 11.7.** Lidhja korrelacionale mes përmbysjes dhe nxitësve

		Në shtëpi	Në shkollë	Me shokët/ shoqet	Në përgjithësi
Përmbysja	Pearson Korrelacion	,346**	,326**	,348**	,272**
	Sig. (2-tailed)	,000	,000	,000	,000
	N	814	814	814	816

\*\* Lidhja korrelacionale është sinjifikante në shkallën  $p < 0.01$ .

Përsa i takon lidhjes së nxitësve me përmbysjen, përkatësisht me nënshkallët e saj agresivitetin marrëdhënor dhe atë pasiv, ajo që raportohet nga të dhënat është fakti se midis saj dhe nxitësve krijohen lidhje sinjifikative statistikore lineare korrelacionale me drejtim pozitiv. Me nxitësin *në përgjithësi*, shfaqet me fuqinë më të dobët me një vlerë të shprehur  $r(816) = .27, p = .00$  për  $p < 0.01$  ku  $30 \leq |r|$ .

Të dhënat tregojnë se me nxitësit e tjerë raportohen lidhje me fuqi të moderuar përkatësisht, *në shkollë*, përmbysja nxitet në një vlerë për  $r(814) = .33, p = .00$  për  $p < 0.01$ , në *shtëpi* dhe *me shokët*, paraqitet me vlerë të njëjtë kundrejt përmbysjes më saktësisht për  $r(814) = .35, p = .00$  për  $p < 0.01$ , ku  $30 \leq |r| > 62$ .

### **Bulling**

Bulling krijon lidhje sinjifikative korrelacionale lineare me drejtim pozitiv me format e tjera të agresivitetit. Këto lidhje paraqitet me vlera të moderuara ku me hakmarrjen raportohet me një vlerë  $r(815) = .51, p = .00$  për  $p < 0.01$ , në lidhje me agresivitetin e fshehur dhe përmbysjen krijon të njëjtën vlerë  $r(815) = .55, p = .00$  për  $p < 0.01$  ku  $30 \leq |r| > 62$ .

Bulling e krijon lidhjen korrelacionale më të fortë me dy nga format e agresivitetit, forma të agresivitetit të shfaqur, përkatësisht agresiviteti fizik dhe ai verbal me vlerë  $r(815) = .64, p = .00$  për  $p < 0.01$  dhe  $r(814) = .66, p = .00$  për  $p < 0.01$  ku  $|r| > 62$ .

**Tabela 11.8.** Lidhja korrelacionale mes bulling dhe nxitësve

	Në shtëpi	Në shkollë	Me shokët/ shoqet	Në përgjithësi
Bulling Pearson Korrelacion	,289**	,214**	,225**	,182**
Sig. (2-tailed)	,000	,000	,000	,000
N	814	814	814	815

\*\* Lidhja Korrelacionale është sinjifikante në shkallën  $p < 0.01$ .

Përsa i takon lidhjeve sinjifikative korrelative së nxitësve me bulling janë lineare, me drejtim pozitiv po me magnitudë të dobët . Midis nxitësit, *në përgjithësi* dhe bulling ekziston një lidhje me një vlerë të shprehur me  $r(815) = .18$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$ .

Të dhënat tregojnë se, *në shkollë*, bulling nxitet në një vlerë për  $r(814) = .21$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$ . Nxitësi, *me shokët*, bazuar në të dhënat kundrejt bulling është me një vlerë për  $r(814) = .23$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$ , kundrejt bulling dhe nxitësit, *në shtëpi*, shfaqet me vlerë  $r(814) = .28$ ,  $p = .00$  për  $p < 0.01$  ku  $30 \leq |r|$ .

## 6.5 T-Test në lidhje me gjininë

Tabelat në vijueshmëri tregojnë dallimet gjinore, përkatësisht asaj mashkullore dhe asaj femërore (që në programin SPSS të hedhjes së të dhënave janë kodifikuar me vlerat përkatëse 0 dhe 1) dhe formave të ndryshme të agresivitetit.

Në tabelën 12-të paraqiten të dhënat mbi lidhjen që raportohen mes formave të agresivitetit dhe dy gjinive.

Referuar vlerave, gjinia mashkullore dhe ajo femërore krijojnë lidhje sinjifikante jo me të gjithë format e agresivitetit, por dallimi i tyre shfaqet tek agresiviteti fizik, i fshehur dhe hakmarrja.

**Tabela 12.** T-Test, format e agresivitetit për dy gjinitë

	Gjinia	Statistikë Grupi			
		N	Mean=Mesatare	Deviacioni standart	Gabimi standart
Ag. I Shfaqur	Femer	427	1,9637	,71411	,03456
	Mashkull	389	2,0623	,75160	,03811
Ag. I Fshehur	Femer	427	1,9246	,80025	,03873
	Mashkull	389	2,0778	,85857	,04353
Hakmarrja	Femer	427	1,8416	,72761	,03521
	Mashkull	389	2,1302	,79437	,04028
Përmbysja	Femer	427	2,1516	,62195	,03010
	Mashkull	389	2,1931	,68936	,03495
Bulling	Femer	427	1,9758	,96452	,04668
	Mashkull	388	2,0266	,89228	,04530

\*\* T- Test sinjifikante në vlerën 0.01



Sipas vlerave të raportuara agresiviteti i shfaqur nuk rezulton të ketë dallime sinjifikative gjinore, ku vlerat variojnë , tek djemtë  $Mv = 2,06$  dhe  $Ds = 0,75$ , ndërsa vajzat përkatësisht me vlerë  $Mv = 1,96$  dhe  $Ds = 0,71$ , për  $t(814) = -1.920$ ,  $p = .055$  . Diferenca sinjifikative nuk raportohen as tek përmbysja dhe as tek bulling.

*Përmbysja* me nënshkallët e veta agresivitetin marrëdhënor dhe atë pasiv tek vajzat merr vlerën  $Mv = 2,15$  dhe  $Ds = 0,62$  kundrejt djemve me vlerë  $Mv = 2,19$  dhe  $Ds = 0,68$  ku  $t(814) = - ,903$ , ku  $p = ,367$ .

Përsa i takon bulling rezulton se nuk raportime për dallime gjinore, tek djemtë raportohet një vlerë mesatare  $Mv = 2,02$  dhe  $Ds = 0,89$  kundrejt vajzave që shfaqin mesatarisht vlerën  $Mv = 1,97$  dhe  $Ds = 0,96$ , ku  $t(813) = - ,779$ , për  $p = ,436$ .

Diferencat gjinore konstatohet tek *agresiviteti i fshehur* , ku djemtë raportojnë mesatarisht vlerën  $Mv = 2,07$  dhe  $Ds = 0,85$  ndërsa tek vajzat reflektohet mesatarisht me vlerë  $Mv = 1,92$  dhe  $Ds = 0,80$  , ku  $t(814) = - 2,638$  me  $p = ,009$  për  $p < 0,01$ .

Tek hakmarrja djemtë shfaqin diferencë sinjifikative përsëri kundrejt vajzave, ata rezultojnë mesatarisht me vlerë  $Mv = 2,13$  dhe  $Ds = 0,79$ , ndërkohë vajzat shfaqen mesatarisht me vlerë  $Mv = 1,84$  dhe  $Ds = 0,72$  , ku  $t(814) = -5,416$  me  $p = ,001$  për  $p < 0,01$ .

Në tabelën e mëposhtme paraqiten dallimet gjinore kundrejt nënshkallëve të agresivitetit të shfaqur, përkatësisht atij fizik dhe verbal.

**Tabela 12.1.** T-Test i agresivitetit fizik dhe verbal për të dyja gjinitë

Statistikë Grupi					
	Gjinia	Nr.	Mean- Mesatare	Deviacioni Standart	Gabimi Standart
Ag.Fizik	Femer	427	1,8659	,69037	,03341
	Mashkull	389	2,0563	,76690	,03888
Ag.Verbal	Femer	427	2,0616	,85039	,04115
	Mashkull	388	2,0633	,83052	,04216

\*\* T- Test sinjifikante në vlerën 0.01

Referuar vlerave mesatare të raportuara më të larta për të dyja gjinitë janë tek agresiviteti verbal si nënshkallë e agresivitetit të shfaqur, por dallimet gjinore shfaqen tek agresiviteti fizik.

Agresiviteti verbal shfaqet me vlera mesatare të njëjta për të dyja gjinitë me vlerë

$M_v = 2,06$  dhe  $D_s = 0,83/0,85$ ,  $t(813) = - ,028$  me  $p = ,977$ .

Diferenca sinjifikative gjinore shfaqet tek një nga nënshkallët e agresivitetit të shfaqur, përkatësisht atij fizik, ku djemtë rezultojnë me një vlerë mesatare më të lartë nga vajzat, ku djemtë raportojnë  $M_v = 2,05$  dhe  $D_s = 0,76$ , ndërsa vajzat shfaqin mesatare me vlerë përkatësisht  $M_v = 1,86$  dhe  $D_s = 0,69$ , ku  $t(814) = - 3,733$ ,  $p = ,001$  për  $p < 0.01$ .

Si përmbledhje mund të themi se diferencat sinjifikative gjinore mes formave të ndryshme të agresivitetit raportohen te agresiviteti i fshehur, hakmarrja dhe te agresiviteti fizik si nënshkallë e agresivitetit të shfaqur.

## *Nxitësit*

Përsa i takon nxitësve rezulton se përveç nxitësit “*në shtëpi*” nuk ka dallime të rëndësishme statistikore midis dy gjinive.

**Tabela 12.2.** T-Test, gjinitë në lidhje me nxitësit

Nxitësit	Gjinia	Statistikë Grupi			
		Nr.	Mean- Mesatare	Deviacioni Standart	Gabimi Standart
Në shtëpi	Femer	426	2,25	1,036	,050
	Mashkull	388	2,12	1,100	,056
Në shkollë	Femer	426	2,78	1,083	,052
	Mashkull	388	2,76	1,025	,052
Me shokët /shoqet	Femer	427	2,52	1,064	,052
	Mashkull	387	2,48	1,078	,055
Në përgjithësi	Femer	427	2,97	1,177	,057
	Mashkull	389	2,96	1,136	,058

\*\* T- Test sinjifikante në vlerën 0.01

Vërehet se vajzat , *në shtëpi*, nxiten më tepër se djemtë ato rezultojnë përkatësisht me një vlerë mesatare  $M_v = 2,25$  dhe devijacion standart  $D_s = 1,03$ , kundrejt djemve që raportojnë përkatësisht me vlerë mesatare  $M_v = 2,12$  dhe  $D_s = 1,10$ . Duke rezultuar si dhe nxitësi me diferenën më të madhe midis djemve dhe vajzave.

Me të tre nxitësit e tjerë nuk raportohen diferenca sinjifikative. *Me shokët*, vajzat nxiten me vlerë mesatare përkatësisht  $M_v = 2,52$  dhe  $D_s = 1,06$  kundrejt djemve që raportojnë përkatësisht vlerë mesatare  $M_v = 2,48$  dhe devijacion standart  $D_s = 1,07$  ku  $t(812) = ,554$  dhe  $p = ,580$  për  $p < 0,01$ .

Përsa i takon nxitësit, *në shkollë*, vajzat shfaqen me pothuajse të njëjtat vlera mesatare ashtu si dhe meshkujt pa raportuar dallime statistikore të rëndësishme, kështu vajzat rezultojnë përkatësisht me vlerë  $M_v = 2,78$  dhe  $D_s = 1,08$ , ndërkohë që djemtë rezultojnë përkatësisht me vlerë  $M_v = 2,76$  dhe  $D_s = 1,02$ , ku  $t(812) = ,289$  dhe  $p = ,773$ .

Në lidhje me nxitësin, *në përgjithësi*, vajzat shfaqen me pothuajse të njëjtat vlera mesatare si dhe djemtë, përkatësisht  $M_v = 2,97$  dhe  $D_s = 1,17$ , ndërsa djemtë me vlerë  $M_v = 2,96$  dhe  $D_s = 1,13$  ku  $t(814) = ,129$  me  $p = ,897$ .

## 6.6 Lidhjet korrelative midis formave të agresivitetit dhe moshave

Në tabelat e mëposhtme do të paraqiten lidhjet korrelacionale që moshë krijon me format e ndryshme të agresivitetit si dhe nxitësit

**Tabela 13. Lidhjet korrelacionale midis formave të agresivitetit dhe moshës**

		Ag. i shfaqur	Ag. i fshehur	Hakmarrja	Përmbysja	Bulling
Moshë	Korrelacion sipas Pearson	,054	,000	,041	,092**	,037
	Signifikant (2-seitig)	,126	,996	,238	,008	,293
	N	816	816	816	816	815
Ag. i shfaqur	Korrelacion sipas Pearson	1	,673**	,732**	,694**	,706**
	Signifikant (2-seitig)		,000	,000	,000	,000
	N	816	816	816	816	815
Ag. i fshehur	Korrelacion sipas Pearson	,673**	1	,654**	,608**	,558**
	Signifikant (2-seitig)	,000		,000	,000	,000
	N	816	816	816	816	815
Hakmarrja	Korrelacion sipas Pearson	,732**	,654**	1	,646**	,511**
	Signifikant (2-seitig)	,000	,000		,000	,000
	N	816	816	816	816	815
Përmbysja (Ag. marrëdhënor) (Agresiviteti pasiv)	Korrelacion sipas Pearson	,694**	,608**	,646**	1	,553**
	Signifikant (2-seitig)	,000	,000	,000		,000
	N	816	816	816	816	815
Bulling	Korrelacion sipas Pearson	,706**	,558**	,511**	,553**	1
	Signifikant (2-seitig)	,000	,000	,000	,000	
	N	815	815	815	815	815

\*\* . Korrelacion konsiderohet sinifikant 0,01 (2-seitig)

Ajo që bie në sy është fakti se nuk kemi një lidhje sinifikante korrelacionale midis moshës dhe formave të ndryshme të agresivitetit ku me agresivitetin e shfaqur raportohet me vlerë  $r(816) = .05$ ,  $p = .12$ . Agresiviteti i fshehur në lidhje me moshën raportohet përkatësisht me vlerë  $r(816) = .00$ ,  $p = .99$ . Lidhja që moshë krijon me hakmarrjen është  $r(816) = .04$ ,  $p = .23$  dhe me përmbysjen dhe dy nënshkallët e saja agresivitetin marrëdhënor dhe atë

pasiv përkatësisht  $r(816) = .09$  për  $p = .00$  për  $p < 0.01$ . Ndërsa në lidhje me bulling moshë paraqitet me vlerat  $r(815) = .03$ ,  $p = .29$ .

**Tabela: 13.1 Lidhjet korrelacionale midis agresivitetit fizik, atij verbal dhe moshave**

		Agresiviteti fizik	Agresiviteti Verbal
Moshë	Korrelacion sipas Pearson	,066	,033
	Sinjifikant (2-seitig)	,058	,340
	N	816	815
Ag. fizik	Korrelacion sipas Pearson	1	,729**
	Signifikant (2-seitig)		,000
	N	816	815
Ag. Verbal	Korrelacion sipas Pearson	,729**	1
	Signifikant (2-seitig)	,000	
	N	815	815

*\*\*.* Korrelacioni konsiderohet sinjifikant 0,01 (2-seitig)

Duke analizuar agresivitetin fizik dhe atë verbal si nënshkallë të agresivitetit të shfaqur nuk raportohet përsëri lidhje sinjifikante midis tyre dhe moshës. Agresiviteti fizik shfaqet me përkatësisht me vlerë  $r(816) = .06$ ,  $p = .05$ , ndërsa ai fizik përkatësisht merr vlerat  $r(815) = .03$ , për  $p = .05$ .

**Tabela: 13.2. Lidhja korrelacionale midis moshës dhe nxitësve**

		Mosha	Në Shtëpi	Në Shkollë	Me shokët/ shoqet	Në përgjithësi
Mosha	Korrelacion Pearson	1	,041	,033	,030	,054
	Signifikant (2-seitig)		,247	,352	,396	,126
	N	816	814	814	814	816
Në shtëpi	Korrelacion Pearson	,041	1	,422**	,342**	,250**
	Signifikant (2-seitig)	,247		,000	,000	,000
	N	814	814	814	813	814
Në shkollë	Korrelacion Pearson	,033	,422**	1	,387**	,488**
	Signifikanz (2-seitig)	,352	,000		,000	,000
	N	814	814	814	813	814
Me shokët/shoqet	Korrelacion Pearson	,030	,342**	,387**	1	,318**
	Signifikanz (2-seitig)	,396	,000	,000		,000
	N	814	813	813	814	814
Me shokët/shoqet	Korrelacion Pearson	,054	,250**	,488**	,318**	1
	Signifikanz (2-seitig)	,126	,000	,000	,000	
	N	816	814	814	814	816

\*\* . Korrelacioni konsiderohet sinjifikant për  $p < 0.01$ .

Në lidhje me nxitësit përsëri mosha nuk krijon lidhje korrelacionale sinjifikante. Kështu në lidhje me nxitësin në shtëpi raportohen vlerat e mëposhtme  $r(814) = .04$ ,  $p = .24$ , ndërsa në lidhje me nxitësin në shkollë raportohet përkatësisht vlerat  $r(814) = .03$ ,  $p = .35$ , në lidhje me nxitësin me shokët/ shoqet përsëri mosha nuk shfaq lidhje sinjifikante, ku raportohet me vlerë përkatësisht  $r(816) = .03$ ,  $p = .39$  dhe me nxitësin në përgjithësi raportohen vlerat  $r(816) = .05$ ,  $p = .12$ .

## 6.7 T-Test në lidhje me Vendbanimin

Tabelat në vijueshmëri tregojnë dallimet midis zonave të banimit, përkatësisht midis zonave urbane dhe atyre rurale dhe formave të agresivitetit, kjo gjë që konstatohet dhe në lidhje dhe me nxitësit. Në tabelën e mëposhtme paraqiten vlerat mesatare si për zonën urbane dhe rurale në lidhje me format e agresivitetit dhe deviacioni standart.

**Tabela 14.** T- Test i formave të agresivitetit në lidhje me zonat urbane dhe rurale

	Statistikë Grupi				
	Z. Urbane Z. Rurale	N	Mesatare	Deviacion i Standart	Gabimi Standart
Agresiviteti i shfaqur	Zone Urbane	435	2,0476	,75190	,03605
	Zone Rurale	381	1,9685	,71038	,03639
Agresiviteti i fshehur	Zone Urbane	435	2,0259	,87625	,04201
	Zone Rurale	381	1,9654	,77735	,03982
Hakmarrja	Zone Urbane	435	2,0188	,77092	,03696
	Zone Rurale	381	1,9339	,77446	,03968
Përmbysja	Zone Urbane	435	2,2124	,65534	,03142
	Zone Rurale	381	2,1246	,65204	,03341
Bulling	Zone Urbane	434	2,0438	,95766	,04597
	Zone Rurale	381	1,9501	,89744	,04598

\*\* T- Test sinjifikante në vlerën 0.01

Adoleshentët e zonave urbane dhe atyre rurale nuk shfaqin diferenca të rëndësishme apo sinjifikative në lidhje me format e agresivitetit.



Tek agresiviteti i i shfaqur adoleshentët e zonave urbane dhe rurale rezultojnë me vlera të përafërta me ata të zonave rurale për vlerat e mesatare  $Mv = 1,96$  me  $Ds = 0,71$  përkundrjet adoleshentëve të zonave urbane që rezultojnë me vlerë mesatare  $Mv = 2,04$  me devijacion standart  $Ds = 0,75$  ku  $t(814) = 1,538$  me  $p = ,124$

Tek agresiviteti i fshehur adoleshentët e zonave urbane paraqesin një vlerë mesatare  $Mv = 2,02$  me devijacion standart  $Ds = 0,87$  kundrejt adoleshentëve të zonave rurale që shfaqen me një vlerë mesatare  $Mv = 1,96$  dhe me devijacion standart  $Ds = 0,77$ , ku  $t(814) = 1,037$  me  $p = ,300$  për  $p < 0.01$ .

Adoleshentët e zonave urbane nuk raportohen diferenca edhe përsa i takon hakmarrjes përkatësisht me një vlerë mesatare  $Mv = 2,01$  dhe me devijacion standart  $Ds = 0,77$  kundrejt atyre të zonës rurale që raportojnë përkatësisht një vlerë mesatare  $Mv = 1,93$  dhe me devijacion standart  $Ds = 0,77$  ku  $t(814) = 1,565$  me  $p = ,118$  për  $p < 0.01$ .

E njëjta gjë vërehet dhe tek përmbysja, ku nuk vërehen dallime statistikore sinjifikative mes adoleshentëve të zonave urbane kundrejt atyre urbane, ku adoleshentët e zonave urbane shfaqen me një vlerë mesatare  $Mv = 2,21$  me  $Ds = 0,65$  kundrejt atyre të zonës rurale një vlerë mesatare  $Mv = 2,12$  dhe me devijacion standart  $Ds = 0,65$  ku  $t(814) = 1,914$  me  $p = ,056$  për  $p < 0.01$  dhe në lidhje me bulling adoleshentët e zonës urbane shfaqin vlera mesatare  $Mv = 2,04$  me  $Ds = 0,95$  kundrejt atyre të zonës rurale që rezultojnë me një vlerë  $Mv = 1,95$  me  $Ds = 0,89$  ku  $t(813) = 1,434$  me  $p = ,152$ .

**Tabela 14.1.** T-Test i agresivitetit fizik dhe verbal në zonat urbane dhe rurale

Statistikë Grupi					
	Z. Urbane/ Z. Rurale	Nr.	Mesatare	Deviacioni Standart	Gabimi Standart
Ag. Fizik	Zone Urbane	435	1,9846	,74548	,03574
	Zone Rurale	381	1,9248	,71945	,03686
Ag. Verbal	Zone Urbane	434	2,1063	,85566	,04107
	Zone Rurale	381	2,0123	,82109	,04207

\*\* T- Test sinjifikante në vlerën 0.01

Rezultatet na tregojnë të njëjtat vlera dhe kundrejt dy nënshkallëve të agresivitetit të shfaqur atij fizik dhe atij verbal. Adoleshentët e zonave urbane nuk shfaqin diferenca sinjifikative me adoleshentët e zonave rurale përsa i takon agresivitetit fizik, përkatësisht me një vlerë mesatare  $M_v = 1,98$  me  $D_s = 0,74$  kundrejt atyre në zonat rurale shfaqet një vlerë mesatare  $M_v = 1,92$  dhe me devijacion  $D_s = 0,71$  për  $t(814) = 1,163$  ku  $p = ,245$

Adoleshentët e zonave urbane nuk shfaqin diferenca në krahasim me adoleshentët e zonave rurale as të agresivitetit verbal ku raportohen përkatësisht për vlerë mesatare  $M_v = 2,10$  me devijacion standart  $D_s = 0,87$  kundrejt atyre të zonave rurale raportohen me një vlerë mesatare  $M_v = 2,01$  me devijacion standart  $D_s = 0,82$  ku  $t(814) = 1,595$  me  $p = ,111$  për  $p < 0.01$ .

Si përmbledhje mund të themi që format e agresivitetit, përkatësisht ai i shfaqur si: agresiviteti fizik dhe verbal, hakmarrja, agresiviteti i fshehur, bulling, si dhe përmbysja me dy nënshkallët e saj, përkatësisht agresiviteti pasiv dhe marrëdhënor rezultojnë se adoleshentët e zonat urbane dhe rurale nuk shfaqin diferenca të rëndësishme statistikore.

## Nxitësit

**Tabela 14.2.** Vlerat e nxitësve në lidhje me adoleshentët që jetojnë në zonat urbane dhe rurale

Statistika Grupi					
	Z. U. / Z. R.	Nr.	Mesatare	Deviacioni Standart	Gabimi Standart
Në shtëpi	Zone Urbane	433	2,19	1,081	,052
	Zone Rurale	381	2,19	1,054	,054
Në shkollë	Zone Urbane	433	2,77	1,015	,049
	Zone Rurale	381	2,78	1,100	,056
Me shokët/shoqet	Zone Urbane	433	2,53	1,038	,050
	Zone Rurale	381	2,47	1,106	,057
Në përgjithësi	Zone Urbane	435	2,90	1,103	,053
	Zone Rurale	381	3,04	1,212	,062

\*\* T- Test sinjifikante në vlerën 0.01

Përsa i takon nxitësve nuk raportohen dallime statistikore mes adoleshentëve që jetojnë në zonat urbane dhe ato rurale.

Adoleshentët e zonave rurale dhe ato urbane kundrejt nxitësit në “në shtëpi” raportohen me vlera mesatare të njëjtë  $M_v = 2.19$  me  $D_s = 1,08/ 1,05$  ku  $t(812) = ,036$  me  $p = ,971$ , në lidhje me nxitësin në shkollë adoleshentët e zonave rurale kundrejt atyre urbane raportojnë vlera mesatare  $M_s = 2.78$  dhe  $D_s = 1,10$  në zonat urbane  $M_s = 2.77$  me  $D_s = 1,01$  ku  $t(812) = -,137$  me  $p = ,891$  për  $p < 0,01$ .

Në lidhje me nxitësit “me shokët / shoqet” studimi identifikon se adoleshentët e zonave urbane kundrejt atyre të zonave rurale shfaqin diferenca në vlerat mesatare  $M_v = 2.53$  dhe

me deviacion standart  $Ds = 1,03$ , kundrejt atyre të zonave rurale shfaqin vlera mesatare  $Mv = 2,47$  me  $Ds = 1,10$  ku  $t(812) = ,750$  me  $p = ,453$  për  $p < 0,01$  , duke raportuar se adoleshentët e zonave urbane nga ata të zonave rurale nuk kanë diferenca me vlerë statistikisht të rëndësishme . Diferenca statistikore këto që nuk shfaqet as në lidhje me nxitësin, *në përgjithësi*, ku adoleshentët e zonave rurale marrin vlera mesatare  $Mv = 2,90$  me  $Ds = 1,03$  kundrejt atyre të zonave urbane shfaqin vlera mesatare  $Mv = 3,04$  me  $Ds = 1,21$  ku  $t(814) = -1,677$  me  $p = ,094$  për  $p < 0,01$

## **KAPITULLI VII**

### **DISKUTIME**

Qëllimi i këtij studimi ishte analiza e formave të agresivitetit dhe e nxitësve të tyre te adoleshentët shqiptar nga mosha 15- 19 vjeç. Ky studim përfshin një kampion prej 816 nxënës që ndjekin shkollën e mesme në 12 qarqe të Shqipërisë. Nga të cilët 389 meshkuj, 47.6% dhe 427 vajza, 52.3%. 434 nxënës janë nga zonat urbane dhe 382 janë nxënës të zonave rurale. Testi i përdorur ishte ARES, (2011). Nxënësit u testuan duke filluar nga nëntori 2014 deri në shkurt të 2015.

Pyetjet kërkimore dhe hipotezat e ngritura të këtij studimi:

#### **P.1 - Cilat janë format e shfaqjes së agresivitetit dhe nxitësit përkatës dhe a ekziston një lidhje domethënëse mes tyre?**

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetje i referohemi teorisë dhe literaturës së trajtuar gjerësisht në kapitullin II, duke i përmbledhur format e agresivitetit në agresivitet të shfaqur, të fshehur, marrëdhënor apo pasiv si nënshkallë të përmbysjes si dhe bulling dhe hakmarrjes. Nxitësit luajnë rol të rëndësishëm në analizën e këtyre lloj formash të shfaqjes së agresivitetit. Më së miri për plotësimin e përgjigjes së kësaj pyetje na vjen në ndihmë pikërisht pyetsori i përzgjedhur dhe përdorur për testimin e adoleshentëve shqiptar nga 15- 19 vjeç ARES, 2011(Raymond DiGiuseppe & Raymond Chip Tafrate).

Si aspekte psikologjike të shprehjes së zemërimit, nënshkallët e agresivitetit të shfaqur lidhen me agresivitetin fizik drejtuar objekteve dhe personave, ky agresivitet mund të drejtohet dhe kundrejt objekteve si: dyerve dhe mureve. Adoloshentët mund të shtynjë, shajnë ose godasin të tjerët. Ata mund ta shprehin edhe duke dëmtuar pronën apo gjithçka

çfarë i përket personave me të cilët kanë zemërim ose gjejnë mënyra për të dëmtuar këta persona. Adoleshentët mund të shprehin zemërimin e tyre dhe verbalisht, ku nuk mungojnë dhe komentet deri në sarkazëm, pasi ata mendojnë se duke përdorur tone të larta apo agresivitet verbal mund të imponojnë, atë që, ata mendojnë se është e drejtë.

Nuk ngurojnë të jenë hakmarrës, prandaj marrin hak, madje shpenzojnë kohë dhe energji për të gjetur mënyra hakmarrjeje, shpesh ata thonë gjëra të paqëna apo të këqija, ose trillojnë histori kundrejt personave me të cilët kanë zemërim ose inat , ata nuk ngurojnë të manipulojnë fakte dhe devijojnë të vërtetat.

Përsa i takon formave të agresivitetit në studimin tonë janë identifikuar lidhje sinjifikative korrelative lineare , me drejtim pozitiv me fuqi që variojnë nga *ajo e moderuara*, përkatësisht bulling kundrejt agresivitetit të fshehur, hakmarrjes dhe përmbysjes, duke justifikuar më së miri dhe rezultatet e statistikës deskriptive, duke treguar se adoleshentët ndoshta tashmë të ndërgjegjshëm për pasojat ligjore apo ndëshkimet nuk preferojnë të zgjedhin agresivitetin e shfaqur, e deri në lidhje sinjifikative korrelative të fortë kundrejt të gjithë formave të tjera, duke treguar se këto variabla kanë tendencën që të rriten së bashku.

Adoleshentët detyrojnë ose gjejnë mënyra të ndryshme duke i detyruar të tjerët të bëjnë atë që ata duan, duke arritur të marrin atë që kanë dëshiruar. Disa nga format e këtij agresiviteti janë: agresiviteti i dukshëm apo i shfaqur me dy nënshkallët e tij, agresivitetin fizik,verbal, agresiviteti i fshehur (ku ata dëshirojnë të dëmtojnë të tjerët, me të cilët ata kanë inat), hakmarrja (ata përpiqen në çdo kohë të gjejnë rrugë dhe harxhojnë energji për të dëmtuar të tjerët), përmbysja (ku hyjnë agresiviteti marrdhënor, të folurit keq ose

fabrikojnë histori të qëllimshme për ti bërë keq personave me të cilët kanë inat), si dhe bulling (dëshira për kontroll, intimidim për dominim).

Një nga pjesët e rëndësishme të studimit përbëjnë nxitësit, të cilët ndikojnë drejtpërsëdrejti në marrëdhëniet ndërpersonale të individit adoleshent dhe në sjelljen e tyre agresive.

Adoleshenti në një seksion të veçantë në pyetsorin vetëraportues kanë përzgjedhur sa gjëra nxisin zemërimin e tij përkatësisht: *në shtëpi, në shkollë, me shokët/shoqet/miqte dhe në përgjithësi.*

Gjetjet e studimit tonë raporton se nxitësit *në shtëpi* dhe *me shokët/shoqet* krijojnë një lidhje sinjifikative korrelative, me drejtim pozitiv dhe fuqi të moderuar me pothuajse të gjithë format e agresivitetit.

Literatura referon se si sjelljet agresive ashtu dhe agresiviteti në adoleshencë shpesh janë produkt i një game bashkëveprimi, si fëmijë – rritje, fëmijë - probleme të sjelljes, kjo sipas Dishion & McMahon, 1998; Patterson, Dishion, & Bank, 1984. Të dhënat e studimit tonë janë të ngjashme me studime në kulturat e tjera, si p.sh. adoleshentët amerikan, të cilët kanë hedhur poshtë autoritetin e të rriturve, prandaj vihet re rebelimi dhe refuzimi i tyre kundrejt standardeve të të rriturve.

Rezultatet tona përse i takon formave të agresivitetit të shfaqur dhe nxitësve kryesisht *në shtëpi* janë në linjë me studime të tjera që vijnë nga literatura, kështu sipas Judith, (2015). Sipas saj, fakti i niveleve të lartë të refuzimit propozon që sasi të moderuara të rezistencës dhe refuzimit ndaj autoritetit prindëror mund të jetë normativ, ajo propozon se rezistenca

dhe refuzimi mund të jenë forma të përshtatshme zhvillimi, madje në kushte të caktuara, ato mund të konsiderohen funksionale për zhvillimin e adoleshentëve.

Përsa i takon një nxitësi tjetër, që gjithashtu raportohet në studimin tonë me një lidhje sinjifikative korrelative lineare me drejtim pozitiv, si nxitësi, me *shokët/shoqet* referuar literaturës këto rezultate janë në të njëjtën linjë me studime të tjera dhe teori që na ofron literatura, pasi kultura e adoleshentëve ka disa aspekte të veçanta, të cilat kanë ndikim të fuqishëm në socializimin e tyre brenda grupit, shokë apo shoqe, kjo sipas Erickson, Crosnoe & Dornbusch (2000).

### **H.1 – Ekziston nje lidhje statistikore e rëndësishme mes formave të agresivitetit dhe nxitësve të tyre tek adoleshentët.**

Referuar rezultateve të studimit janë identifikuar lidhje të sinjifikative statistikore mes formave të agresivitetit dhe mes nxitësve të tyre.

Zemërimi qoftë i internalizuar apo ai i ekstrenalizuar, por shumë intensiv ulin tek adoleshenti aftësinë për të kontrolluar sjelljen e tij, duke bërë që zemërimi të përshtatet në forma të ndryshme të agresivitetit, aspektet psikologjike të shprehjes së këtij të fundit janë dhe fokus i studimit tonë, të cilat janë: agresiviteti i shfaqur me dy format e veta agresivitetin fizik dhe verbal, agresiviteti i fshehur, hakmarrja, përmbysja apo bulling.

Sipas statistikës deskriptive nxënësit kanë përzgjedhur më tepër nivele të ulta të shprehjes së formave të agresivitetit të shfaqur. Rezulton se agresiviteti i shfaqur, me dy nënshkallët e tij përkatësisht, agresivitetin fizik dhe verbal rezulton të jetë me frekuencë më të ulët



krahasuar me format e tjera, ndërsa vlerat më të larta në disa nga format e tjera.

Frekuencat më të larta identifikohen të jenë përzgjedhur nga adoleshentët më tepër tek agresiviteti i fshehur dhe bullying, gjë që na tregon se ata nuk preferojnë ta shfaqin hapur agresivitetin e tyre, por përdorin forma të sofistikuara për të arritur synimet e tyre.

Format e ndryshme të shfaqjes së agresivitetit lidhen me tensionin fiziologjik, i cili në vetvete konsiderohet si një shenjë paralajmëruese.

Të dhëna interesante këto që janë në linjë me një studim i kryer nga Novaco, Taylor, Gillmer & Thorne, (2002), ku adoleshentët përdorin më së shumti agresivitetin e fshehur, për të arritur qëllimet e tyre.

Ajo që raportohet në studimin tonë mes formave të agresivitetit me njëra tjetrën referuar shkallëve të ARES krijojnë lidhje të forta dhe shumë të forta korrelacionale me njëra tjetrën.

Agresiviteti i shfaqur në studimin tonë rezulton se lidhjen korrelative sinjifikative më të fortë statistikore lineare, me drejtim pozitiv e krijojnë të jenë përkatësisht me hakmarrjen dhe bullying, ndërsa me agresivitetin e fshehur dhe përmbysjen krijojnë lidhje me fuqi të moderuar me vlera kufi pranë lidhjes së fortë.

Agresiviteti fizik e krijojnë lidhjen korrelative lineare me fuqi të fortë me hakmarrjen, ndërsa ai verbal lidhjen më të rëndësishme me fuqi të moderuar me vlera kufi drejt asaj të fortës e krijojnë me bullying.

Agresiviteti i fshehur, hakmarrja, përmbysja dhe bullying e krijojnë lidhjen sinjifikative korrelative lineare më të fortë me drejtim pozitiv me agresivitetin e shfaqur. Shfaqja e

bulling është e lidhur me një numër të problemeve të sjelljes, jo vetëm atyre emocionale por dhe problemeve fizike.

Referuar literaturës nxënësit që shfaqin bulling kanë performancë të dobët në shkollë, si dhe rrezikohen të përjashtohen nga shkollat, pasi është tipike që mbajnë armë me vete edhe në shkollë për të sulmuar të tjerët.

Studimet raportojnë se ekziston një lidhje e fortë mes bulling dhe agresivitetit fizik, gjë që në studimin tonë paraqitet me fuqi të moderuar drejt vlerave të forta, ku bulling lidhjen më të fortë e krijon me agresivitetin e shfaqur dhe të moderuar me tendencë kufi me lidhje të fortë me atë fizik dhe verbal (nënshkallë e agresionit të shfaqur). Gjetjet tona përsa i takon bulling janë në linjë dhe studimet e kryera nga Berthold & Hoover, 2000; Nansel, 2003.

Rezultatet tona treguan se nga të gjitha format e agresivitetit, lidhja më e fortë krijohet mes formave të agresivitetit të shfaqur, hakmarrjes, agresivitetit fizik dhe hakmarrjes, duke arritur vlerën më të lartë, krahasuar me të gjitha format e tjera të agresivitetit.

Këto rezultate janë në linjë me të njëjtat të dhëna që raportohet po nga një studim, ku rezulton se rreth 1.9 milion krime janë kryer në shkollat në mbarë vendin, duke konstatuar se rreth 40 nxënës për 1000 nxënës kanë qenë viktimë të disa formave të agresivitetit të shfaqur nga bashkëmoshatarët e tyre, si agresiviteti verbal, bulling dhe sidomos atij fizik, Universiteti i Minesotës dhe Qendrës Kombëtare për Statistikat e Arsimit, (2010) dhe Navis, (2012).

Agresiviteti i fshehur, hakmarrja dhe përmbysja me dy nënshkallët e veta lidhjen më të rëndësishme e krijojnë me agresivitetin e shfaqur dhe dy nënshkallët e tij përkatësisht agresivitetin fizik dhe atë verbal.

Hulumtimet tregojnë se ka dallime të rëndësishme statistikore të cilat tregojnë se ekzistojnë që lidhje mes emocioneve dhe formave të ndryshme të agresivitetit. Refruar kjo studimeve si të Frick, (2001) dhe Dodge & Pettit, (2003). Fëmijët dhe adoleshentët të cilët manifestojnë apo shfaqin forma të agresivitetit aktiv dhe të atyre që shfaqin forma të agresivitetit instrumental rezultojnë të kenë karakteristika shumë të ndryshme emocionale dhe konjitive.

Karakteristikat emocionale dhe konjitive janë të lidhura me modele të ndryshme të shfaqjes së agresivitetit, rezultate që raportohen nga një studim i kryer me 85 djem adoleshentë (mosha 13-18) në dhomat e paraburgimit për të mitur.

Sipas këtij studimi ka rezultuar se adoleshentët shfaqën nivele të larta në të dy nga format e agresiviteti, si atë aktiv dhe instrumental. Adoleshentët reagojnë përmes përgjigjeve të ndryshme të sjelljes prej provokimeve në dallim nga të rinjtë me nivele të larta vetëm të agresivitetit aktiv Muñoz, Frick, Kimonis & Aucoin, (2008) dhe Muñoz, (2012).

Në lidhje me nxitësit, referuar rezultateve të studimit, identifikohen lidhje korrelative sinjifikative statistikore lineare, me drejtim pozitiv mes formave të agresivitetit dhe nxitësve të tyre.

Duke u ndalur dhe në hipotezën tonë për të analizuar format e agresivitetit me nxitësit ajo që bie në sy është fakti se agresiviteti i shfaqur krijon lidhje sinjifikative korrelative me

drejtim pozitiv por me fuqi të dobët me nxitësin në shkollë dhe në përgjithësi dhe të moderuar me nxitësit në shtëpi dhe me shokët /shoqet. Agresiviteti fizik, ai verbal dhe bulling krijojnë gjithashtu lidhje sinjifikative statistikore lineare, me drejtim pozitiv dhe fuqi të moderuar me nxitësin, në shtëpi, ndërsa hakmarrja dhe përmbysja me shokët/shoqet krijon lidhje sinjifikative statistikore me fuqi të moderuar, duke vërtetuar hipotezën e parë, sipas të cilës midis formave të agresivitetit dhe nxitësve ekzistojnë lidhje të rëndësishme statistikore.

Agresiviteti në adoleshencë referuar literaturës janë produkt i një game bashkëveprimi, si fëmijë – rritje, fëmijë - probleme të sjelljes. Nëse do ti referohemi faktit që raportohet nga studim ynë se disa forma të agresivitetit lidhen ngushtësisht me një nga nxitësit si, në shtëpi, një shpjegim që vjen nga literatura është se prindërit dështojnë në monitorimin e fëmijëve të tyre, fëmija sillet keq, prindërit reagojnë ashpër dhe ushtrojnë disiplinë (Dishion & McMahon, 1998; Patterson, Dishion, & Bank, 1984).

Ky është momenti ku adoleshenti dhe prindërit fillojnë të kenë ndërveprime shtrënguese brenda familjes, të cilat nuk bëjnë gjë tjetër vetëm "mësojnë" adoleshentin që të sillet agresivisht. Adoleshenti refuzon të sillet si prindërit duan. Prindërit i përgjigjen për sjellje të keqe adoleshentit , kryesisht me agresivitet, pasi nuk pranojnë refuzimin e fëmijëve të tyre, duke bërë një përpjekje në këtë mënyrë për të detyruar fëmijën për të bërë atë që ata dëshirojnë.

Adoleshenti i zemëruar vazhdon përsëri. Prindërit tërhiqen, kjo përforcon agresivitetin e adoleshentit. Ky cikël në rënie vazhdon dhe adoleshenti tashmë ka mësuar se përmes

agresivitetit prodhon rezultate të dëshirueshme, duke justifikuar faktin pse nxitësi “në shtëpi” rezulton në nivele të konsiderueshme (Bushman & Huesmann, 2009).

Fëmijët janë vëzhgues shumë të kujdesshëm, ata vëzhgojnë dhe përpiqen ti imitojnë sidomos ata që kanë afër, ata që qendrojnë rreth tyre dhe agresiviteti ndikohet fuqimisht nga sjelljet agresive apo agresiviteti që mund të shfaqin prindërit e tyre, kjo sipas studimeve të ngjashme kryer nga Capaldi, Pears, Patterson, & Owen, 2003; Connell & Goodman, 2002; Huesmann, 1984).

Ndikimi i agresivitetit dhe sjelljeve agresive brenda famijes mund të jetë i gjatë dhe kryesisht i qëndrueshëm. Kur fëmijët rriten, tashmë adoleshentë sjelljet e tyre dhe besimi se ata janë të rritur dhe mund të sillen si të tillë, lidhet drejtpërsëdrejti me shkallën e dhunës prindërore në shtëpi, kur ata kanë qenë dëshmitarë kur ishin fëmijë (Hill & Nathan, 2008).

Studime afatgjata kanë identifikuar se ekziston një numër i lartë i adoleshentëve që shfaqin agresivitet, sjelljet e të cilëve kanë qenë të lidhur ngushtësisht me zhvillimin jetësor brenda familjes, ku është raportuar agresivitet i gjatë, disiplinë e rreptë, dështimi i monitorimit, refuzimi dhe indiferencë si dhe përdorimi i ashpër i dhunës fizike, studime këto të kryera nga Eron, Huesmann, & Zelli, (1991); Patterson, DeBaryshe & Ramsey, (1989); McCord, (1983); Olweus, (1980, 1995).

Nga analiza e rezultateve të studimit në lidhje mes nxitësve dhe formave të agresivitetit vërehet se vlera me fuqin më të fortë, me vlerën më të lartë arrihet te agresiviteti i shfaqur.

Përmbysja me dy nënshkallët e veta agresivitetin marrëdhënor dhe pasiv dhe agresiviteti i fshehur lidhjen më të rëndësishme e krijojnë me nxitësin *me shokët/shoqet dhe* referuar

literaturës kulturore e adoleshentëve ka disa aspekte të veçanta, të cilat kanë ndikim të fuqishëm në socializimin e tyre brenda grupit. Duke përdorur shpjegimet e asosacionit diferencial Erickson, Crosnoe & Dornbusch (2000), kanë gjetur se marrëdhëniet me shokët dhe brenda grupit shoqëror të tyre, ose marrëdhëniet e tyre brenda shkollës janë çelësi për të shpjeguar një pjesë të konsiderueshme të sjelljeve problematike të adoleshentëve. Lidhje të ngjashme janë gjetur edhe nga studiues të tjerë, ku provuan se ekspozimi ndaj bashkëmoshatarëve, që shfaqin devijime rezulton i lidhur ngushtë me zhvillimin e sjelljeve problematike, ndërsa shoqërimi me bashkëmoshatarët tradicional ose që nuk shfaqin sjellje devijante tregojnë mos agravim të agresivitetit si dhe sjelljeve agresive (Allen, Porter, Marsh, & McElhaney, McFarland, 2005; Monahan, Steinberg, & Kauffman, 2009).

## **P.2- A ekzistojnë dallime gjinore mes formave të agresivitetit dhe nxitësve të tij?**

Referuar rezultateve të studimit vërehet se janë identifikuar dallime të rëndësishme midis dy gjinive, përkatësisht djem/ vajza tek agresiviteti fizik si nënshkallë e agresivitetit të shfaqur, agresiviteti i fshehur dhe hakmarrjes.

Në raportimin e agresivitetit të shfaqur djemtë dhe vajzat rezultojnë në nivele të konsiderueshme, por jo me dallime kundrejt njëri tjetrit dhe tek format e tjera të agresivitetit si përmbysja apo bulling identifikohen vlera të larta si nga ana e djemve dhe vajzave në disa forma të agresivitetit, por djemtë dhe vajzat nuk raportojnë diferenca statistikore.

Referuar literaturës mbi agresivitetin e adoleshentëve thuhet se djemtë priren të jenë më të dhunshme se vajzat. Ky dallim, referuar literaturës mund të vijë për faktin se dikur studimet

fokusohehin tek agresiviteti fizik e nga kjo pikëpamje agresiviteti fizik raportohej më i lartë te djemtë se tek vajzat dhe ky fakt vërehet në një sërë studimesh, si Baron dhe Richardson, 1994; Bjorkqvist dhe Niemela, 1992; Bjorkqvist, 1994; Burbank, 1994; Campbell, 1995; Kinnear, 1995; Lang, 1991; Rotenberg, 1984). Një tjetër arsye e mundshme që vjen nga literatura është se shumica e hulumtimeve të 90' viteve janë kryer nga burrat, koncepti i të cilëve përqëndrohej kryesisht në dhunë fizike (Bjorkqvist, 1994).

Rezultate të tjera të ngjashme na jep dhe studimi i 2005 në SHBA, ku raportohej se 14% e nxënësve në klasat 9 deri në 12, kanë raportuar se janë përfshirë në dhunë fizike brenda mjedisit të shkollës në 12 muajt e fundit. Edhe pse nxënësit meshkuj pritej të kishin më shumë gjasa për të qenë të përfshirë në agresivitet fizik, u raportua se 8.8% e femrave kishin qenë të paktën një herë pjesë e agresivitetit fizik brenda mjedisit të shkollës. Po sipas këtij studimi rreth 5% e mësuesve në shkollat e zonave urbane dhe 3% në shkollat e zonave rurale ishin sulmuar fizikisht nga nxënësit, Qendra Kombëtare për Statistikat e Arsimit në SHBA (NCES, 2007) dhe Larson, (2010).

Studime të tjera gjithashtu kanë zbuluar se meshkujt shfaqin nivele të larta të agresivitetit në krahasim me vajzat madje dhe tendencat e tyre të agresivitetit janë më të larta sesa femrat. Dhe nga ky studim raportohej se ka dallime të konsiderueshme midis djemve dhe vajzave përsa i takon agresivitetit armiqësor. Rezultate të ngjashme vijnë dhe nga dy studime të tjetër, që tregojnë dallimet midis dy gjinisë dhe formave të ndryshme të agresivitetit, të cilat rezultojnë të shfaqen në nivele më të larta te meshkujt në krahasim me agresivitetin e vajzave Ryan & Mohr (2005), si dhe Maxwell (2009).

Një dallim i madh mes agresivitetit armiqësor dhe agresivitetit instrumental tek të dyja gjinitë ekziston dhe kundrejt djemve në krahasim me vajzat atlete. Rezultatet e studimit tregojnë se agresiviteti i djemve atletë në krahasim me agresivitetin e vajzave është më i lartë. Sipas një studimi të kryer në Mazandaran ku janë testuar 1876 nxënës atletë (Kharkan, Andam & Mehdizadeh, 2013).

Përfundimet tona janë pjesërisht në linjë me studimin e kryer nga Onukwufor, N. J., 2012 në Nigeri, ky studim fokusohet sesi ndryshojnë format e agresivitetit në bazë gjinore.

Matja e agresiviteti fizik dhe ai verbal kryer me 360 nxënës adoleshent të shkollave të mesme, ku instrumenti i përdorur është Buss-Perry, ku rezultoi se 20.8% e nxënësve të shkollave të mesme shfaqnin nivele të larta të agresivitetit fizik, ndërsa prevalenca e agresivitetit verbal te nxënësit ishte 48.3%. Agresiviteti fizik dhe agresiviteti verbal rezultojnë po sipas këtij studimi me vlera më të larta tek meshkujt se femrat. Ndërkohë që ajo pjesë ku kemi dhe një përputhje me gjetjet tona është përsa i takon shfaqjes së formave të agresivitetit fizik, sipas moshave, ku ato shfaqen me nivel më të lartë vlerash tek nxënësit 15 vjeçarë (28.3%) se tek ata 18 vjeçarë (13.3%), ndërsa prevalenca e agresivitetit verbal ishte më e lartë në mesin e nxënësve adoleshentë 18 vjeçarë (56.7%), se në mesin e nxënësve adoleshenë 15 vjeçarë (40%). Në total rezultati tregon se 48.3% (174) e nxënësve të shkollave të mesme të adoleshentëve, shfaqin agresivitet verbal. Kategorizimi tregoi se 51.7% (87) e nxënësve meshkuj raportojnë të jetë verbalisht agresiv në krahasim me 45% (81) femra. Meshkujt kanë rezultuar të shfaqin agresivitet më tepër se femrat në të gjithë llojet e ndryshme të kulturave, ata theksojnë se studimet shkencore kanë raportuar të dhëna të tilla për kategori të ndryshme të agresivitetit, sipas një studimi të Conner dhe Barkley (2004).



Adoleshentët në studimin tonë shfaqin nivele të larta të agresivitetit verbal, por pa dallime gjinore. Këto rezultate janë gjithashtu në përputhje me studimin e Sameer & Jamia (2007), ku raportohet se nxënësit e shkollave të mesme shfaqin një masë të madhe të agresivitetit verbal. Në këtë studim raportohet se nuk ekzistojnë dallime mes nxënësve meshkuj dhe femra në lidhje me format e agresivitetit, rezultat që është në të njëjtën linjë me rezultatet e studimit tonë në lidhje me agresivitetin e shfaqur, përmbysjen dhe bulling.

Djemtë përta i takon agresivitetit verbal dhe përmbysjes në krahasim me vajzat, nuk shfaqin diferenca, si vajzat dhe djemtë raportojnë të njëjtat nivele në vlera të papërfillshme, referuar numrit të tretë pas presjes, i cili është praktikisht jo domethënëse. Por këto rezultate nuk janë në linjë me një studim të kryer në Spanjë, nga Ramirez (1993), sipas të cilit djemtë shfaqin agresivitet verbal më shumë se vajzat. Ndërsa, nga studimet e Atkin, Smith, Robertson, Fredin dhe Wagner (2002) i cili gjeti se agresiviteti verbal është shumë i përhapur tek adoleshentët pa patur dallime gjinore që është gjithashtu në linjë me rezultatet tona.

Rezultatet e studimit tonë nuk janë përsëri tërësisht në të njëjtën linjë me rezultate që vijnë dhe nga vende të tjera, kështu sipas një studimi në Izrael, në fokus të të cilit qëndron analiza e dallimeve gjinore në format e agresivitetit fizik, verbal, indirekt dhe kundrejt pronës dhe ku janë përfshirë 921 adoleshentë, që ndjekin shkollën nga mosha 15-18 vjeç. Ky studim raporton se ka dallime të mëdha gjinore mes agresivitetit fizik, verbal dhe agresivitetit lidhur me pronën, ku meshkujt shfaqin më tepër agresivitet sesa femrat. Ndërkohë që po sipas këtij studimi dallimet gjinore përta i takon agresivitetit indirekt ishte shumë më i ulët (Selah-Shayovits, 2004). Në më shumë se 120 vende të botës, raportohet

se djemtë dhe burrat haptazi shfaqin agresivitet fizik dhe verbal më tepër se vajzat dhe gratë sipas Shaffer (2005).

Në studimin e tyre, Imhonde, Aluede dhe Obiote (2009) kanë gjetur se adoleshentët, femra dhe meshkuj, të cilët janë dëshmitarë të dhunës në familje, shfaqin shkallë të lartë të formave të agresivitetit në krahasim me ata që nuk janë dëshmitar të dhunës në familje.

Këto rezultate janë në kundërshtim me studimin e Fares, Ramirez, Cabrera, Lozamo & Salas (2011) që kanë gjetur se nuk ka dallim mes të dyja gjinive dhe në agresivitetin verbal që në fakt janë gjithashtu në të njëjtën linjë dhe me gjetjet tona.

Dallime të rëndësishme statistikore në studimin tonë raportohet përsa i takon hakmarrjes, ku djemtë shfaqin diferenca statistikore të rëndësishme krahasuar me vajzat.

Referuar qasjes social- kulturore një arsye për raportimin e niveleve më të lartë të agresivitetit fizik të djemve se të vajzat mund të lidhet me faktin se vajzat fitojnë forma të ndryshme sjellje nëpërmjet të mësuarit social. Vajzat p.sh. mund të mendojnë se agresiviteti indirekt apo i brendshëm ka të bëjë me modelet e sjelljes normale shoqërore, për shkak se nuk ka sanksione sociale. Një shpjegim tjetër i mundshëm mund të jetë se vajzat kanë frikë nga agresiviteti i shfaqur apo i drejtpërdrejtë. Agresiviteti i drejtpërdrejtë do të të vinte në rrezik statusin e tyre social, duke i dëmtuar ato. Përveç kësaj, agresiviteti i drejtpërdrejtë mund të çojë në kontrole më të rrepta kundrejt tyre, si nga ana e mësuesve dhe prindërve, ku sipas qasjes socio-kulturor presupozohet se dallimet gjinore në lidhje me format e ndryshme të agresivitetit varen nga efektet e mjedisit nëpërmjet edukimit gjinor dhe procesit të shoqërizimit .

Proceset e socializimit për vajzat janë më të rrepta, dhe për këtë arsye dukshëm ato janë më të kufizuara në shprehjen e drejtpërdrejtë të agresivitetit. Si pasojë, vajzat kanë tendencë për të shprehur agresivitet indirekt në nivel më të lartë se djemtë (Lagerspetz dhe Bjorkqvist, 1994).

Agresiviteti i drejtpërdrejtë trajtohet në literaturë dhe si një atribut i pjekurisë sociale. E megjë vajzat e arrijnë pjekurinë më herët se djemtë dhe e kanë më të qartë statusin e individit brenda shoqërisë janë dhe më të përmbajtura nga shfaqja e agresivitetit. Vajzat preferojnë miqësinë afatgjatë, ndarjen e informacionit mbi marrëdhëniet shoqërore dhe e konsiderojnë shumë të rëndësishme marrëdhënien mes miqsh. Kjo tregon qartazi se vajzat kanë më shumë mundësi që të shfaqin forma të agresivitetit indirekt, krahasuar me djemtë, që shfaqin forma të agresivitetit të shfaqur (Bjorkqvist et al., 1992).

Në studimin tonë nuk jemi në të njëjtën linjë pasi tek agresiviteti i fshehur, djemtë krahasuar me vajzat raportojnë diferenca sinjifikative statistikore.

Sipas një studimi të fokusuar mbi lidhjen korelacionale mes agresivitetit të adoleshentëve dhe marrëdhënieve sociale, ku janë përfshirë 524 adoleshentë nga 20 shkolla në qendër të qytetit Nigde, Turqi, të moshës 15 vjeç, ku 257 (49%) e pjesëmarrësve janë vajza dhe 267 (51%) prej tyre janë djem, ku instrumenti i përdorur është Buss dhe Perry dhe i përditësuar nga Buss dhe Warren (2000), janë matur pesë nga format e agresivitetit: agresiviteti fizik, agresiviteti verbal, tensioni fiziologjik, armiqësia dhe agresiviteti indirekt. Nga ky studim raportohet se mes agresivitetit dhe marrëdhënieve sociale ka dallime të rëndësishme gjinore. Rezultatet tregojnë se katër nga format e agresivitetit të djemtë (me përjashtim të zemërimit, mbizotërues tek vajzat) rezultojnë në nivele më të larta se tek vajzat.

Gjetje e rëndësishme të këtij hulumtimi është dhe fakti se adoleshentët të cilët janë të pëlqyer nga grupet e tyre shoqërore janë më social dhe nuk janë të prirur të shfaqin agresivitet, ndërsa ata që nuk janë të pëlqyer shfaqin më tepër agresivitet, kjo sipas Yavuzer, (2013).

Nga studimet raportohet se një nga shkaqet e rezultateve, ku vajzat raportojnë nivele agresiviteti më të lartë se djemtë, mund të lidhet edhe me dhunën dhe format e ndryshme të abuzimit që ushtrohet kundrejt femrave në vendin tonë kjo sipas Mundy, (1997); Guerra, (2004); Cillessen & Rose, (2005); Walcott, (2008); Yilmaz-Anatca, (2010); Borch, (2011); Kuryluk,( 2011). Vetëm në 2010, raprohet një përqindje e lartë e abuzimit fizik , emocional, seksual dhe neglizhence kundrejt vajzave, kjo vlerësuar nga një studim në kuadër të ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore, organizuar kjo nga UNICEF dhe CRCA, ku raportohet se disa nga format e abuzimit kundrejt vajzave që zënë dhe përqindjet më të larta janë: marrëdhëniet me partnerin (53%), prind- fëmijë (28%), abuzimi emocional dhe ai fizik(6% secila) etj. Të dhëna të ngjashme vijnë dhe nga studimi i mbi dhunën kundrejt fëmijëve në Shqipëri, ku vajzat raportnin dhunë psikologjike më të lartë se djemtë , ndërsa në lidhje me dhunën fizike të dhënat e këtij studimi nuk paraqesin ndonjë ndryshim thelbësor midis viktimizimit të djemve dhe vajzave, Hazizaj, A., Coku, B., Cenko, E., & Haxhiymeri, E., (2013) “*Case-based surveillance study on violence against children in Albania*”, CRCA, BECAN, duke na treguar dhe njëherë që rezultatet tona na japin po të njëjtat gjetje.

Një lidhje mund të shohim me faktin si vajzat perceptojnë mënyrën e trajtimit në familje pasi një tjetër studim na raporton të dhëna mbi ndjesinë e neglizhencës, tek vajzat

raportohen nivele më të larta se tek djemtë. Prevalenca tek vajzat është 31%, ndërkohë që raportohen vetëm 20% tek djemtë. Të dhëna po aq interesante ky studim kryer në 160 vende të ndryshme të botës mbi dhunën ndaj vajzave, sipas të cilit raportohet se çdo 10 minuta, diku në botë, një vajzë adoleshente vdes si rezultat i dhunës. Megjithatë, këto vdekje përfaqësojnë vetëm sulmet më ekstreme dhe të paravokueshme, studimi e të publikuar nga UNICEF, (2014) “A Statistical Snapshot of Violence against Adolescent Girls, New York”.

Në vazhdimësi vajzat adoleshente në jetën e tyre të përditshme përballen me dhunë që zakonisht ushtrohet nga njerëzit e tyre të afërt - kujdestarë, kolegë si dhe partnerët intim. Dhuna mund të marrë shumë forma, duke përfshirë atë fizike, seksuale dhe dhunë emocionale, e cila ndryshon nga forma dhe ashpërsia e saj.

Të gjithë adoleshentët mund të përjetojnë dhunë, por duke qenë se vajzat paraqesin dobësi të veçantë dhe duke patur parasysh rolin e tyre në jetën e mëvonshme, ku ato do të jenë nëna dhe edukuese të një brezi të ri, këto sjellje kundrejt tyre mund të ketë pasoja, që mund të zgjasin gjatë gjithë jetës. Vajzat adoleshente përjetojnë forma të tilla, si, dhuna seksuale, në norma më të larta se sa tek djemtë. Ato janë gjithashtu më shumë të ekspozuar ndaj disa praktikave të dëmshme, të tilla, si martesë e tyre në moshë shumë të hershme, si dhe në disa kultura dhe gjymtimi gjenital femëror / prerje - të cilat janë manifestime të drejtpërdrejta të diskriminimit gjinor. Çdo vit, rreth 1.3 milionë adoleshentë vdesin, si rezultat i shkaqeve të ndryshme. Rreth 45 përqind e këtyre vdekjeve (rreth 600.000), janë vajza adoleshente, ku rreth 10 për qind e tyre, janë për shkak të llojeve të ndryshme të dhunës. Niveli i dhunës ndryshon nga adoleshenca e hershme deri në adoleshencën e vonë.

Përsa i takon dhe përmbysjes me dy nënshkallët e veta, agresivitetin marrëdhënor dhe atë pasiv, djemtë paraqiten gjithashtu pothuajse me të njëjtën vlerë me vajzat si dhe tek bulling.

Referuar literaturës rezultatet e këtij studimi lidhur me bulling janë në të njëjtën linjë, që ka të bëjë me nivel të lartë të cilën, paraqesin se djemtë krahasuar me vajzat, shfaqnin nivele të larta të bulling, por së fundmi, ky fenomen raportohet në nivel të larta lidhur dhe me vajzat.

Në këtë kuadër të dhënat studimit tonë mund të thuhet se janë të pritshme duke ju referuar edhe të dhënave që kemi marrë në mënyrë të tërthortë nga Inventari i Ministrisë së Drejtësisë mbi kriminalitetin e të miturve në Shqipëri. Në përputhje kjo dhe me nivelin e dënimit të marra nga shteti Shqiptar siaps të dhënave statistikore për kriminalitetin e të miturve nga viti 2003 deri në vitin 2013, që pasqyrojnë një rritje të theksuar të fenomenit të kriminalitetit tek të rinjtë, sipas këtyre të dhënave vihet re se është rritur ndjeshëm madje në proporcion numri si i djemve dhe vajzave adoleshente që përfshihen në kundravajtje penale, të cilat shërbyen dhe si një indicio për kryerjen e studimit tonë.

Po të njëjtën gjë vërejmë dhe në lidhje me studimin i publikuar mbi dhunën kundrejt vajzave adoleshente, ku raportohet si një nga problemet më shqetësuese për tërë botën e adoleshentëve është fenomeni i bulling. Studimi na ofronte informacion për gjininë femërore, ku një në tre vajza mes moshës 13 dhe 15 në gjithë botën kanë një përvojë me bulling. Të dhënat e disponuara sugjerojnë se të dyja gjinitë në shumicën e vendeve janë në rrezik të barabartë para bulling apo viktimë e bulling, megjithatë, dallimet mes gjinive janë

të dokumentuara kur është fjala për mënyrat në të cilat djemtë dhe vajzat përjetojnë bulling apo detyrojnë të tjerët të bëjnë atë që ata duan *A Statistical Snapshot of Violence against Adolescent Girls*, UNICEF (2014).

Referuar literaturës një vajzë është më e prirur për format psikologjike/ relacionale të dhunës psikologjike, të cilat përfshijnë veprime të tilla, si përjashtimin e të tjerëve apo përhapja e thashethemeve për ta, duke përdorur madje dhe mënyra të sofistikuara për të arritur qëllimin e tyre.

Një studim i kryer në 106 vendeve me të dhëna të krahasueshme mbi vajzat adoleshente që janë pre e bulling, raportohet se normat variojnë me vlera të ndryshme, nga 7% në 70 për qind në Egjipt, tek vajzat niveli i bulling varion nga 8 për qind, në Itali në 52 përqind, në Lituanë. Në 12 nga 67 vende me të ardhura të ulëta sipas të dhënave të disponueshme, më shumë se gjysma e vajzave adoleshente kanë thënë se kohët e fundit kanë patur një përvojë me bulling UNICEF, (2013).

## **H.2- Ekzistojnë dallime gjinore mes formave të agresivitetit dhe llojeve të nxitësve të tij tek adoleshentët.**

Mbështetur në hipotezën e dytë, në këtë studim raportohet se dallime gjinore ekzistojnë midis disa formave të agresivitetit përkatësisht atij fizik, agresivitetit të fshehur dhe hakmarrjes, ku djemtë raportojnë nivele më të larta se vajzat, ndërkohë dallime statistikore të rëndësishme ku vajzat raportojnë nivele më të larta krahasuar me djemtë tek nxitësi “*në shtëpi*”.

Përsa i takon nxitësit, *në shkollë* dhe *në në përgjithësi* konstatohet se vajzat dhe djemtë nxiten me të njëjtat vlera. Dallimet gjinore në lidhje me nxitësit, *me shokët / shoqet*, tregojnë se vajzat nxiten me të njëjtat vlera krahasuar me gjininë mashkullore.

Shkalla e lartë e ndikimit të nxitësve tek agresiviteti që adoleshentët paraqesin, *në shtëpi* dhe *në shkollë*, si dhe *me shokët / shoqet* mund të ketë disa arsye, por kjo është në të njëjtën linjë, me një nga indiciet e ndërmarrjes së këtij studimi mbështetur nga të dhënat e studimit të kryer nga Tamo A. & Karaj Th.(2006) mbi Dhunën kundër fëmijëve në Shqipëri, UNICEF & Qendra e studimeve humane, Tiranë. Raporti i cili ka sjellë disa gjetje, që shpjegojnë dy nga arsyet e nxitjes së agresivitetit në shtëpi si: atë të dhunës fizike dhe psikologjike. Referuar gjetjeve të këtij studimi në lidhje me format e dhunës, rezulton se dhuna fizike aplikohet si te djemtë ashtu edhe te vajzat, por me një vlerë më shumë të lartë tek djemtë se te vajzat, kjo si në familje ashtu edhe në shkollë.

Sipas një studimi të kryer në Kentakin Verior mbi këtë problematikë jemi pothuajse në të njëjtën linjë, përsa i takon vlerave të rritura, por jo përsa i takon diferencave gjinore, kur në fokus të të cilit është rritja e niveleve të agresivitetit dhe dhunës në shkolla. Studimi hedh dritë në qartësimin e diferencave të agresivitetit në mesin e nxënësve të shkollave të mesme por dhe ndikimit të moshës dhe gjinisë në lidhje me agresivitetin, Shaikh, F., Viveki, R. G. & Halappanavar, A. B., (2014).

Ky studim i kryer në një shkollë të mesme në zonë urbane që ka përfshirë 347 studentë, ku 199 djem dhe 148 vajza, të moshës 13-16 i cili është mbështetur mbi pyetsorin vetraportues Baron, 1977, analizon format e agresivitetit të përdorura nga ana e



adoleshentëve në lidhje me agresivitetin fizik (agresivitet fizik aktiv të drejtëpërdrejt, të tërthortë, agresivitet fizik pasiv të drejtëpërdrejtë dhe indirekt) / verbal (agresivitet verbal aktiv i drejtëpërdrejtë, verbal aktiv i tërthortë, agresivitet verbal pasiv i drejtëpërdrejt dhe indirekt).

Rezultatet kanë treguar se shumica e nxënësve (58.8%) rrjedhin nga familjet që nuk manifestojnë agresivitet, ndërsa 26.2% e nxënësve përjetonin apo janë pre e formave të agresivitetit në familje, ku modeli për përdorimin e formave të agresivitetit ishin prindërit (42.3%) dhe aktorët TV / Kinema (39.0%). Në përgjithësi, 241 (69.5%) nxënës raportonin të kishin shfaqur në muajin e mëparshëm agresivitet fizik. Raportohet se agresiviti fizik aktiv, ose direkt dhe indirekte është më i zakonshëm te djemtë se sa te vajzat. 248 (71.5%) nxënës raportohet se kanë shfaqur agresivitet verbal në muajin e kaluar, ndërkohë rezulton se dhe agresiviteti fizik rritet ndjeshëm sipas moshës duke filluar me (56.9%) në moshën bazë të studimit pra 13-14 vjeç dhe rritet në (84.6%) në moshën 16 vjeç. Kjo nuk raportohet me të dhënat e studimit tonë mbi ndryshimet e ndikimin të nxitësve në lidhje me moshën nga 15-19 vjeç.

Të dhëna të tjera që raportohen në studimin tonë tregon që nuk ekzistojnë dallime midis formave të agresivitetit në lidhje me zonën ku banojnë adoleshentët, përkatësisht zonë urbane dhe rurale. Referuar këtij studimi vlerësohet se nuk ekziston një lidhje statistikisht e rëndësishme mes formave të agresivitetit dhe vendbanimit të adoleshentëve.

Për nxitësin, në *shtëpi*, qoftë adoleshentët e zonave rurale dhe ata të zonave urbane nxiten pothuajse njësoj pra me të njëjtën vlerë. Adoleshentët nuk dallojnë nga njëri tjetri as përsa i

takon nxitësit, *me shokët* , ku adoleshentët e zonave urbane nuk nxiten më tepër krahasuar me adoleshentët e zonave rurale, ndërsa përsa i takon nxitësit “në përgjithësi” rezulton se adoleshentët që jetojnë në zona rurale, dukshëm nga ata të zonave urbane, shfaqin vlerë mesatare të lartë, por jo me vlera sinjifikative statistikore.

Duke iu referuar këtij studimi, kemi të dhëna interesante dhe përsa i takon moshës, të diferencuara këto nga 15 deri në 19 vjeç, në lidhje me format e agresivitetit. Ashtu si është paraqitur dhe në të dhënat që raporton studimi (shih kapitulli VI ), ajo që të bie në sy është se të gjithë adoleshentët nxënës nga mosha 15- 19 vjeçare pjesëmarrës në këtë studim nuk na rezultojnë të kenë një lidhje sinjifikante statistikore me shkallët dhe nënshkallët e agresivitetit. Rezultatet në lidhje me moshën dhe format e agresivitetit lidhen pak a shumë dhe me ndërveprimin e katër llojeve të nxitësve që përfshin ky studim. Të dhënat nuk raportuan dallime gjinore në lidhje me moshën dhe tek nxitësit, në shtëpi, në shkollë, me shokët/ shoqet dhe në përgjithësi.

## **PËRFUNDIME**

Studimi paraqet të dhëna lidhur me format e agresivitetit dhe nxitësve të tij tek adoleshentët shqiptar nga mosha 15 - 19 vjeç, duke mundësuar analizën dhe vlerësimin e dinamikave dhe prirjeve aktuale e lidhur kjo me shfaqjen e formave të agresivitetit tek djemtë dhe vajzat si dhe e nxitësve përkatës.

Krahasimi i të dhënave të raportuara me ato nga literatura ndërkombëtare ofrojnë një mundësi të mirë për të kuptuar dhe vlerësuar nivelin e formave të ndryshme të agresivitetit në Shqipërisë kundrejt vendeve të rajonit apo më gjerë.

Nga ky studim kemi një informacion të gjerë dhe analizë të thellë të formave të shfaqjes së agresivitetit dhe nxitësve të tij te adoleshentët shqiptar, nga mosha 15-19 vjeç, bazuar kjo jo vetëm përmes aplikimit të instrumentit vetraportues ARES, por mbështetur dhe mbi të dhënat zyrtare kombëtare, si: INSAT, Invenatri i Ministrisë së Drejtësisë, si dhe burime të besueshme ndërkombëtare si: Organizatën Botërore të Shëndetësisë( OBSH), Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF), Children's Human Rights Centre of Albania( CRCA).

Është tepër e thjeshtë të thuash apo të shprehesh qoftë edhe duke ju referuar statistikave të përgjithshme, se të rinjtë janë, ose jo agresivë, apo duke dashur t'i përgjithësojmë, shpesh mund të bëhen edhe gabime. Studimi tregon qartë qasjen apo tendencat e kohës, duke paraqitur nivelin e formave të shfaqjes së agresivitetit te adoleshentët shqiptar, nga mosha 15-19 vjeç, që janë kthyer në problem shqetësues jo vetëm për adoleshentin dhe jetën e tij të mëvonshme, por për familjen dhe shoqërinë në përgjithësi.

Ajo që paraqet interes në lidhje me rezultatet e këtij studimi është fakti i analizës së lidhjes korrelative sinjifikative lineare që raportohet mes formave të agresivitetit dhe nxitësve të

tyre, si faktorë kyç që kanë të bëjnë me intensifikimin apo agravimin e agresivitetit tek këta adoleshentë.

Ka një mospërputhje midis shkallës së agresivitetit të raportuar në studim dhe formave të ushtruar nga adoleshentët ndërmjet tyre, kundrejt prindërve, mësuesve apo pronës private të shfaqura në jetën e përditëshem.

Mospërputhje vërehet dhe me të dhënat kombëtare që publikohen në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë mbi adoleshentët, apo dhe për vlerësimet e bëra nga institucione ndërkombëtare mbi të drejtat dhe mënyrën e trajtimit të tyre në familje dhe shkollë, me qëllim formulimin dhe hartimin e politikave ndërhyrëse.

Nxitësit si: *shkolla* dhe *në përgjithësi*, paraqesin lidhje korrelative lineare sinjifikative statistikore, me drejtim pozitiv por me fuqi të dobët mes tyre dhe formave të agresivitetit, ndërsa nuk raportohen dallime gjinore si në lidhje me nxitësit ashtu si dhe në lidhje me zonën ku ata jetojnë.

Ndërkohë faktor shqetësues konsiderohen gjetjet mes formave të agresivitetit dhe nxitësve *në shtëpi* si dhe *me shokët/shoqet* me fuqi të moderuar, që kërkon studime të më tejshme për gjetjen e rrugëve të zgjidhjes, si dhe dallimi gjinor, vajza kundrejt djem, i raportuar në lidhje me nxitësin *në shtëpi*.

Janë pikërisht adoleshentët e grupmoshës së përfshirë në studim 15-19 vjeç, që raportojnë se adoleshentët e zonave rurale nuk nxiten më tepër, se ata në zonë urbane .

Shkalla e shfaqjes së agresivitetit në përgjithësi është e krahasueshme me vendet e rajonit, ku ajo shfaqet jo me vlera më të lartë krahasuar kjo me vendet e Bashkimit Europian apo SHBA.

Në fakt në këto vende fenomeni i agresivitetit ka qenë problematike në vitet 80-90 të cilat, në vite kanë ndërmarrë ndërhyrje afatgjata, afatmesme dhe afat shkurtra, përmes programeve ndërhyrëse për reduktimin dhe parandalimin e këtyre lloj sjelljesh.

Prandaj në këto vende sot fokusi i analizës së agresivitetit dhe masave ndërhyrëse është drejtuar në studimin e ndikimit të botës kibernetike tek adoleshentët, element i cili nuk ishte në fokus të këtij studimi në vendin tonë.

Nivelet e larta që rezultojnë në lidhje me agresivitetin e fshehur dhe bulling e që lidhen në fakt me agresivitetin e shfaqur, i cili në vetvete rezulton në nivele të larta, te nxënësit e shkollave të mesme përbën problem serioz për shkak të rreziqeve që ato bartin.

Agresiviteti dhe niveli i lartë i bulling tek adoleshentët e shkollave të mesme përkatësisht të moshës 15- 19 vjeç mund të pengojnë nxënësit jo vetëm të shkojnë në shkollë, por për rrjedhojë, kjo sjell pengesë në ecurinë e tyre akademike dhe zhvillimin individual, kjo për shkak të qenit të frikësuar apo frika që vërtet mund të dëmtohen.

Agresiviteti në shkollë mund të jetë një nga arsyet që pengojnë në arritjet e tyre akademike. Kjo ndodh për shkak se nëse ata mësojnë me frikë për shkak të frikës dhe ngacmimeve të marra në klasë ose jashtë saj, niveli i tyre i përqëndrimit dhe asimilimi mund të bjerë dhe ky fakt mund të sjellë për pasojë dështime akademike.

Prandaj bëhet e domosdoshme që çdo masë e nevojshme duhet të merret në mënyrë që të eliminohet ose zbutet niveli i agresivitetit, si dhe studime të mëtejshme duhet të fokusohen në lidhje me nxitësit e agresivitetit tek adoleshentët e shkollave të mesme.

Ky studim mund të konsiderohet si një mundësi vlerësimi për të riparë dhe analizuar në detaje faktorët e ndryshëm, që ndikojnë tek të rinjtë, shtigjet e veprimit të tyre, kornizat konceptuale, pasojat individuale, sociale dhe shoqërore, por mbi të gjitha pasojat ligjore.

Ky punim mund të shërbejë si një mundësi për të gjithë studiuesit e fushës lidhur me planifikimin e programeve ndërhyrëse mbi parandalimin apo minimizimin e formave të agresivitetit dhe sidomos nxitësve, në ridimensionimin e mbështetjes sociale dhe aktorëve të ndryshëm, që veprojnë në këtë fushë në vendin tonë. Ngelet problematike analiza e kuadrit ligjor, që duhet të ofrojë një tablo mbi gjithëpërfshirjen e adoleshentëve në vendin tonë nga mosha 15-19 vjeç.

## **KUFIZIMET E STUDIMIT**

Studimi mbi analizën e formave të agresivitetit dhe nxitësve të tij te adoleshentët shqiptar, nga mosha 15-19 vjeç, mbart kufizimet e veta.

Kufizim specifik i këtij studimi është gjeneralizimi i gjetjeve mbi analizën e formave të agresivitetit dhe nxitësve të tij te adoleshentët shqiptar, pasi ky studimi përfshin vetëm grupmoshën 15 – 19 vjeç.

Grupmosha e adoleshentëve që u përfshinë në këtë studim iu referuan të dhënave që INSTAT ofron në ndarjen që i bën grupmoshave. Ndarja e grupmoshave jepet me periudha me një diferencë minimale katër vjeçare dhe jo për secilin vit jetësor. Kjo ka sjellë një kufizim në këtë studim përse i takon pjesëmarrësve, pjesë e të cilit ishin vetëm adoleshentët e grupmoshës 15- 19 vjeç, duke përjashtuar përfshirjen e atyre që i përkasin adoleshencës së hershme, mosha 11/12 -14 vjeç, si dhe ata të moshës 20/21 vjeç.

INSTAT ofron ndarjen e popullsisë sipas 12 qarqeve të territorit Shqiptar, vendbanimit, përkatësisht të dhënat e popullsisë në zona urbane dhe rurale, si dhe numrin e nxënësve që kryejnë arsimin e mesëm sipas drejtimeve në shkollat e mesme të përgjithshme, profesionale apo atyre të orientuara, si dhe numrin e tyre përkatës sipas gjinive. Në këto të dhëna nuk identifikohet numri i nxënësve në arsimin e mesëm sipas secili qark, zonës së banimit, përkatësisht urbane dhe asaj rurale apo gjinisë.

Kjo gjë ka sjellë kufizim në numrin e kampionit të përzgjedhur, përkatësisht 816 nxënës. Ky numër është jo plotësisht i saktë, por një numër i përafërt.

Jashtë këtyre të dhënave ngelen dhe detaje mbi atë numër nxënësish që nuk frekuentojnë shkollën, të cilët nuk janë pjesë gjithashtu e këtij studimi, për ata që kryejnë arsim me kohë të pjesshme, adoleshentë që mund të vuajnë dënime, në vitin përkatës, për shkak të veprave penale të kryera, si dhe ata të cilët mund të mos jenë në vitin përkatës rezident në Shqipëri. Të gjithë adoleshentët e kategorive të sipër përmendura përbëjnë një tjetër kufizim të këtij studimi.

Në lidhje me procedurën e kryerjes së studimit, ai u realizua nga profesionistë të fushës në çdo qark, dhe në të u përfshin në studimin final 816 nxënës, natyrisht vështirësi u ndesh në zonat rurale ku ekzistojnë tabu në lidhje me rolin e psikologut dhe rolit të tij, sikundër dhe mungesa masive e tyre.

Një pjesë e nxënësve ishin dyshues për mos nxjerrjen e identitetit të tyre ndonëse ju bë e qartë mos identifikimi i tyre me emër, por me një numër. Zgjedhja e nxënësve është rastësore në shkollat dhe klasat që u përfshinë në studim, por në qarqe të caktuara jo të gjithë nxënësit pranuan të ishin pjesë e studimit në momentin që ju shpjegua se çfarë ai kërkonte.

Në zonat rurale numri i vajzave të cilat nuk pranuan të ishin pjesë e këtij studimi ishte 39, ndërsa në zonat urbane djemë të cilët nuk pranuan të ishin pjesë e këtij studimi ishte 46. Këta adoleshentë ishin të moshës 15 vjeç dhe i takonin klasave të 10-ta, pasi e kishin kryer të njëjtin studim një vit më parë, përkatësisht në klasën e 9-të. Kjo përbën dhe një tjetër kufizim që lidhet me numrin e pjesëmarrësve për shkak të përsëritjes së instrumentit matës.



Një kufizim tjetër lidhet me instrumentin e përdorur në studim. Pyetsori i përdorur ARES, që synon matjen e formave të agresivitetit dhe evidentimin e nxitësve të një episodi është i vetmi instrument matës për popullsinë shqiptare që është drejt validitetit dhe ndërkohë në variantin origjinal është përdorur për adoleshentët deri në moshë 17, duke sjellë kufizim në interpretimin dhe për rrjedhojë gjetjeve lidhur me moshat 18 dhe 19 pjesë të këtij studimi.

Ndër limitet mund të përmendim faktin se nga adoleshentët e përfshirë në studim nuk ka të dhëna mbi sëmundjet shoqëruese që ata mund të kenë, si dhe nëse janë apo jo përdorues të psikotikëve të ndryshëm. Nuk ka informacion nëse ndonjë prej tyre ndjek seanca për pakësimin e niveleve të agresionit.

Kufizime rrjedhin dhe për shkak se mungon sistemi i informimit nga vjetarët e Ministrisë së Drejtësisë mbi faktin se sa prej të dënuarve adoleshentë janë apo kanë qënë në periudhën e kryerjes së një vepre penale përdorues të alkoolit, apo psikotikëve të ndryshëm.

Në kontekstin social-kulturor nuk kemi të dhëna për nxënësit që janë përfshirë në këtë studim për nivelin e tyre ekonomik, etninë të cilës i përkasin, stilit të jetesës dhe pritshmërive që ka çdo familje për statusin e tyre në shoqëri, nëse merren me aktivitete fizike apo kulturore. Nëse ka prej tyre që mund të jetë me prindër të dënuar për kryerje të veprave penale, nëse ndonjë prej tyre mund të jetë apo të ketë qënë pre e formave nga më të ndryshme të dhunës, apo mund të jetë pjesë përfshirëse e ndonjë programi rehabilitues, nëse ka prej tyre që nuk kanë prindër dhe jetojnë ose tek të afërmit ose në institucionet përkatëse.

Të gjitha këto ndikojnë drejt përsëdrejti në rezultatet e këtij studimi mbi analizën e formave të shfaqjes së agresivitetit dhe nxitësve të tij. Ajo që mungon në këto të dhëna dhe që luan një rol të rëndësishëm në rezultate është mungesa e informacioneve mbi marrëdhëniet e adoleshentëve me familjen, shkollën dhe bashkëmoshatarët.

Përdorimi i një metodologjie vet - raportuese është e rëndësishme pasi jep të dhëna të përgjithshme mbi kampione të gjera popullatash si dhe rezultatet mund të publikohen në media, sikundër mund të jenë sinjifikative në mënyrën si publiku percepton kërkimin shkencor.

Në këtë studim ndonëse pjesëmarrësve iu siguroa anonimatit dhe konfidencialiteti i përgjigjeve përdorimi i instrumentit vetraportues mbart në vete dhe rreziqet e veta, gjë që përbën dhe kufizim në këtë studim në lidhje me: ndershmërinë që tregon pjesëmarrësi, apo vërtetësinë e raportimit, sidomos kur pjesëmarrësi duhet të raportojnë në lidhje me sjelljet e veta, si ato seksuale, sjelljet e dhunës që ushtrojnë, apo kur ajo ushtrohet mbi ta, si dhe mbi raportimin mbi përdorimin e drogës. Niveli i raportimit në këtë rast ndryshon në varësi të personalitetit.

Aftësia vet- analizuuese, e cila edhe në rastet kur pjesëmarrësi është duke u përpjekur të jetë i sinqertë, mungesa e kësaj aftësie bën që të mungojë përgjigja e saktë si dhe sjell paaftësi për të vlerësuar veten saktë. Në këto kushte çdo informacion që vet raportimi ofron mund të jetë i pasaktë, pavarësisht nga përpjekjet për të qenë të sinqertë dhe të saktë.

Të kuptuarit apo interpretimi mund të jetë sa i ndryshëm dhe problematik për pjesëmarrësit, kjo dhe përse i takon njëanshmërisë së përgjigjes në lidhje me përvojat

personale. Disa nga pjesëmarrësit mund të kenë qenë të njëanshëm në përgjigje, psh. kthimi i një përgjigjeje, *po*, duke vlerësuar vetëm një aspekt të veçantë për të, megjithëse një përvojë e tillë apo e ngjashme mund të ketë ndodhur vetëm në një rast të jetës së tyre.

Nuk kemi të përfshirë në këtë studim prindër apo mësues. Në prespektivën e prindërve ne nuk kemi informacion mbi vëllezërit e motrat dhe mosmarrëveshjet që adoleshentët e përfshirë në studim mund të kenë me ta, si dhe sa produktiv mund të kenë qenë vet prindërit në zgjidhjen e problemeve përmes diskutimit me adoleshentët. Pra, mungon informacioni, si për prindërit dhe adoleshentët, lidhen me njëri-tjetrin, në kontekstin marrëdhënor mbi zbulimin e anëtarëve të tjerë të familjes, kjo referuar dhe niveleve të larta që raportuan në këtë studim adoleshentët në lidhje me nxitësin, *në shtëpi*.

Një tjetër kufizim ka të bëjë me vlerësimin vëzhgimor të marrëdhënieve adoleshent- prind, apo matjen e cilësisë së këtyre marrëdhënieve, të cilat lidhen me rrezikun e agravimit të mëtejshëm të përdorimit të formave të ndryshme të agresionit, lidhen me rezultatet e punimit.

Nuk ka të dhëna nëse ka prej adoleshentëve që u bënë pjesë e këtij studimi, të cilët mund të kenë marrë masa ndëshkimore, qoftë për shkelje të disiplinës në shkollë, apo të kryerjes së akteve të dhunshme kundrejt bashkëmoshatarëve. Duke u fokusuar në zgjedhjen rastësore mosha e adoleshentit jo gjithnjë përputhej me moshën e bashkëmoshatarëve në klasën përkatëse. Mungojnë të dhënat për adoleshentët që mund të jenë më të mëdhenj në moshë se shokët e klasës koresponduese, kjo për shkak të ndonjë sëmundjeje, që mund të ketë qenë prezente në fëmijëri, për shkak të mos zhvillimit normal, prapambetjes akademike, për arsye të kthimit nga emigrimi, apo dhe për faktin, se në një stad tjetër moshor, mund të ketë

qenë në masën e kryerjes së dënimit për kundravajtjeve penale, apo të kenë qenë pjesë e grupeve për kryerjen e sulmeve kibernetike.

Pavarësisht nga kufizimet metodologjike të studimit, ku mund të përmendim kampionin e përcaktuar për këtë studim, pra mbi pjesëmarrësit, procedurën apo instrumentin e përdorur, studimi mbart rëndësinë e vet, pasi ai sjell gjetje të rëndësishme në lidhje me adoleshentët e moshës 15-19 vjeç. Ky studim mbi analizën e formave të agresivitetit dhe nxitësve të tij në këtë grupmoshë, raporton se ekziston një lidhje statistikisht e rëndësishme midis llojeve të agresivitetit, gjinisë, vendbanimit të adoleshentëve, në zonat urbane dhe rurale, por dhe moshës së tyre, si dhe në lidhje me nxitësit e tij.

## REKOMANDIME

Lidhja e raportuar mes formave të ndryshme të agresivitetit me nxitësit, *në shtëpi*, me *shokët/shoqet*, *shkolla* dhe *në përgjithësi* si dhe dallimet gjinore duhet të përbëjnë një shqetësim real në kontekstin shqiptar. Rezultatet e raportuara në këtë studim çojnë drejt sugjerimit të zgjidhjes së problemeve përmes kryerjes së studimeve të mëtejshme, sasiore dhe cilësore, apo përmes përdorimit të formave praktike të trajtimit të fenomenit.

Prania e psikologut në shkolla sugjerohet, si një institucion që parimisht duhet të ndikojë në reduktimin e agresivitetit dhe kjo jo vetëm brenda mjedisit shkollor. Në gjithë botën, kur shfaqen tendenca të agresivitetit, adoleshentët referohen tek psikologu, me synimin për të mos agravuar më tej këto sjellje tek adoleshentët, por sidomos në jetën e tyre të mëvonshme. Rekomandohet vendosja e tyre në shkollat e zonave rurale ku sot ky shërbim pothuajse nuk ofrohet. Gjithashtu shkollat e mesme dhe nëntëvjeçare duhet të mos kenë të njëjtët psikologë, që punojnë gjysëm kohe në shkollat nëntëvjeçare dhe gjysmën tjetër në shkollat e mesme dhe kjo vetëm në shkollat e qyteteve. Prandaj duhet të bëhet e mundur vendosja e këtyre profesionistëve, si dhe funksionimi i tyre në shkolla.

Sistemi i informacionit, i cili ka nevojë për rinovim që të bëjë të mundur konstatimin, vlerësimin, si dhe menaxhimin e formave të ndryshme të agresivitetit që në adoleshencën e hershme dhe të sjelljeve agresive. Monitorimi i vazhdueshëm i ndërhyrjeve parandaluese mundëson aplikimin e masave për forcimin e zbatimit të ligjit, kryesisht për adoleshentët. Hartimi i statistikave më të sakta nga institucionet e tjera shtetërore si: kujdesi shëndetësor, shëndeti publik si dhe organet ligjzbatuese, por dhe mbledhja e informacione mbi stilet e jetesës, bëjnë të mundur vendosjen e prioriteteve për parandalim dhe reduktim të

agresivitetit dhe sjelljeve agresive. Nevojiten anketa periodike jo vetëm vetraportuese nga ana e adoleshentëve, por dhe prindërve, mësuesve apo punonjësve socialë në të gjithë territorin e vendit.

Parandalimi apo reduktimi i agresivitetit duhet të jetë disa planësh dhe multidisiplinar. Ministrinë e ndryshme, organizatat ndërkombëtare dhe shoqatat joqeveritare, përmes oragnizmave të tyre, duhet të aplikojnë programe të ndryshme edukative si për mirëfunksionimin në shkolla, si dhe zbatimin e duhur të kurrikulave si dhe njohja e penaliteteve në rastet e përcaktuara në legjislacionin Shqiptar. Duhet të ndryshojnë baza ligjore në lidhje me penalitetet mbi adoleshentët, si dhe trajtimi i tyre në institutet e vuajtjes së dënimit. Vënia në funksion e shkollave të riedukimit mund të ishte një zgjidhje dhe jo vuajtja e dënimeve në burg, siç ndodh aktualisht.

Roli i fushatave periodike mediatike kombëtare duhet të jetë domethënës dhe jo diskutimee fokusime vetëm në raste që tronditin rëndë opinionin publik. Shoqatat e ndryshme joqeveritare, duhet të ofrojnë shërbime frytdhënëse duke filluar nga programet e ndërhyrjeve, deri te edukimi i tyre në vendet e vuajtjes së dënimeve.

Shihet e domosdoshme hartimi i strategjive parandaluese. Qëllimi i aplikimit të tyre duhet të jenë përfshirja e vazhdueshme e adoleshentëve në sa më shumë aktivitete. Adoleshentët duhet ta shohin veten të vlefshëm, të dobishëm, të ndihen pjesë integruese e shoqërisë e që mund të kontribuojnë fal aftësive të tyre, kjo edhe në rastet e vendimmarrjeve.

Ndërhyrjet duhet të fokusohen edhe mbi rreziqet shëndetësore: Adoleshentët duhet të jenë të ndërgjegjshëm për atë çfarë ju ofrohet, duke kuptuar që pakësimi i këtyre sjelljeve, qenia tolerant dhe bashkëpunues e jo hakmarrës, ndikon drejtpërsëdrejti në shëndetin e tyre fizik,

emocional dhe mendor, si dhe në përmbushjen e detyrave dhe roleve që ata duhet të përmbushin në shoqëri.

Sipas Berg, (2012) rekomandohet identifikimi dhe gjetja e metodave më të mira të menaxhimit të agresivitetit. Ai sugjeron tri faza: Në fazën I, analizohet perceptimi i formave të agresivitetit të adoleshentëve dhe metodat për të menaxhuar. Në fazën II, është analizuar vendosja e trajtimit dhe ndërhyrjes. Në Fazën III, është vlerësuar efektiviteti i programi të menaxhimit të agresivitetit. Për të menaxhuar agresivitetin duhet të përcaktohet qëndrueshmëria e natyrës së agresiviteti dhe faktorët që lidhen me të.

Ky përkufizim është parakusht për njohjen e nivele të agresivitetit dhe për zbatimin e metodave të nevojshme në kohën e përshtatshme për të menaxhuar këtë sjellje sfiduese. Janë të rekomandueshme: Kryerje e herëpashershme e testeve me qëllim intervenimin e hershëm dhe përdorimin e metodave më pak kufizuese për të menaxhuar agresivitetit. Ndërhyrjet verbale, të cilat përdoren si metodat për menaxhimin kryesor të agresivitetit. Në menaxhimin e agresivitetit duhet të përfshihen rregullisht diskutimet Post- incidentit me adoleshentët.

Për trajtimin e një sërë problemesh të lidhura me agresivitetin rekomandohen ndërhyrjet me natyrë psikosociale, si: ndërhyrjet psikodinamike, ndërhyrjet konjitive dhe të sjelljes, ndërhyrje afatshkurtra, nëpërmjet bisedave motivuese, si dhe ndërhyrjet morale e fetare.

Ndërhyrjet psikosociale: Ato duhet të kenë si synim ndryshimin e faktorëve të sjelljes sociale dhe konjitive. Përdorimi i ndërhyrjeve psikodinamike mund të ishin tepër efektive,

duke mundur ta tërheqin adoleshentin në konfliktet bazë psikodinamike dhe në çështjet emocionale, të cilat mund të çojnë drejt zgjidhjes.

Ndërrhyrjet kognitive- bihejviorale, mund të jenë strategji e vlefshme në reduktimin e agresivitetit. Bazuar në një studim të kryer në Lituani, ku janë përfshirë, nxënës nga 13 deri 17 vjeç të shkollave të mesme, të ndarë në dy grupe: grupi eksperimental dhe grupi i kontrollit, synohej matja e ndryshimit të agresivitetit, fokusuar mbi ndërrhyrjen përmes përdorimit të terapisë Kognitive – Bihejviorale. Rezultatet e këtij hulumtimi kanë zbuluar se pas intervenimit të bazuar në terapi kognitive- behaviorale niveli i agresivitetit fizik dhe verbal, si tek meshkuj dhe femrat është ulur. Bazuar po në terapinë Kognitive- Bihaviorale, rezultoi se niveli i armiqësisë u ul në të dy grupet, si tek meshkuj dhe femrat. Niveli i zemërimit tek femrat pësoi rënie të ndjeshme, pas ndërrhyrjes së terapisë Kognitiv- Bihejviorale (Normantaite & Permina, 2013). Ndërrhyrjet Kognitive- Bihejviorale janë efektive në menaxhimin e zemërimit, pasi ndërrhyrje të tilla përfshijnë aspekte që janë domethënëse në kontrollin e zemërimit, të të menduarit, sjelljeve agresive, emocioneve apo agresivitetit. Këto ndërrhyrje mund të jenë gjithashtu efektive në çrënjosjen e sjelljeve të mësuara në familje, shoqëri apo media (Humphrey & Brooks, 2006; Ireland, 2004; Mohammadi, 2010; Qutaiba, 2010).

Duhet të synohet drejt përfuturit të aftësive të tjera konjitive, ndryshime në mjedisin e ngushtë social, si ndjekja e terapisë familjare ose grupeve sociale. Terapitë e grupit të njohura më së shumti për efektin e tyre, lidhur me sjelljet auditive, mund të jenë efektive dhe për sjelljet agresive dhe agresivitetin. Nëse këto grupe janë të mirëstrukturuara, ato



rritin mundësitë për një risocializim të mirë të adoleshentëve dhe kthimin e tyre në individë të përgjegjshëm dhe racionalë në gjykim dhe në marrjen e vendimeve.

Një vëmendje e veçantë u duhet kushtuar faktorëve dhe nxitësve që ndikojnë në shfaqjen e shkallëve dhe nënshkallëve të agresivitetit. Rekomandohet kryerja e studimeve cilësore duke evidentuar saktë nxitësit specifikë që përfshiheshin në këtë studim, duhet që të punohet me organet dhe institucionet për kryerjen e studimeve cilësore që lidhen ngushtësisht me këtë fenomen.

Efektive mund të jetë shpeshherë dhe përfshirja e adoleshentëve në aktivitete fetare apo altruiste, duke synuar në iluminimin shpirtëror, faljes së dashurisë, si normë në shoqëri dhe duke ju larguar dhunës si formë e zgjidhjes së problemeve.

Tepër e rëndësishme ngelet futja në studime sasiore dhe cilësore dhe e adoleshentëve të cilët nuk ndjekin arsimin. Një pjesë e tyre punon, për të ndihmuar prindrit e tyre, shumë prej tyre nuk ndjekin arsimin për shkak të mentalitetit të prindërve, apo ka nga ata që ju përkasin shtresave më vunerabël të shoqërisë tonë si: adoleshentët e komunitetit rom dhe egjiptjan.

Në përmbledhje mund të themi se institucionet duhet të bashkëveprojnë dhe të mundësojnë përveç hartimit të sistemeve të informacionit dhe kryerjen e fushatave sensibilizuese të pasojave të dhunës dhe niveleit të shfaqjes së agresivitetit. Vendosja e punonjësve psikologë në të gjithë shkollat e vendit. Ndërhyrje të natyrës praktike duhet të jenë në përputhje me hartimin e strategjive parandaluese dhe ndërhyrjet me natyrë psikosociale. Në lidhje me nivelet e agresivitetit dhe lidhjes që ato krijojnë me nxitësit dhe gjinitë përkatëse sugjerohen studimet cilësore.

## **BIBLIOGRAFIA**

### **Burime Parësore**

- Achenbach, T.M. (1993). *Empirically based taxonomy: How to use syndromes and profile types derived from the .CBCL/4-18, TRF, and YSR*. Burlington, VT: University of Vermont Department of Psychiatry.
- Atkin, C., Smith, S.W., Roberto, A.J., Fedriuk T. & Wagner, T. (2002). Correlates of verbally aggressive communication in adolescents. *Journal of Applied Communication Research*, 30(3), 251-268.
- Allen, J. P., Porter, M. R., McFarland, F. C., Marsh, P., & McElhaney, K. B. (2005). The two faces of adolescents' success with peers: Adolescent popularity, social adaptation and deviant behavior. *Child Development*, 76, 747 – 760.
- Anderson, C.A., & Bushman, J., (2002). *Human aggression*. Annual Review Psychology, 53, 27-51.
- Ayers, S., Baum, A. , Mc Manus, Ch. Newman, S., Wallston, K., Weinman, J. & West, R. (2007) . *Cambridge Handbook of Psychology, Health and Medicine*. (2nd Ed). Cambridge University Press
- Baron, R., (1977). Human Aggression. New York. *Plenium Press Behavior and Personality: an international journal*, 31(8), 815-823.
- Bjorkqvist, K., & Niemela, P. (1992). New trends in the study of female aggression. London: *Academic Press*
- Björkqvist, K. (1994). Sex differences in physical, verbal, and indirect aggression. *A review of recent research. Sex Roles*, 30, 177-188.
- Borch, C., Hyde, A., & Cillessen, A. H. N. (2011). The role of attractiveness and aggression in high school popularity. *Social Psychology Education*, 14, 23-39.
- Burbank, V.K. (1994). *Fighting Women: anger and aggression in Aboriginal Australia*. Berkeley, USA: *University of California Press*.
- Burns, R.B. & Dobson, C.B. (1984) *Introductory Psychology*, Springer,SV ISBN 978-94-011-6279-1
- Bushman, B. J., & Huesmann, L. R. (2006). *Short-term and long-term effects of violent media on aggression in children and adults*. *Archives of Pediatrics & Adolescent Medicine*, 160, 348–352.

- Buss, A. H. (1961). *The psychology of aggression*. New York: Wiley.
- Buss, A. H., & Durkee, A. (1957). An inventory for assessing different kinds of hostility. *Journal of Consulting Psychology, 21*.
- Buss, A. H., and Perry, M. (1992). The aggression questionnaire. *Journal of Personality and Social Psychology, 63*, 452-459.
- Buss, A. H., & Warren, W. L. (2000). Aggression questionnaire. Manuel. Los Angeles CA: *Western Psychological Services*.
- Campbell, S. B., (1995). Behaviour problems in preschool children: A review of recent Research. *Journal of Child Psychology and Psychiatry, 36, 1*, 115-119
- Card, A.N. Sawalani, M. G. Stucky, D. B. & Little, D. T.(2008). Direct and Indirect Aggression During Childhood and Adolescence. *A Meta-Analytic Review of Gender Differences, Intercorrelations and Relations to Maladjustment Direct. Vol 79*, fq 1185-1225.
